

osbe

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup



UDHËZUES PËR KALIMIN E BARRËS SË PROVËS TË KOMISIONIT TË PARANDALIMIT DHE TË MBROJTJES NGA DISKRIMINIMI



Shkup, 2023



UDHËZUES PËR KALIMIN E BARRËS SË PROVËS TË KOMISIONIT TË PARANDALIMIT DHE TË MBROJTJES NGA DISKRIMINIMI

Redaktore:

Dr. Zhaneta Poposka nga Misioni i OSBE-së në Shkup

Autore:

Natasha Amdiju, Konsulente e pavarur,
Dr. Zhaneta Poposka nga Misioni i OSBE-së në Shkup

Përktheu në shqip:

Blerina Starova Zllatku

Redaktim gjuhësor:

Edita Jashari

Dizajn grafik:

Toni Najdov - Vinsent Grafika, Shkup

Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përmbajtja e këtij edicioni mund të përdoret dhe riprodhohet lirisht për qëllime edukative dhe qëllime të tjera jo komerciale, me kusht që në çdo riprodhim si burim të theksohet Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminim dhe Misioni i OSBE-së në Shkup.

ISBN: 978-92-9271-197-9



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

PËRMBAJTJA:

HYRJE	7
I. KONCEPTI I PARIMIT TË KALIMIT TË BARRËS SË PROVËS	9
II. STANDARDE NDËRKOMBËTARE DHE KOMBËTARE PËR KALIMIN E BARRËS SË PROVËS	17
1. E drejta e Bashkimit Evropian.....	17
2. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.....	19
3. Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi	20
III. ELEMENTET DHE FAZAT E KALIMIT TË BARRËS SË PROVËS NË PRAKTIKË	23
1. Elementet e rastit prima facie të diskriminimit	24
1.1. Diskriminimi i drejtpërdrejtë.....	25
1.1.1. Diskriminimi i drejtpërdrejtë në bazë të seksit.....	30
1.1.2. Diskriminimi i drejtpërdrejtë në bazë të përkatësisë etnike.....	32
1.1.3. Diskriminimi i drejtpërdrejtë në bazë të aftësive të kufizuara	34
1.1.4. Diskriminimi i drejtpërdrejtë në bazë të religjionit ose besimit.....	36
1.1.5. Diskriminimi i drejtpërdrejtë mbi një bazë tjetër.....	37
1.1.6. Diskriminimi i shumëfishtë i drejtpërdrejtë.....	40
1.2. Diskriminimi i tërthortë.....	41
1.2.1. Diskriminimi i tërthortë në bazë të seksit	43
1.2.2. Diskriminimi i tërthortë në bazë të përkatësisë etnike	44
1.2.3. Diskriminimi i tërthortë në bazë të aftësive të kufizuara	46
1.2.4. Diskriminimi i tërthortë në bazë të religjionit ose besimit	46
1.2.5. Diskriminimi i tërthortë mbi një bazë tjetër	48
1.2.6. Diskriminimi i shumëfishtë i tërthortë	48
1.3. Forma dhe lloje të tjera të diskriminimit	49
1.3.1. Ngacmimi.....	49
1.3.2. Segregimi.....	50
1.3.3. Përshtatja adekuate	51
1.3.4. Thirrje, nxitje dhe instruksione për diskriminim.....	55
1.3.5. Viktimizimi.....	55
1.3.6. Forma më të rënda të diskriminimit	56
2. Përgënjeshtrimi i supozimit të diskriminimit dhe justifikimi objektiv	59
3. Specifikimi i barrës së provës në vendim (mendimi i Komisionit të Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi ose me vendimin e gjykatës)	73
BIBLIOGRAFIA	77



HYRJE

Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi (në tekstin e mëtejshëm: KPMD ose Komisioni), në kuadër të projektit “Fuqizimi i sundimit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut II” i mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Shkup, në periudhën kohore prej gushtit deri në tetor të vitit 2022, e hartoi Udhëzuesin për kalimin e barrës së provës të Komisionit të Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi. Ai synon të qartësojë institutin proceduralo-juridik të kalimit të barrës së provës në procedurë para Komisionit me qëllim të zbatimit efikas të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi (në tekstin e mëtejshëm: LPMD).

Sfidë gjatë hartimit të Udhëzuesit ishte shqyrtimi sistematik dhe analitik i situatave lidhur me kalimin e barrës së provës si në procedurën para Komisionit, ashtu edhe në procedurën gjyqësore, duke e marrë në konsideratë praktikën ekzistuese kombëtare. Së këtejmi, Udhëzuesi e sqaron kuptimin, shtrirjen, pyetjet e hapura dhe diskutimet rreth këtij instituti juridik, si dhe jep shembuj nga praktika e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejshëm: GJDBE) dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), si dhe nga disa praktika krahasuese të vendeve evropiane, për të ndihmuar praktikuesit juridik dhe veçanërisht KPMD në të kuptuarit dhe të zbatuarit e tij. Për më tepër, Udhëzuesi nxjerr në pah shembuj pozitivë nga praktika e KPMD-së, duke e ilustruar kalimin e barrës së provës në opinionet e tyre.

Arsyetimi i hartimit të Udhëzuesit konsiston në nevojën e shtjellimit të kalimit të barrës së provës si institut proceduralo-juridik, i cili është sanksionuar në sistemin juridik kombëtar përmes legjislacionit kundërdiskriminim, si në procedurat gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi, ashtu edhe në procedurat para Komisionit. Ky Udhëzues duhet të shërbejë si një ndihmesë për ta kuptuar atë, i cili nuk synon të ofrojë një shqyrtim të plotë teorik të tij, ndërkaq i vë në dukje mënyrat më të mira për aplikimin e barrës së provës në praktikë. Njëkohësisht, lë hapësirë për fleksibilitet dhe interpretim evolutiv të këtij instituti nga KPMD-ja si dhe nga praktikueset dhe praktikuesit e tjerë juridikë.

Udhëzuesi u hartua me anë të përdorimit të një metodologjie të kombinuar, e cila korrespondon me pasqyrën e literaturës që përbëhet nga dokumente juridike dhe praktika gjyqësore, si dhe nga debati profesional me Komisionin në lidhje me tekstin e Udhëzuesit. Implementimi u mbikëqyr nga Misioni i OSBE-së në Shkup.



I

KONCEPTI I PARIMIT TË KALIMIT TË BARRËS SË PROVËS

Sipas LPMD-së, barazia kuptohet si një parim sipas të cilit të gjithë njerëzit janë të barabartë, përkatësisht të njëjtë në gëzimimin dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe lirive. Në zhvillimin e saj historik në teorinë juridike, barazia kuptohej, fillimisht, si formalo-juridike sipas së cilës të gjithë jemi të barabartë përpara ligjit dhe konform kësaj, të barabartit duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, ndërsa të pabarabartët në një mënyrë ndryshe. Sipas Komentit të përgjithshëm nr. 6 të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, megjithëse barazia formale mund të ndihmojë shumë në luftimin e stereotipave dhe paragjykimeve negative, megjithatë nuk mund të ofrojë një zgjidhje për „dilemën e diversitetit“, sepse nuk i shqyrton madje as nuk i pranon dallimet ndërmjet qenieve njerëzore¹. Prandaj, në teorinë juridike konsiderohet se është një mënyrë e vjetruar e perceptimit të barazisë, e cila nuk u jep përgjigje formave të shumta të diskriminimit që paraqiten edhe pse kuptimi formalo-juridik i barazisë është përmbushur. Së këtejmi, ishte e padiskutueshme shfaqja e mënyrës së dytë të perceptimit të barazisë, që ka të bëjë me barazinë materiale, e cila duhet të garantojë barazi në mundësitë dhe realizimin e të gjitha potencialeve të personit, duke siguruar barazinë e pozicionit fillestar, që mund të kërkojë edhe aplikimin e masave të veçanta ose afirmative atje ku ka pabarazi të krijuar historikisht. Për më tepër, barazia materiale parasupozon një interpretim më të gjerë të nocionit të barazisë dhe nënkupton zbatimin e barazisë juridike në jetën e përditshme, me ç'rast rezultatet dhe efektet që burojnë nga zbatimi i ligjeve, politikave dhe praktikave nuk duhet të rezultojnë me diskriminim. Ky qëndrim, në mënyrë të veçantë e merr parasysh diversitetin e grupeve të caktuara të mbrojtura, si për shembull, në rastet e përshtatjes së duhur për personat me aftësi të kufizuara.

Sot jemi dëshmitarë se kuptimi materialo-juridik i barazisë gradualisht po zëvendësohet me një koncept të ri të barazisë, që është barazia inkluzive. Me fjalë të tjera, Komenti i përgjithshëm nr. 3 i Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara pranë Kombeve të Bashkuara,² flet për barazinë inkluzive si një model i ri i barazisë, i zhvilluar në Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e cila e përfshin barazinë materiale, duke e ela-

1. Shih: General Comment No. 6: Article 5: Equality and non-discrimination, Committee on the Rights of Persons with Disabilities, CRPD/C/GC/6, 9 mars 2018, paragrafi 10.

2. Shih: General Comment No. 3: Article 6: Women and girls with disabilities, Committee on the Rights of Persons with Disabilities, CRPD/C/GC/3, 25 November 2016, paragrafi 11. Për më shumë informacione shih: Poposka, Zh., Interpretues i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Polio Plus – Lëvizja kundër handikapit, Shkup, 2018, f. 30-31.

boruar përmbajtjen e barazisë në katër dimensione. Këto dimensione janë: (a) dimensiononi i ndershëm i rishpërndarjes me qëllim balafaqimi me mangësitë socio-ekonomike; (b) dimensiononi i njohjes për të luftuar stigmën, stereotipat, paragjykimet dhe dhunën, duke njohur dinjitetin e qenieve njerëzore dhe ndërsektorialitetin e tyre; (c) dimensiononi pjesëmarrës, me qëllim konfirmimi i natyrës sociale të njerëzve si anëtarë të grupeve shoqërore dhe njohja e humanizmit të përgjithshëm përmes përfshirjes në shoqëri; dhe (ç) dimensiononi i përshtatshmërisë që synon të krijojë hapësirë për dallimet e njerëzve si një çështje e dinjitetit njerëzor (paragrafi 11).

A e keni ditur se gjatë historisë, teoria juridike ka kuptuar barazinë në tre mënyra të ndryshme, secila duke u zhvilluar mbi tjetrën. Fillimisht si barazi formale-juridike, më pas si barazi materialo-juridike, që më në fund, pra sot, ta kuptojmë si barazi inkluzive!

Sipas Poposkës, Mihajlljoskit dhe Georgievskit, problemi i barrës së provës si institut juridik procedural është kompleks, kështu që në elaborimin e tij duhet të përfshihet një varg i çështjeve teorike dhe praktike, si nga aspekti materialo-juridik ashtu edhe nga aspekti proceduralo-juridik. Përmbajtja e detyrimit ligjor ka të bëjë me një sjellje të caktuar për subjektin, duke vepruar ose duke mosvepruar, që shprehet si një imperativ drejtuar subjektit të detyrimit për t'u sjellë në mënyrë të caktuar. Detyrimi themelor (primar) i normave juridike është të sigurojnë që rendi juridiko-civil ta përmbushë funksionin e tij, bartësit dhe bartëset e të drejtave subjektive civile dhe detyrimeve juridike të sillen në mënyrën e përcaktuar me normat juridike. Kur nuk arrihet efikasiteti primar i normave juridike, ndërsa për shkak të mungesës së vetiniciativës, vullnetarizmit dhe sjelljes spontane të subjekteve, në përputhje me normat juridike, është e nevojshme të ndërtohet një mekanizëm për mbrojtje shtesë - dytësore, përkatësisht efikasiteti me anë të ekzekutimit të tyre të detyrueshëm. Kjo arrihet përmes mekanizmit të organizuar të shtetit, nga i cili mekanizëm, me mënyrën e detyrimit, subjekti kërkon të ndërhyhet në mbrojtjen e së drejtës së tij. Këtu mund të bëhet fjalë për trajtim parandalues, të cilin e ndërmarrin subjektet e interesuara me anë të mbrojtjes jashtëgjyqësore, siç është procedura para KPMD-së, apo për trajtim represiv-restitutiv të subjekteve të interesuara, që përcaktohet në një procedurë gjyqësore (civile, kundërvajtëse, penale)...³

Për shkak të specifikës së shfaqjes së diskriminimit, në këto lëndë paraqiten mjaft vështirësi gjatë dëshmisë së tyre nëse do të përdorej barra e rregullt e provës, përkatësisht secili që pohon duhet ta provojë të njëjtën. Me qëllim të lehtësimit të provës në lidhje me trajtimin diskriminues ose efektin e normës së përcaktuar, në shikim të parë, neutral, kriteri ose praktika e caktuar, në rastet e diskriminimit lejohet të ndahet barra e provës ndërmjet parashtruesit ose parashtrueses së parashtrësës dhe personit kundër të cilit është para-

3. Shih: Poposka, Zh., Mihajlljoski, Z., Georgievski, A., Udhëzues për rolin e Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi në Procedurë Gjyqësore dhe Kalimi i Barrës së Provës, Misioni i OSBE-së në Shkup, Shkup, 2013, f. 30-31.

qitur parashtresa. Ky parim, i cili u zhvillua nga GJDBE-ja në rastet e diskriminimit në bazë të seksit siç është rasti *Danfoss*⁴ dhe rasti *Enderby*⁵, sot i ka rrënjët e thella në legjislacionin evropian kundër diskriminimit.

Në përgjithësi, ka dy arsye kryesore për shkak të të cilave e drejta e Bashkimit Evropian e rregullon kalimin e barrës së provës:

- » mbrojtja e anës më të dobët në marrëdhënien juridike dhe
- » sigurimi i aksesit në informacione si pasqyrim i parimit të barazisë së palëve në procedurë.

Mbrojtja e anës më të dobët në marrëdhënien juridike dhe kalimi i barrës së provës nga parashtruesi ose parashtruesja e parashtresës te personi kundër të cilit është paraqitur parashtresa, kontribuon në arritjen e njërit prej qëllimeve bazë të politikës evropiane për barazinë e palëve në procedurë, përkatësisht është në funksion të realizimit të mbrojtjes juridike të viktimave nga pabarazia në procedurë. GJDBE-ja konfirmon vazhdimisht në jurisprudencën e saj, se në të drejtën e Bashkimit Evropian, dimensionin social, i cili e përfshin trajtimin e barabartë, është i barabartë, madje edhe më i rëndësishëm se dimensionin ekonomik.⁶ Arsyeja e dytë ka të bëjë me aksesin në informacione. Për më tepër, pala e dëmtuar nga diskriminimi, si rregull, nuk ka qasje në informacione të rëndësishme, të cilat ndikojnë në dëshminë e cenimit të së drejtës së parimit të barazisë së procedurës, prandaj barra duhet të kalojë tek pala tjetër, e cila i posedon këto informacione, përkatësisht të dhëna, në mënyrë që viktimat të kenë në dispozicion një mjet juridik efektiv.

Standardi i kalimit të barrës së provës i rregulluar me të drejtën e Bashkimit Evropian, përkatësisht në direktivat kundërdiskriminim dhe në ato gjinore, përcakton se: “Vendet anëtare, në përputhje me sistemet e tyre gjyqësore kombëtare, ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se, në rastet kur personat që konsiderohen viktimat, meqenëse ndaj tyre nuk është zbatuar parimi i trajtimit të barabartë, para gjykatës ose para një organi tjetër kompetent, janë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka ndodhur një diskriminim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, i padituri duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë”.

Duhet të dihet!

E drejta e Bashkimit Evropian specifikon se kalimi i barrës së provës rregullohet si në mbrojtjen gjyqësore ashtu edhe në mbrojtjen jashtëgjyqësore nga diskriminimi.

Ajo që duhet të dëshmohet në rastet e diskriminimit është ekzistimi i një trajtimi ndryshe më pak të favorshëm (në rastin e diskriminimit të drejtpërdrejtë) ose i një pozicioni më pak të fa-

4. Shih: GJDBE, C-109/88, Handels- og Kontorfunktionærernes Forbund i Danmark v Dansk Arbejdsgiverforening (acting on behalf of Danfoss), [1989] ECR I-3199.

5. Shih: GJDBE, C-127/92, Enderby v Frenchay Health Authority and Secretary of State of Health, 1993 ECR I-05535.

6. Shih: GJDBE, C-80/70, Defrenne I, [1971] ECR 445; CJEU, S-50/96, Deutsche Telekom v. Schröder, [2000] ECR I-743, paragrafi 56.

vorshëm, pra një efekt (në rastin e diskriminimit të tërthortë) mbi baza diskriminuese, që nuk mund të justifikohet ose me ndonjë nga përjashtimet ekzistuese nga diskriminimi i drejtpërdrejtë, përkatësisht me masat dhe veprimet që nuk përbëjnë diskriminim, ose me testin e justifikimit objektiv të diskriminimit të tërthortë.


Kjo do të thotë se nuk është e nevojshme të përcaktohen disa fakte shoqëruese të cilat paraqiten në rastet e diskriminimit, në mënyrë që rasti të dëshmohet në aspektin juridik.

- » *Së pari*, nuk është e nevojshme të provohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur parashtresa është i/e motivuar nga paragjykimet, përkatësisht nuk ka nevojë të provohet se ekzistojnë paragjykime për personin ose grupin e përcaktuar të personave, në mënyrë që të dëshmohet rasti i diskriminimit. E drejta nuk mund t'i rregullojë qëndrimet e njerëzve sepse ato janë thjesht gjendje të brendshme. Atë që mund ta rregullojë dhe e rregullon ka të bëjë me trajtimin përmes të së cilit mund të manifestohen ato qëndrime. Për shembull, në rastin *Feryn* të shpjeguar më poshtë, edhe pse pronari ka pohuar se klientët e tij, dhe jo ai vetë, donin vetëm belgë me lëkurë të bardhë të punojnë në shtëpitë e tyre, GJDBE-ja fare nuk e ka marrë në konsideratë këtë fakt si relevant gjatë vendimarrjes lidhur me atë se a ka diskriminim në këtë rast.
- » *Së dyti*, nuk është e nevojshme të konfirmohet se një dispozitë, kriter ose praktikë e caktuar ka për qëllim, më konkretisht, të ndikojë në mënyrë të pafavorshme mbi një grup të caktuar personash. Përkundrazi, nëse konfirmohet se një dispozitë, kriter apo praktikë e caktuar është parashikuar me qëllime të mira, por megjithatë ka efekt më pak të favorshëm mbi grupin përkatës të personave, atëherë do të jetë diskriminuese. Për shembull, në rastin *D.H.*, megjithëse shteti ka konfirmuar se sistemi i shkollave speciale u krijua për të ndihmuar nxënësit romë të kapërcejnë pengesën gjuhësore dhe mungesën e arsimit parashkollor, GJEDNJ-ja ishte e mendimit se një gjë e këtillë është jorelevante dhe se për të provuar diskriminimin, duhet të përcaktohet se romët janë prekur (goditur) në mënyrë joproporcionale dhe negative në shembullin konkret në krahasim me popullsinë shumicë, dhe jo ekzistenca e një qëllimi për të diskriminuar⁷.
- » *Së treti*, sa i përket vetë legjislacionit kundërdiskriminim të Bashkimit Evropian, nuk ka nevojë të dëshmohet ekzistenca e një viktime konkrete, e cila mund të identifikohet, siç u demonstrua në rastin *Feryn*. Nga ana tjetër, sipas KEDNJ-së, nëse viktimat konkrete nuk konfirmon *locus standi*, atëherë rasti nuk do t'i përmbushte kriteret e pranueshmërisë në përputhje me nenin 34 të KEDNJ-së.⁸

7. Shih: GJEDNJ, *D.H. and Others v. the Czech Republic [GC]*, Aplikimi nr. 57325/00, 13 nëntor 2007, paragrafi 175 dhe 184.

8. Shih: European Union Agency for Fundamental Rights and Council of Europe, *Handbook on European non-discrimination law*, 2018 edition, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2018, f. 239-241.

E njëjta gjë mund të pasqyrohet në mënyrë tabelore si më poshtë.



Barra e provës është detyrim për një subjekt të caktuar procedural që të propozojë prova me të cilat do të konfirmohet vërtetësia e konfirmimit të caktuar të fakteve juridikisht relevante. Barrës së provës i paraprin barra e pohimit, e cila paraqet detyrim për subjektin e caktuar procedural para gjykatës ose para KPMD-së për t'i prezantuar pohimet për faktet mbi të cilat e mbështet kërkesën e tij/saj ose me të cilat i përgënjeshtrojnë pretendimet e palës së kundërt. Kalimi i barrës së provës ka karakter të natyrës proceduralo-juridike. Për kalimin e barrës së provës në legjislacionin tonë kombëtar, në mënyrë të prerë janë parashikuar dispozita në ligjet të cilët rregullojnë marrëdhënie të caktuara specifike shoqërore, të shpjguara më poshtë. E drejta për të kaluar barrën e provës nga parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës te personi kundër të cilit është paraqitur parashtrësia duhet të analizohet në kontekstin e vendosjes së mbrojtjes juridike në procedurë sipas parimit të trajtimit të barabartë.


Në mënyrë që barra e provës të kalojë nga viktimi (parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës) te diskriminuesi i supozuar (personi kundër të cilit është paraqitur parashtrësia), i pari, përkatësisht, e para duhet të prezantojë fakte që bëjnë të mundur se diskriminimi mund të jetë kryer, përkatësisht duhet të paraqesë një rast prima facie diskriminimi, nga i cili mund të supozohet në mënyrë të qartë probabiliteti se pikërisht tipari mbrojtës, përkatësisht baza diskriminuese, është rrethana që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në një efekt nga trajtimi, ndryshe nga të tjerët. Gjithashtu, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet të bëjë të mundshme ekzistimin e një lidhjeje kauzale midis trajtimit më pak të favorshëm ose efektit nga trajtimi dhe cënimit të shkaktuar (dëmit) ose negativitetit joproportional.

Duhet të dihet!

Fakti që një person ka një tipar të caktuar mbrojtës dhe një tjetër jo, nuk është i mjaftueshëm për të kaluar barrën e provës, sepse ky dallim do të ekzistojë gjithmonë dhe nëse pranohet si i mjaftueshëm, atëherë do të kemi gjithmonë një rast prima facie diskriminimi, ndërsa kjo paraqet një nebulozë përkatësisht mjegullnajë juridike.

Krahas ekzistencës së bazës diskriminuese, d.m.th. të një tipari të mbrojtur, për të vërtetuar prezumimin e diskriminimit, është e nevojshme të paraqitet edhe ndonjë fakt apo provë tjetër që do të tre-

gojë përdorimin e tiparit të mbrojtur, si kriter për dallimin e specifikes, pra personit në rastin përkatës. Për shembull: nëse personi me një origjinë të caktuar etnike kishte pasur kualifikime më të mira se personi tjetër ndërkaq personi tjetër është zgjedhur, ose nëse personat e tjerë lejohen të hyjnë në një restorant ndërsa vetëm romët nuk lejohen, atëherë një rast *prima facie* tashmë është i bazuar dhe barra e provës i kalon personit kundër të cilit është paraqitur parashtresa, ndaj ai/ajo duhet të provojë të kundërtën. Ose, nëse përveç aftësisë së kufizuar ekzistojnë rrethana shtesë që e vënë në dukje ekzistencën e stereotipave për personat me aftësi të kufizuara, mbi të cilat bazohet vendimi i vendimmarrësit të të njëjtit. Rrethana të këtilla janë, për shembull: komente që e vënë në dukje synimin për të diskriminuar, raste/politika të mëparshme të diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara ose ndaj një lloji të caktuar të aftësisë së kufizuar (kryesisht personat me aftësi të kufizuara mendore ose intelektuale) të kryera pikërisht nga ai person fizik ose juridik, pyetje të parashtruara në intervistë (për shembull, për llojin e aftësisë së kufizuar që ka personi përkatës), jotransparencë ose shkelje të pashpjegueshme procedurale, kërkesë për të dhëna shtesë si p.sh., ato nga kartela shëndetësore e personit në fjalë me aftësi të kufizuara dhe ngjashëm.



Me fjalë të tjera, parashtruesi ose parashtruesja e parashtresës, për të bërë një rast diskriminimi *prima facie*, duhet të tregojë lidhjen e qartë kauzale ndërmjet trajtimit të pafavorshëm dhe cenimit të shkaktuar, por edhe ndërmjet trajtimit të pafavorshëm dhe bazës diskriminuese, ndërkaq duhet ta bëjë të mundshme lidhjen kauzale ndërmjet bazës diskriminuese dhe cenimit të shkaktuar.

Sipas Poposkës, shumë shpesh, rasti *prima facie* i diskriminimit të drejtpërdrejtë në baza diskriminuese vërtetohet nëse parashtruesi ose parashtruesja e parashtresës prezanton një politikë të qartë diskriminuese të një personi të caktuar juridik ose, nga ana tjetër, një rregull që zbatohet, ndërkaq personat në fjalë i trajton ndryshe, për dallim nga të tjerët. Për shembull, nëse rezulton se në pishinë ka një praktikë që të mos pranohen persona romë dhe rome, ose në një kafe-bar të caktuar të mos pranohen persona të moshuar, apo nëse në restorant ka një rregull që të mos pranohen persona të shoqëruar nga një qen udhërrëfyes. Kjo është veçanërisht e rëndësishme edhe në dëshminë e rasteve të diskriminimit të tërthortë ku duhet të dëshmohet se një dispozitë, kriter ose praktikë, në shikim të parë neutrale, ka një efekt veçanërisht të pafavorshëm mbi një grup të caktuar personash. Nevojitet që parashtruesi ose parashtruesja e parashtresës, të dëshmojë se ky efekt joproportionalisht më pak i favorshëm është rezultat i zbatimit të dispozitës, kriterit

ose praktikës konkrete që sulmohet. Me fjalë të tjera, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet të tregojë se ekziston një marrëdhënie kauzale midis masës që sulmohet dhe disbalancit midis grupeve të ndryshme në gëzimin e një përfitimi të caktuar.⁹

Pasi barra e provës të ketë kaluar nga kërkuesi te personi kundër të cilit është paraqitur parashtrësja, ky i fundit mund të refuzojë prezumimin e diskriminimit nëse vërteton se kërkuesi nuk është në të vërtetë në një situatë të ngjashme me komparatorin e tij, ose nëse vërteton se trajtimi i ndryshëm nuk bazohet në tiparin e mbrojtur, por në bazë të një dallimi tjetër objektiv. Nëse personi kundër të cilit është paraqitur parashtrësja nuk arrin ta hedhë poshtë parashtrësën për diskriminimin e kryer në njërin nga këto dy mënyra, atëherë ai/ajo do të duhet të arsyetojë trajtimin ndryshe/efektin e ndryshëm, duke dëshmuar se një gjë e këtillë është objektivisht e justifikuar dhe proporcionale. Përkatësisht, në rastet e krijimit të diskriminimit *prima facie*, personi kundër të cilit është paraqitur parashtrësja duhet të dëshmojë se dallimi përkatës me bazë diskriminimin synon të arrijë qëllimin, i cili është objektiv dhe i justifikuar, ndërkaq dallimi është përkatës dhe i nevojshëm për të arritur atë qëllim.

Si përfundim, do të theksojmë se kur bëhet fjalë për barrën e provës, duhet të kemi parasysh tri gjëra, si vijon:

- » *Së pari*, legjislacioni kombëtar është ai që përcakton se cilat lloje të fakteve/provave janë të pranueshme dhe të nevojshme që të prezantohen para gjykatave kombëtare dhe autoriteteve të tjera kompetente dhe se si do të nxirren ato, ndërsa kjo mund të përcaktohet në mënyrë më të prerë për dallim nga GJEDNJ-ja ose GJDBE-ja.
- » *Së dyti*, rregullat e kalimit të barrës së provës nuk zbatohen në procedurën penale kur shteti ndjek autorët ose autorët e veprave penale të motivuara nga urrejtja ose dhuna me bazë gjinore për shkak të nivelit më të lartë të provës për përcaktimin e përgjegjësisë penale.¹⁰
- » *Së treti*, shtetet mund të përcaktojnë që rregullat e kalimit të barrës së provës të mos zbatohen në rastet kur gjykatat apo organet e tjera kompetente kryejnë veprime hetuese, për shkak të parimit të prezumimit të pafajësisë, por edhe për shkak të parimit të objektivitetit dhe paanshmërisë.

A e keni ditur se e drejta e Bashkimit Evropian ia lë çdo shteti ta rregullojë vetë çështjen e kalimit të barrës së provës? Për shembull, legjislacioni kundër diskriminimit i Francës dhe Belgjikës parashikon se rregullat e veçanta në lidhje me kalimin e barrës së provës janë të zbatueshme, përveç në procedurat juridike civile dhe në procedurat juridike administrative.

9. Shih: Poposka, Zh., Diskriminimi në bazë të handikapit në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" – Shkup, Fakulteti Juridik "Justiniani I" 2012, f. 47-52.

10. Shih: European Union Agency for Fundamental Rights and Council of Europe, Handbook on European non-discrimination law, 2018 edition, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2018, f. 236.





STANDARDE NDËRKOMBËTARE DHE KOMBËTARE PËR KALIMIN E BARRËS SË PROVËS

Parimi i kalimit të barrës së provës është sanksionuar në të drejtën e Bashkimit Evropian dhe në praktikën gjyqësore të GJDBE-së, prej ku e ka origjinën ky institut juridik procedural, por edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të shpjeguar më poshtë. Edhe Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale i themeluar nga Karta Sociale Evropiane e Këshillit të Evropës, gjithashtu, në disa raste që janë shqyrtuar para tij, përcakton se në rastet e diskriminimit barra e provës nuk duhet të jetë tërësisht në anën e parashtruesit ose parashtrueses, por duhet të jetë objekt i përshtatjes përkatëse¹¹. Sipas Manualit të së Drejtës Evropiane për Mosdiskriminimin, kjo praktikë respektohet nga Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore si dhe nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor pranë Kombeve të Bashkuara. Për më tepër, Komisioni për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore vuri në dukje se “në rastet kur faktet dhe ngjarjet në fjalë janë tërësisht ose pjesërisht në dijeni ekskluzive të autoriteteve ose organeve të tjera përgjegjëse, barra e provës duhet të konsiderohet si përgjegjësi e autoriteteve ose e organeve të tjera përgjegjëse, në mënyrë përkatëse”¹².

1.

E drejta e Bashkimit Evropian

Siç u tha edhe më lart, kalimi i barrës së provës u shfaq për herë të parë në praktikën gjyqësore të GJDBE-së në rastet e pagës së barabartë për të njëjtën punë dhe punë me të njëjtën vlerë, përkatësisht në rastet e diskriminimit të drejtpërdrejtë në bazë të gjinisë. Ekzistimin e këtij instituti juridik Gjykata e lidh ngushtë me krijimin e supozimeve për zbatimin efektiv të parimit të trajtimit të barabartë. Me fjalë të tjera, duhet të merren parasysh dy parime juridike të së drejtës së Bashkimit Evropian, njëri është parimi i efektivitetit, sipas të cilit materialet dhe garancitë procesore për ndërmarrjen e veprimeve për zbatimin e së drejtës së Bashkimit Evropian nuk guxon të vendosen në mënyrë që do ta pamundësonte aplikimin konform së drejtës së rregulluar me legjislacionin e Bashkimit. Në këtë drejtim, GJDBE-ja në rastin Comet BV¹³ thekson qartë se legjislacioni kombëtar i parashikon kushtet procedurale për mbrojtjen e të drejtave të garantuara me legjislacionin e Bashkimit nëse ato nuk janë diskriminuese dhe nëse nuk i pengojnë njerëzit t'i aplikojnë ato në praktikë. Parimi i dytë është parimi i mbrojtjes efektive gjy-

11. Shih: EKSP, Associazione Nazionale Giudici di Pace v. Itali, Aplikimi nr. 102/2013, 5 korrik 2016, paragrafi 73; EXP, SUD Travail Affaires Sociales, SUD ANPE dhe SUD Collectivité Territoriales v. France, Aplikimi nr. 24/2004, 8 nëntor 2005; EKSP, Mental Disability Advocacy Centre (MDAC) v. Bullgaria, Aplikimi nr. 41/2007, 3 qershor 2008.

12. Shih: European Union Agency for Fundamental Rights and Council of Europe, Handbook on European non-discrimination law, 2018 edition, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2018, f. 239.

13. Shih: GJDBE, C-45/76, Comet v. Produktschop voor Siergewassen, [1975] ECR 2043.

qësore. Së këtejmi, në rastin *San Giorgio*,¹⁴ Gjykata vlerësoi se nuk është e përshtatshme t'i imponohet barra e provës parashtruesit ose parashtrueses, sepse në atë rast do të ishte krejtësisht i pamundur realizimi i të drejtave të garantuara me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Mund të konkludojmë se në juridiksionin e tij, në mënyrë të qartë specifikon se pa e ndarë barrën e provës midis dy palëve në kontest, nuk ka parakushte për zbatimin në praktikë të parimit të barazisë dhe ndalimit të diskriminimit. Rastet nuk do të mund të provohen ndërsa me këtë edhe praktika nuk do të ndryshonte. Prandaj, Bashkimi Evropian fillimisht në një Direktivë të veçantë, Direktivën 97/80/EC të Këshillit për barrën e provës në rastet e diskriminimit gjinor,¹⁵ ndërsa pastaj edhe në dy direktivat kundër diskriminimit të vitit 2000¹⁶ kurse në direktivat gjinore¹⁷ e parashikon në mënyrë të prerë këtë institut proceduralo-juridik. Në pikat 8 dhe 18 të preambulës së Direktivës 97/80/EC specifikohet se kalimi i barrës së provës është në funksion të arritjes së mbrojtjes juridike të viktimave nga pabarazia në procedurë.

Akti juridik	Neni
<i>Direktiva 2000/78/EC e Këshillit për vendosjen e kornizës së përgjithshme për veprim të barabartë gjatë punësimit dhe aksesit në kryerjen e një profesioni të caktuar</i>	neni 10
<i>Direktiva 2000/43/EC e Këshillit për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të personave pavarësisht origjinës racore dhe etnike</i>	neni 8
<i>Direktiva 2004/113/EC e Këshillit për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave gjatë aksesit dhe furnizimit me mallra dhe shërbime</i>	neni 9
<i>Direktiva 2006/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe kryerjes të një profesioni të caktuar (versioni i konsoliduar)</i>	neni 19

14. Shih: GJDBE, C-199/82, Amministrazione delle Finanze della Stato v. SpA San Giorgio, [1983] ECR 3595.

15. Shih: Council Directive 97/80/EC of 15 December 1997 on the burden of proof in cases of discrimination based on sex, OJ L 14, 20.1.1998.

16. Shih: Council Directive 2000/43/EC of 29 June 2000 implementing the principle of equal treatment between persons irrespective of racial or ethnic origin, OJ L 180, 19.7.2000; Council Directive 2000/78/EC of 27 November 2000 establishing a general framework for equal treatment in employment and occupation, OJ L 303, 2.12.2000.

17. Shih: Directive 2006/54/EC of the European Parliament and of the Council of 5 July 2006 on the implementation of the principle of equal opportunities and equal treatment of men and women in matters of employment and occupation (recast), OJ L 204, 26.7.2006; Council Directive 2004/113/EC of 13 December 2004 implementing the principle of equal treatment between men and women in the access to and supply of goods and services, OJ L 373, 21.12.2004.

A e keni ditur se rastet e para në të cilat u konstatua nevoja për kalimin e barrës së provës ishin në lidhje me diskriminimin në bazë të seksit dhe kishin të bënin me pagën e barabartë për të njëjtën punë dhe punën me vlerë të njëjtë midis burrave dhe grave.

2.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Nga ana tjetër, ndryshe nga e drejta kundërdiskriminim e Bashkimit Evropian, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më tej në tekst: KEDNJ ose Konventa) nuk e njeh shprehimisht dispozitën për kalimin e barrës së provës. Kur GJEDNJ-ja i shqyrton rastet nga aspekti i provave, Gjykata zakonisht e zbaton parimin *affirmanti incumbit probatio*, përkatësisht se parashtruesi ose parashtruesja duhet të provojë pohimin e tij/saj. Gjykata zbaton standardin e provës “jashtë dyshimit të arsyeshem” si standard i zakonshëm për të gjitha të drejtat e përcaktuara me Konventën. Në procedurën para GJEDNJ-së, nuk ekzistojnë pengesa procedurale për pranueshmërinë e provave apo për formula paraprakisht të paracaktuara mbi të cilat bazohet vlerësimi i tyre. Gjykata i miraton konkluzionet të cilat, sipas saj, mbështeten nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave, përfshirë edhe konkluzionet që mund të rezultojnë nga faktet dhe ankesat e palëve në procedurë.

Megjithatë, barra e provës zbatohet nga GJEDNJ-ja, gjë që shihet edhe nga praktika gjyqësore e saj. Për shembull, kur ngjarjet në fjalë, të cilat janë objekt shqyrtimi, janë tërësisht, ose në një pjesë të madhe, brenda kuadrit të njohurive ekskluzive të autoriteteve, barra e provës mund të konsiderohet se u përket autoriteteve për të dhënë një shpjegim të kënaqshëm dhe bindës (*Rasti Salman, rasti Angelova, rasti Makuchyan dhe Minasyan*)¹⁸. Gjykata, nga ana tjetër, e kaloi barrën e provës edhe në raste të tjera, ndërkaq në praktikë do të ishte jashtëzakonisht e vështirë për parashtruesin ose parashtruesen që të provojë diskriminimin (*rasti Cînta*).¹⁹

GJEDNJ-ja i shqyrton provat e paraqitura si tërësi, për faktin se në shumicën e rasteve janë shtetet ato që i posedojnë informacionet (faktet dhe provat) me të cilat mund të konfirmohet kërkesëpadia në fjalë. Kjo do të thotë, nëse faktet e prezantuara nga parashtruesi ose parashtruesja Gjykata i konsideron si autentike dhe konsistente me provat e tjera të prezantuara, GJEDNJ do t'i pranojë ato si të provuara, përveç nëse shteti nuk është në gjendje të prezantojë një shpjegim tjetër autentik. Gjykata do t'i pranojë si fakte ato pretendime që “mbështeten nga një vlerësim i lirë i të gjitha provave, përfshirë këtu edhe ato pohime, të cilat rezultojnë nga faktet dhe

18. Shih: GJEDNJ, *Salman k. Turqi* [GC], Aplikimi nr. 21986/93, 27 qershor 2000, paragrafi 100; GJEDNJ, *Angelova v. Bullgari*, Aplikimi nr. 38361/97, 13 qershor 2002, paragrafi 111; GJEDNJ, *Makuchyan and Minasyan v. Azerbaijan and Hungary*, Aplikimi nr. 17247/13, 26 maj 2020. Për më shumë informacione shih: Council of Europe/European Court of Human Rights, Guide on Article 14 of the European Convention on Human Rights and on Article 1 of Protocol No. 12 to the Convention, Prohibition of discrimination, Strasbourg, updated on 31 August 2022, f. 21-23.

19. Shih: GJEDNJ, *Cînta k. Rumani*, Aplikimi nr. 3891/19, 18 shkurt 2020.

ankesat e palëve..., prova mund të rezultojë nga bashkekzistenca e pohimeve mjaftueshëm të fuqishme, të qarta dhe të qëndrueshme ose nga supozime të ngjashme faktike të pakontestuara. Nga ana tjetër, niveli i bindjes, i nevojshëm për të arritur një konkluzion të caktuar, në këtë drejtim, dhe ndarja e barrës së provës, janë ngushtë të lidhura me veçantinë e fakteve, natyrën e pretendimeve të paraqitura dhe me të drejtat e KEDNJ-së që janë vënë në pikëpyetje” (GJEDNJ, rasti Nachova, rasti Timishev, rasti D.H.).²⁰

Duhet të dihet!

Edhe pse KEDNJ-ja nuk e përmend në mënyrë eksplicite kalimin e barrës së provës, prapëseprapë ai zbatohet nga gjykata përmes praktikës së saj gjyqësore.

Lexo më tepër!

Në Manualin mbi të drejtën evropiane për mosdiskriminim (Handbook on European non-discrimination law) për standardet evropiane kundër diskriminimit.

3.

Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi

Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi²¹ pritet të plotësojë vakumin ligjor që ekziston në sistemin tonë juridik në fushën e mosdiskriminimit, si dhe të mundësojë mbrojtje më të lehtë juridike për të gjithë personat që do të paraqiteshin si viktimat të supozuara të diskriminimit. Prej nenit 14 deri në nenin 31 ligji parasheh themelimin e një organi për barazi - Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi dhe rregullon procedurën para tij. Sistemi kombëtar parashikon tri procedura që mund të zhvillohen në rastet e diskriminimit të pretenduar, si vijon: procedura administrative (para Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi në përputhje me nenet prej 23 deri në nenin 31 të LPMD-së dhe para Avokatit të Popullit në përputhje me nenin 13 deri në nenin 27 të Ligjit për Avokatin e Popullit²²), procedura kontestimore (në përputhje me nenin 32 deri në nenin 40 të LPMD-së) dhe procedura kundërvajtëse (në përputhje me nenin 41 deri në nenin 44 të LPMD-së).

Për sa i përket dispozitave procedurale, kalimi i barrës së provës në mënyrë të prerë përcaktohet me LPMD-në, si në proceset gjyqësore ashtu edhe në ato jashtëgjyqësore. Me fjalë të tjera, neni 37 përcakton se: paditësi ose paditësja, i cili/e cila pohon se është kryer diskriminim në përputhje me dispozitat e LPMD-së, e ka për

20. Shih: GJEDNJ, Nachova and Others v. Bullgari [GC], Aplikacionet nr. 43577/98 dhe 43579/98, 6 korrik 2005, paragrafi 147; GJEDNJ, Timishev v. Rusi, Aplikacionet nr. 55762/00 dhe 55974/00, 13 dhjetor 2005, paragrafi 39 dhe GJEDNJ, D.H. and Others v. the Czech Republic [GC], Aplikimi nr. 57325/00, 13 nëntor 2007, paragrafi 178. Për më shumë informacione shih: European Union Agency for Fundamental Rights and Council of Europe, Handbook on European non-discrimination law, 2018 edition, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2018, f. 233.

21. Shih: Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, «Gazeta Zyrtare e RMV», nr. 258/2020.

22. Shih: Ligji për Avokatin e Popullit, «Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë», nr. 60/03, 114/09, 181/16, 189/16 dhe 35/2018.

detyrë t'i prezantojë faktet të cilat pohimin e bëjnë të mundshëm, kurse pastaj barra e provës i kalon të paditurit ose të paditurës që të provojë se nuk ka diskriminim (paragrafi 1). Në mënyrë plotësuese duke specifikuar se kjo dispozitë nuk zbatohet në procedurën kundërvajtëse dhe atë penale (paragrafi 2).

Kalimi i barrës së provës rregullohet edhe në procedurë para LPMD-së.

Neni 26 i LPMD-së

Parashtruesi/parashtruesja i/e parashtresës i cili/e cila pohon se në përputhje me dispozitat e këtij ligji është kryer diskriminim, e ka për detyrë t'i paraqesë të gjitha faktet që pohimin e bëjnë të mundshëm. Në qoftë se Komisioni konstaton se pohimi është i mundshëm, atëherë barra e provës i kalon personit kundër të cilit është paraqitur parashtresa.

Të dyja dispozitat që kanë të bëjnë me kalimin e barrës së provës janë plotësisht në përputhje me standardet kundër diskriminimit, veçanërisht me të drejtën e Bashkimit Evropian. Megjithatë, sipas Kocevskit, nga zbatimi i deritanishëm i rregullit për kalimin e barrës së provës, në praktikë ka një pabarazi sa i përket trajtimit të gjykatave. Në më shumë se gjysmën e vendimeve të analizuara gjyqësore, gjykatat nuk deklarohen fare në lidhje me barrën e provës madje këtë rregull nuk e zbatojnë, gjë që në masë të konsiderueshme e vështirëson qasjen në një procedurë gjyqësore efektive për mbrojtje nga diskriminimi. Arsyet për trajtimin e këtyllë janë trajnimet e pamjaftueshme, si dhe aktiviteti i dobët i gjykatave më të larta në arritjen e zbatimit të barabartë të ligjeve.²³

Nga ana tjetër, nga analiza e opinioneve të KPMD-së, vërehet se Komisioni në përgjithësi, i ndjek elementet e kalimit të barrës së provës ndërkaq vendimin e tij e mbështet në zbatimin e këtij rregulli procedural.

Duhet të dihet!

Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi e parasheh kalimin e barrës së provës në mënyrë eksplicite, si në procedurën gjyqësore ashtu edhe në atë jashtëgjyqësore, para Komisionit të Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi, ndërsa në këtë pjesë është plotësisht në përputhje me standardet kundërdiskriminim, veçanërisht me të drejtën e Bashkimit Evropian.

23. Shih: Kocevski, G., Kalimi i barrës së provës në procedurat gjyqësore për mbrojtjen nga diskriminimi, Analiza dhe rekomandimet për avancimin e efektivitetit të mbrojtjes gjyqësore nga diskriminimi, dokument i politikave publike, Koalicioni «Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të margjinalizuara» MARGINI Shkup, Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi, Shkup, 2020, f. 7.





ELEMENTET DHE FAZAT E KALIMIT TË BARRËS SË PROVËS NË PRAKTIKË

Kalimi i barrës së provës nga parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës te personi kundër të cilit është paraqitur parashtrësja, si instrument procedural, i cili duhet të rrisë efikasitetin e mbrojtjes kuazigjyqësore kundër diskriminimit, si rregull kalon nëpër disa faza të procedurës, si vijon: parashtrimi i parashtrësës, përgjigjja ndaj parashtrësës dhe dëshmia dhe paraqitja e provave.

Autoriteti kompetent, në këtë rast KPMD-ja, gjatë trajtimit, ia parashtron detyrën vetvetes të sigurojë informacionet për të vërtetën, gjendjen faktike, në bazë të së cilës merr vendim të duhur, përkatësisht miraton opinionin. Sipas kësaj, Komisioni i përcakton faktet kontestuese ndërmjet palëve, bazuar në faktet dhe provat e propozuara në të gjitha fazat e procedurës.

Në procedurën gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi zbatohet Ligji për procedurë kontestimore²⁴ (në tekstin e mëtejshëm: LPK), ashtu si edhe në procedurat e tjera civile, gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave të përcaktuara në parashtrësë, ndërkaq palët e kanë për detyrë t'i nxjerrin të gjitha faktet me të cilat përcaktohen ato fakte, ndërsa për atë se cilat fakte do t'i konsiderojë si të provuara, vendos gjykata sipas bindjes së saj, duke u bazuar në një vlerësim të ndërgjegjshëm dhe të kujdesshëm të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, dhe bazuar në rezultatet e procedurës së përgjithshme.

Sipas LPMD-së, njëra nga kompetencat e KPMD-së është trajtimi i parashtrësave, miratimi i opinioneve, rekomandimeve dhe konkluzioneve për raste konkrete të diskriminimit (neni 21 paragrafi 1 alineja 14), por edhe inicimi i procedurës për mbrojtje nga diskriminimi sipas detyrës zyrtare (neni 21 paragrafi 1 alineja 15) nëse nga rrethanat dhe faktet, si dhe nga njohuritë e pranuar nga informacioni-dyshimi i bazuar, rezulton se një organ kompetent ka kryer diskriminim në përputhje me bazat diskriminuese (neni 23 paragrafi 4). Së këtejmi, ndryshe nga Gjykata, Komisioni mund të vendosë më gjerë se kërkesa e parashtrësës, përkatësisht gjatë analizës së të gjitha fakteve dhe provave, mund të gjejë diskriminim të plotë dhe formë apo strukturë të ndryshme, si dhe bazë ose baza të ndryshme diskriminuese nga ajo që ishte përcaktuar fillimisht në parashtrësë, të cilën gjë KPMD-ja ia bën shpesh.

²⁴ Shih: Ligji për procedurë kontestimore, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 79/2005, 110/2008, 83/2009, 116/2010 dhe 124/2015.

Shembull: Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi në rastin nr. **0801 -278**,²⁵ në të cilin bëhet fjalë për një parashtruese të parashtrësës, e cila ka pretenduar diskriminim në bazë të statusit personal ose shoqëror dhe gjendjes civile apo familjare kundër portalit të internetit, i cili ka publikuar tekste me përmbajtje të pavërtetë dhe shqetësuese ndaj saj, pas kalimit të barrës së provës dhe gjatë analizës së të gjitha fakteve dhe provave në rastin në fjalë, ka konstatuar ngacmim në bazë të seksit, gjinisë, gjendjes civile dhe statusit personal dhe shoqëror (KPMD, rasti nr. **0801-278**).

1.

Elemente të rastit prima facie të diskriminimit

Barra fillestare e provës i përket parashtruesit ose parashtrueses së parashtrësës, me sa duket, që të vërtetojë se ekziston rast i diskriminimit, përkatësisht të tregojë ekzistencën e rastit prima facie të diskriminimit. Një gjë të këtillë e bën duke paraqitur fakte, madje edhe atje ku ka edhe prova, të cilat vënë në dukje atë se diskriminimi ka të ngjarë të ketë ndodhur, përkatësisht të cilat çojnë në krijimin e prezumimit të diskriminimit. Për më tepër, kjo e përfshin specifikimin dhe përshkrimin e ngjarjeve, veprimeve, marrëdhënieve ndërmjet palëve për shkak të të cilave parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës konsideron se është kryer diskriminimi. Kjo kërkohet për të shmangur akuzat e pajustificuara ose të pjeshme për diskriminim të kryer, të pabazuara në kurrfarë faktesh relevante.

Shembull: Rasti **Belov**,²⁶ në të cilin pohohet se ka diskriminim në bazë të përkatësisë etnike. Përfaqësuesja e përgjithshme e GJDBE-së Kokot thekson në opinionin e saj se për të kaluar barrën e provës nuk nevojitet asgjë më shumë se një “supozim” diskriminimi dhe çdo interpretim më i rreptë do të rrezikonte nevojën e efikasitet praktik dhe do të nënkuptonte se rregulli në fjalë do të ishte i panevojshëm. Me fjalë të tjera, nevojitet prezumim dhe jo konkluzion apo provë e qartë për diskriminim të kryer.

Parimi zbatohet në mënyrë të barabartë në rastet e të gjitha formave dhe llojeve të diskriminimit, përkatësisht edhe në rastet e diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë (neni 8), si dhe referimit, nxitjes dhe instruksioneve për diskriminim (neni 9), ngacmimit (neni 10), viktimizimit (neni 11), segregimit (neni 12) si dhe në rastet e formave më të rënda të diskriminimit (neni 13), të shpjeguara më poshtë. Gjithashtu, sepse LPMD-ja nënkupton se edhe parandalimi i përshtatjes adekuate dhe pamundësimi i aksesit dhe disponueshmërisë së infrastrukturës, mallrave dhe shërbimeve konsiderohet si diskriminim (neni 6), parimi i kalimit të barrës së provës zbatohet edhe në këto raste.

25. Shih: Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, nr. 0801-278, 5 korrik 2021.

26. Shih: GJDBE, C-394/11, Belov v CHEZ Elektro Bulgaria AG [2013] 2 CMLR 29.

Neni 5 i LPMD-së

Ndalohet çdo diskriminim në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës kombëtare ose etnike, seksit, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, përkatësisë në një grup të marginalizuar, gjuhës, kombësisë, origjinës sociale, arsimit, fesë ose besimit fetar, bindjes politike, besimit tjetër, aftësisë së kufizuar, moshës, gjendjes familjare ose civile, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, cilësisë personale dhe statusit shoqëror ose mbi ndonjë bazë tjetër (në tekstin në vijim: baza e diskriminimit).

Baza dhe fusha e diskriminimit


Është me rëndësi të apostrofohet dallimi midis bazës dhe fushës së diskriminimit. Fusha e diskriminimit është një sferë në të cilën ndodh trajtimi i pabarabartë i paligjshëm. Këto mund të jenë: marrëdhëniet e punës, arsimi, mallrat dhe shërbimet, strehimi, kujdesi shëndetësor, kujdesi social etj.

Kuptimi i fushës së diskriminimit është i rëndësishëm për të kuptuar fushëveprimin e mbrojtjes nga diskriminimi mbi një bazë të caktuar, në varësi të fushës. Një bazë mund të mbrohet (1) në një fushë (për shembull, baza “mosha” mund të mbrohet vetëm në fushën “punësimi”), (2) në disa fusha (për shembull, “orientimi seksual” mund të mbrohet në shëndetësi dhe në marrëdhëniet e punës), ose (3) në të gjitha fushat ku për një gjë të këtyllë ekziston bazë ligjore (siç është rasti me nenin 3 paragrafin 2 të LPMD-së, i cili për fushë të veprimit specifikon disa sfera dhe përfundon me “dhe të gjitha fushat e tjera”).²⁷


1.1.

Diskriminimi i drejtpërdrejtë


Në rastet e diskriminimit të drejtpërdrejtë, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet të bëjë prezumim të diskriminimit, duke treguar:



trajtim të pafavorshëm të kryer me veprim ose mosveprim,



ekzistim të bazës diskriminuese dhe të lidhjes kauzale ndërmjet bazës diskriminuese dhe trajtimit më pak të favorshëm, përkatësisht duhet të tregojë se i vetmi shpjegim racional për dallimin gjatë trajtimit është tipari i mbrojtur i viktimës në përputhje me nenin 5 të LPMD-së, dhe



një komparator, përkatësisht një situatë krahasuese.

²⁷ Kotevska, B., Udhëzues për bazat e diskriminimit, Misioni i OSBE-së në Shkup dhe Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi, Shkup, 2013, f. 12.

Për sa i përket elementit të parë, ekzistimi i një trajtimi të pafavorshëm të kryer me veprim ose mosveprim, më pak të favorshëm, në përputhje me përkufizimin e diskriminimit nga LPMD-ja (neni 6), KPMD-ja e shqyrton ekzistencën e çdo dallimi, përjashtimi, kufizimi ose dhënie përparësie, me veprim ose mosveprim, që kanë për qëllim si rezultat parandalimin, kufizimin, njohjen, gëzimin ose ushtrimin e të drejtave dhe lirive të një personi të caktuar ose grupi të personave të caktuar mbi bazë të barabartë me të tjerët. E gjithë kjo duhet të mbështetet mbi një bazë apo baza të diskriminimit (elementi i dytë).

Parashtruesi ose parashtruesja e parashtresës mund të pohojë diskriminim në bazë të diskriminimit, përkatësisht tiparit të mbrojtur nëse e posedon realisht, ose nëse personi kundër të cilit është paraqitur parashtresa ka menduar se e posedon (sipas perceptimit) dhe vetëm për këtë shkak ai/ajo është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, ose nëse është diskriminuar nga asociacioni për shkak të shoqërimit me një person ose me grup personash që e ka/kanë tiparin e mbrojtur. Gjithashtu, një person në të njëjtën kohë mund të diskriminohet edhe mbi disa baza diskriminuese (diskriminim i shumëfishtë).

Kur bëhet fjalë për ekzistimin e bazës diskriminuese, sipas Freedman, mund të veçohet një listë e karakteristikave të cilat Komisioni mund t'i shqyrtojë në mënyrë që të përcaktohet nëse një karakteristikë ose status i caktuar a mund të konsiderohet i mbrojtur, nëse nuk përmendet në mënyrë eksplicite ndërkaq mund të përcaktohet me “në bazë tjetër”:

- » *Pandryshueshmëria, zgjedhja dhe autonomia*: A kanë mundësi personat ta ndryshojnë karakteristikën apo statusin me të cilët ka të bëjë trajtimi i pabarabartë? Meqë karakteristika ose statusi i këtyre shprehë janë gjenetik ose të pandryshueshëm, shkelja e ndalimit të diskriminimit duhet të konsiderohet si veçanërisht serioze.
- » *Aksesi në proceset politike*: A është ose a ka qenë personi apo grupi i marginalizuar në proceset politike? Mungesa e këtyre personave apo grupeve në proceset, ku miratohen ligjet me të cilët (veç tjerash) rregullohen edhe të drejtat dhe mbrojtja e tyre, mund të konsiderohen si shkas për t'u dhënë mbrojtje.
- » *Dinjiteti (trajtimi i personave si pjesëtarë më pak të vlefshëm të shoqërisë)*: Trajtimi i pabarabartë, i bazuar në tiparin apo statusin personal, rezulton me cenimin e dinjitetit të atij personi, apo i dëmton këta persona dukshëm më shumë për dallim nga të tjerët.
- » *Historiku i trajtimit të pabarabartë*: A është personi pjesëtar i një grupi që mund të konsiderohet se në një periudhë të gjatë kohore i është nënshtruar trajtimit të pabarabartë ose paragjytimeve.²⁸

Kur bëhet fjalë për elementin e tretë, pra komparatorin, KPMD-ja ndonjëherë mund të përdorë edhe një komparator hipotetik nëse nuk mund të identifikojë një komparator real. Në rastet kur përdor-

28. Shih: Fredman, S., *Discrimination Law*, (2nd edn), Oxford University Press, 2011, f. 110-139. Në mënyrë plotësuese shihni edhe: Kotevska, B., *Udhëzues për bazat e diskriminimit*, Misioni i OSBE-së në Shkup dhe Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi, Shkup, 2013, f. 8-9.

et një komparator hipotetik, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet ta bëjë të duket e besueshme se një komparator real nuk është i domosdoshëm.

Shembull: *Kur një pacient ose paciente bën komente raciste, të cilat ia adreson teknikut/es mjekësor/e që i përket një bashkësie etnike, mjafton që teknik/u/ja të tregojë se pacienti ose pacientja i ka bërë këto komente raciste, së këtejmi pa treguar se ato nuk i janë adresuar ndonjë teknik/u/es tjetër mjekësor/e që i përket bashkësisë etnike shumicë.*

Po kështu, nuk kërkohet një komparator në rastet kur mund të identifikohet qëllimi diskriminues (edhe pse qëllimi nuk është element përbërës i asnjë forme të diskriminimit) nëpërmjet deklaratave publike të pakundërshtueshme të bëra nga personi kundër të cilit është paraqitur parashtrësja, KPMD-ja e ndjek të njëjtën logjikë të të menduarit, e cila mund të shihet në praktikën e tyre të procedimit të parashtrësëve, që kanë të bëjnë me fushën e medias dhe informimit publik, që korrespondojnë me postimet në internet dhe mediat sociale, me çrast me parashtrësën paraqiten edhe postimet të cilat vetvetiu, pa pasur nevojë për një komparator, krijojnë prezumim të diskriminimit. Në këto raste, KPMD-ja kalon barrën e provës nga parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës te personi kundër të cilit është paraqitur parashtrësja për ta provuar të kundërtën.

Shembull: *Në rastin Feryn, i cili ka të bëjë me diskriminimin e drejtpërdrejtë në bazë të përkatësisë etnike, GJDBE-ja konstatoi se ekziston një rast **prima facie** diskriminimi me ekzistencën e deklaratës publike të pronarit të kompanisë se ai nuk do të punësojë marokenë (GJDBE, rasti Feryn).²⁹*

Ligji federal belg për luftimin e disa formave të diskriminimit përmban shembuj të fakteve që lejojnë krijimin e një prezumimi të diskriminimit të drejtpërdrejtë, duke theksuar në mënyrë specifike dy lloje faktesh, përkatësisht:

- » *Së pari*, elemente që demonstrojnë një përsëritje të caktuar të trajtimit të pafavorshëm të kryer me veprim ose mosveprim më pak të favorshëm ndaj personave që ndajnë një karakteristikë të caktuar të mbrojtur e të përbashkët, si p.sh., raportime të përsëritura për diskriminim drejtuar organit të barazisë ose organizatave qytetare kundër diskriminimit.
- » *Së dyti*, elemente që konfirmojnë se gjendja e parashtruesit ose parashtrueses së parashtrësës është e krahasueshme me atë të personit që nuk e posedon tiparin e mbrojtur në fjalë kurse ai/ajo është trajtuar në mënyrë të pafavorshme.³⁰

KPMD-ja në procedurën përpara saj, është ai që vendos se cilat janë faktet që e bëjnë të mundshëm pretendimin për ekzistimin e

29. Shih: GJDBE, C-54/07, Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding v. Firma Feryn NV, 10 korrik 2008.

30. Shih: Ringelheim, J., The burden of proof in anti-discrimination proceedings. A focus on Belgium, France and Ireland, in European equality law review, European network of legal experts in gender equality and non-discrimination, Publications Office of the European Union, Luxembourg, 2019, f. 53.

diskriminimit, përkatësisht ekzistimin e rastit *prima facie* të diskriminimit, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe praktikën. Të njëjtin qëndrim e konfirmojnë edhe GJDBE-ja dhe GJEDNJ-ja në procedurat para tyre, duke konsideruar se gjykatat kombëtare dhe organet e tjera relevante janë ato që vendosin për këto fakte.

Provat që mund t'i paraqesë parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës mund të jenë të drejtpërdrejta ose të tërthorta. Provat e drejtpërdrejta janë ato që mundësojnë përcaktimin e fakteve pa kërkuar nga KPMD-ja të nxjerrë konkluzione në lidhje me të njëjtat, ndërkohë që provat e tërthorta janë vetëm një pjesë e enigmës të cilën KPMD-ja duhet ta zgjidhë në përputhje me rregullat e logjikës.³¹

Duke marrë parasysh natyrën e objektit të parashtrësës, mjetet provuese që mund të përdoren në procedurë do të ishin:

- » dokumentet, nëse kanë përmbajtje që lidhet me diskriminimin ose kanë të bëjnë me rastin konkret të parashtrësës,
- » raportet dhe analizat nga burime relevante,
- » dëshmitarët e trajtimit diskriminues,
- » ekspertiza për dëmin material dhe jomaterial për shkak të diskriminimit të kryer,
- » materialet dhe regjistrimet audio dhe video, të regjistruara në përputhje me ligjin,
- » prova të tjera me shkrim, fragmente artikujsh, postime në rrjetet sociale, etj.,
- » marrja në pyetje e palëve,
- » të dhëna statistikore,
- » testimi i situatës,
- » prova të tjera që do të ishin relevante në rastin e caktuar konkret, ndërsa KPMD-ja konsideron se duhet t'u kushtohet vëmendje.

Për shembull, kur bëhet fjalë për sjelljen e një vendimi në lidhje me përzgjedhjen bazuar në një shpallje të publikuar ose një konkurs, mund të bëhet fjalë vetëm për prova me shkrim, të cilat i ka në dispozicion personi kundër të cilit është paraqitur parashtrësja. Nëse, nga ana tjetër, bëhet fjalë për diskriminim ndaj parashtruesit ose parashtrueses së parashtrësës, i/e cili/a është në marrëdhënie pune te punëdhënësi, varësisht nga natyra e vendimit, gjatë procedurës para KPMD-së është e mundur të merren parasysh edhe deklaratat e dëshmitarëve në lidhje me diskriminimin e mundshëm. Dëshmitarët duhet të propozohen nga parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës me vetë parashtrësën ose gjatë procedurës.

Shembull: Në një rast para Gjykatës së Shkallës së Parë të Brukselit, në të cilën një çift belg me origjinë imigrante kanë pohuar se ka pasur diskriminim në bazë të përkatësisë etnike për shkak të pamundësisë për të marrë me qira një apartament, pas fakteve të paraqitura dhe deklaratave të dëshmitarëve, gjykatat konsideron se është bërë një rast *prima facie* diskriminimi (Gjykata Themelore e Brukselit, çështja nr. 05/1289/A).³²

31. Shih: Farkas, L., O'Farrell, O., *Reversing the burden of proof: Practical dilemmas at the European and national level*, European Commission, Brusseles, 2014, f. 36.

32. Shih: Gjykata Themelore Bruksel, nr. 05/1289/A ref. T. Nr. 1264/05, 25 qershor 2005.

LPMD lejon si prova të përdoren edhe të dhënat e marra nga testimi i një situatë. Neni 4 paragrafi 1 pika 14 e LPMD-së përcakton se çfarë nënkuptohet me “testimin e situatës”, përkatësisht e përkufizon si një metodë për të provuar diskriminimin përmes përfshirjes së testuesve të organizuar, të cilët vendosen në një situatë krahasuese që të hetohet shfaqja e diskriminimit në çështje, procese dhe fusha të ndryshme mbi çdo bazë diskriminimi. Në disa shtete të Bashkimit Evropian, si për shembull, Holanda, Franca, Danimarka, Finlanda, Suedia, Mbretëria e Bashkuar dhe Republika Çeke, lejohet përdorimi i testimit të situatës në proceset gjyqësore. Ajo që duhet theksuar është se testimi i situatës duhet të konsiderohet konfidencial dhe përfundimtar si nga KPMD-ja ashtu edhe nga Gjykata, përkatësisht përmes tij mund të arrihet në një konkluzion konkret. Megjithatë, nga përvoja krahasuese e gjykatave rezulton se, marrë në përgjithësi, gjykatat konsiderojnë se rezultatet e testimit duhet të mbështeten edhe me burime të tjera provash për të çuar në gjetjen e diskriminimit.³³

Neni 38 i LPMD-së

Në procedurën gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi, përveç provave të përcaktuara me Ligjin për procedurë kontestimore, si prova mund të përdoren edhe të dhënat statistikore dhe/ose të dhënat e marra nga testimi i situatës.

Në përputhje me kompetencat e tij, Komisioni mund të bëjë këqyrje në dokumentacionin dhe në hapësirat (neni 29), të grumbullojë të dhëna dhe informacione nga personat fizikë dhe juridikë (neni 30) dhe të bashkëpunojë me institucionet që veprojnë ndaj parashtrësve për mbrojtje nga diskriminimi dhe të drejtat e njeriut (neni 31), dhe në këtë mënyrë të sigurojë fakte dhe prova të tjera të cilat parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës nuk i ka në dispozicion, ndërkaq e ndihmojnë që ta konstatojë plotësisht gjendjen faktike dhe të gjejë ekzistim ose mosekzistim të diskriminimit në rastin konkret.

Neni 29 i LPMD-së

(1) Komisioni, gjatë kryerjes së punëve në kompetencën e tij, mund të bëjë këqyrje të drejtpërdrejta në dokumentacionin dhe hapësirat si dhe të kërkojë dhe të sigurojë kopje të dokumenteve që kanë të bëjnë me një çështje konkrete nga të gjithë personat juridikë, autoritetet shtetërore, organet e njësisë të vetëqeverisjes lokale, autoritetet dhe organizatat e tjera që ushtrojnë kompetenca publike dhe institucionet dhe shërbimet publike që kanë në dispozicion të dhëna dhe informacione për çështje dhe praktika të përgjithshme të diskriminimit, duke respektuar të drejtën e privatësisë.

Neni 30 i LPMD-së

(1) Të gjithë personat fizikë dhe juridikë, autoritetet shtetërore, organet e njësisë të vetëqeverisjes lokale, organet dhe organizatat e tjera që ushtrojnë kompetenca publike dhe institucionet dhe shërbimet publike, e kanë për detyrë, me kërkesë të Komisionit, të japin të dhëna për çështje të veçanta të diskriminimit dhe për praktika të përgjithshme të diskriminimit brenda tetë ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.

(2) Komisioni mund të thërrasë në bisedë çdo person që mund të japë informacione të caktuara për rastet e diskriminimit.

Neni 31 i LPMD-së

(1) Komisioni në ushtrimin e detyrave në kompetencë të tij bashkëpunon me institucionet që veprojnë ndaj parashtrësve për mbrojtje nga diskriminimi dhe të drejtat e njeriut për çështje të veçanta të diskriminimit.

33. Shih: Gjykata e Apelit në Paris, Billau v SOS Racism, vendimi nr. 07.04974, 17 mars 2008.

Në vazhdim, shtjellohen disa baza të diskriminimit si shembuj ilustrues të mbështetur nga praktika ekzistuese e KPMD-së, instancave ndërkombëtare gjyqësore dhe praktikave krahasuese.

1.1.1.

Diskriminimi i drejtpërdrejtë në bazë të seksit

Për të pasur një rast prima facie të diskriminimit të drejtpërdrejtë në bazë të seksit, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet të tregojë:

- 1) trajtim të pafavorshëm të kryer me veprim ose mosveprim,
- 2) ekzistim të bazës diskriminuese - seksit dhe lidhjen kauzale ndërmjet seksit të parashtruesit ose parashtrueses së parashtrësës dhe trajtimit të pafavorshëm,
- 3) një komparator, përkatësisht një situatë krahasuese, me përjashtim të disa rasteve të shpjeguara më poshtë në lidhje me shtatzëninë dhe pushimin e lindjes.

Gjatë analizës së elementit të parë, merret parasysh trajtimi më pak i favorshëm që ka ndodhur (është trajtuar), aktualisht po ndodh (po veprohet), ndërkaq ekziston edhe elementi anticipativ i trajtimit in futuro (do të trajtohej). Siç u theksua më sipër, në përputhje me praktikën gjyqësore të GJDBE-së, nuk nevojitet komparatori në rastet e shtatzënisë³⁴ së parashtrueses së parashtrësës, pushimit të lindjes³⁵ apo nënshtrimit të fekondimit *in vitro*.³⁶

Shembull: Në rastin *Wrights of Howth Seafood Bars Limited v. Murat*,³⁷ Gjykata Irlandeze për konteste të punës konsideron se mbrojtja e veçantë e grave shtatzëna nga përjashtimi nga puna në të drejtën e Bashkimit Evropian kërkon që, kur një grua shtatzënë përjashtohet nga puna, punëdhënësi ta ketë barrën e provës së përjashtimi nga puna bëhet në bazë të rrethanave të jashtëzakonshme që nuk kanë të bëjnë me shtatzëninë apo me pushimin e lindjes. Së këtejmë, Gjykata konsideron se në çdo rast në të cilin bëhet fjalë për përjashtim nga puna që ka të bëjë me shtatzëninë, kombinimi faktik i përjashtimit nga puna dhe shtatzënisë së gruas, vetvetiu, barrën e provës e vendos fuqishëm në anën e punëdhënësit, se nuk bëhet fjalë për diskriminim.

Më poshtë shpjegohen tri raste që kanë të bëjnë me diskriminim në bazë të seksit ndërsa i referohen pagesës së të njëjtës pagë për të njëjtën punë ose për punë me të njëjtën vlerë, të gjitha të shqyrtuara nga GJDBE-ja, e cila bën një vështrim në kalimin e barrës së provës në rastet konkrete.

34. Shih: GJDBE, C-177/88, Dekker v. Stichting Vormingscentrum voor Jong Voswansen (VJV-Centrum) Plus, ECR I-3941, 8 nëntor 1990; GJDBE, C-32/93, Carole Louise Webb v. EMO Air Cargo (UK) Ltd, ECR I-3567, 14 korrik 1994.

35. Shih: GJDBE, C-191/03, North Western Health Board v. Margaret McKenna, 8 shtator 2005, paragrafi 50.

36. Shih: GJDBE, C-506/06, Sabine Mayr v. Bäckerei und Konditorei Gerhard Flöckner OHG [GC], 26 shkurt 2008.

37. Shih: Gjykata për konteste të punës e Irlandës, *Wrights of Howth Seafood Bars Limited v. Murat*, EDA1728, 26 tetor 2017.

Shembull: Në rastin *Brunnhofer*, në të cilin paditësja pretendonte diskriminim në bazë të seksit, sepse ajo paguhej më pak se kolegët e saj meshkuj që ishin në të njëjtin nivel pagash me të, GJDBE-ja konsideron se paditësja duhej të provonte këtë si më poshtë: së pari, se ajo paguhej më pak se kolegët e saj meshkuj që ishin në të njëjtin nivel, dhe së dyti, se ajo po bënte punë me vlerë të barabartë me punën që bënin ata. Kjo ishte e mjaftueshme për ta bërë të mundshme se trajtimi i ndryshëm mund të shpjegohet vetëm për shkak të seksit të saj, dhe kështu barra e provës i kalon automatikisht punëdhënësit për të provuar të kundërtën (GJDBE, rasti *Susanna Brunnhofer*).³⁸

Shembull: Në rastin *Danfoss*,³⁹ sindikata ngriti një çështje në emër të punëtorëve në një ndërmarrje, sepse ato fitonin mesatarisht 7% më pak se kolegët e tyre të seksit mashkull në vendin e njëjtë të punës ose në vend të ngjashëm të punës. GJDBE-ja në këtë rast shprehimisht thekson se në raste në të cilat ndërmarrja aplikon një sistem të përlllogaritjes së pagave që është plotësisht jo transparent ndërsa të dhënat statistikore tregojnë ekzistencën e pabarazisë në pagesën e pagave ndërmjet punëtorëve femra dhe meshkuj, barra e provës i kalon punëdhënësit që të provojë se diferenca e pagës së paguar ka të bëjë me faktorët që nuk kanë lidhje me seksin e punëtorëve (GJDBE, rasti *Danfoss*).

Shembull: Në rastin *Enderby*, që ka të bëjë me diskriminim në bazë të seksit kurse në lidhje me pagesën e së njëjtës pagë për punë me të njëjtën vlerë, GJDBE-ja e konfirmoi qëndrimin e saj të miratuar më parë në rastin *Danfoss*, duke krahasuar pagën e logopedëve, të cilët ishin kryesisht gra dhe të farmacistëve që ishin kryesisht burra. Gjykata konsideron se nëse paga e logopedëve është dukshëm më e ulët se paga e farmacistëve, ndërkaq grupi i parë janë kryesisht femra, për dallim nga grupi i dytë, të cilët janë kryesisht meshkuj, kjo vetvetiu çon në ekzistimin e rastit *prima facie* të diskriminimit në bazë të seksit. Ndërkaq kur ekziston një rast *prima facie* i diskriminimit, punëdhënësi është përgjegjës të tregojë se ekziston arsye objektive për diferencën në pagë. Gjykata shfrytëzon nga rasti të deklarojë se punëtorët dhe punëtoret do të pamundësohen ta zbatojnë parimin e pagës së barabartë para gjykatave kombëtare nëse prova e ekzistencës së rastit *prima facie* të diskriminimit nuk e mundëson kalimin e barrës së provës (GJDBE, Rasti *Enderby*).⁴⁰

38. Shih: GJDBE, C-381/99, *Susanna Brunnhofer v. Bank der österreichischen Postsparkasse AG*, 26 qershor 2001, paragrafi 51-62.

39. Shih: GJDBE, C-109/88, *Handels- og Kontorfunktionærernes Forbund i Danmark v Dansk Arbejdsgiverforening (acting on behalf of Danfoss)*, [1989] ECR I-3199.

40. Shih: GJDBE, C-127/92, *Enderby v Frenchay Health Authority and Secretary of State of Health*, 1993 ECR I-05535, paragrafi 14 dhe 18.

Shembull: GJDBE në rastin Kelly,⁴¹ në të cilin paditësi ka pohuar se ekziston diskriminimi në bazë të seksit për shkak të refuzimit për të marrë pjesë në një program trajnimi pune ndërsa nga institucioni arsimor ka kërkuar që t'i lejojë akses në informacione për kualifikimet e parashtruesve dhe parashtrueseve tjera, qartë vë në dukje se një e drejtë e këtillë nuk ekziston sipas legjislacionit dytësor të Bashkimit. Megjithatë u takon gjykatave kombëtare të vendosin nëse në rastin konkret është e nevojshme që këto të dhëna të bëhen publikisht të aksesueshme për të arritur qëllimin e legjislacionit, në rastin konkret qëllimin e Direktivës 97/80/EC.⁴²

Shembull: Gjykata e Apelit në Montpellier konkludoi në mënyrë identike në rastin IBM v. Buscail,⁴³ në të cilin gjykata konsideron se pasoja nga mossigurimi i provave të cilat i posedon i padituri çon në kalimin e barrës së provës tek ai.

Shembull: GJDBE në rastin Richards,⁴⁴ në të cilin parashtruesja e cila e kishte ndryshuar seksin e saj në mënyrë operative (nga mashkull në femër) kur mbushi 60 vjet, donte të aplikonte për pension, meqenëse në atë moshë gratë në Mbretërinë e Bashkuar e fitojnë të drejtën e pensionit. Shteti refuzoi t'i jepte asaj një pension, duke pasur parasysh se parashtruesja nuk është trajtuar në mënyrë të pafavorshme në krahasim me të tjerët që janë në situatë të ngjashme. Autoritetet konfirmuan se komparatori adekuat në këtë rast duhet të ishin „burra“, sepse parashtruesja jetën e saj e kishte jetuar si burrë. GJDBE-ja vendosi se për shkak se ligjet kombëtare lejojnë ndryshimin e seksit, komparatori përkatës në këtë rast duhet të jenë „gra“. Rrjedhimisht, me parashtruesen është vepruar në mënyrë të pafavorshme në krahasim me gratë e tjera kështu që asaj i imponohet një moshë më e lartë për pensionim (GJDBE, çështja Richards).

Duhet të dihet!

Në rastet e diskriminimit në bazë të seksit e në lidhje me shtatzëninë, nuk nevojitet komparatori.

1.1.2. Diskriminimi i drejtpërdrejtë në bazë të përkatësisë etnike

Për të pasur një rast prima facie të diskriminimit të drejtpërdrejtë në bazë të përkatësisë etnike, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet të tregojë:

- 1) trajtim të pafavorshëm të kryer me veprim ose mosveprim,

41. Shih: GJDBE, C-104/10, Patrick Kelly v. National University of Ireland (University College, Dublin), 21 korrik 2011.

42. Shih: Council Directive 97/80/EC of 15 December 1997 on the burden of proof in cases of discrimination based on sex.

43. Shih: Gjykata e Apelit në Montpellier, IBM v. Buscail, nr. 0200504, 28 maj 2020.

44. Shih: GJDBE, C-423/04, Richards v. Secretary of State for Work and Pensions, ECR I-3585, 27 prill 2006.

- 2) ekzistim të bazës diskriminuese sipas përkatësisë etnike dhe lidhjes kauzale ndërmjet përkatësisë etnike të parashtruesit ose parashtrueses së parashtrësës dhe trajtimit të pafavorshëm,
- 3) një komparator, përkatësisht një situatë krahasuese

Praktika gjyqësore ndonjëherë ofron përgjigje se cilat fakte mund të përdoren për të vendosur prezumimin e diskriminimit. Për shembull, gjykatat irlandeze në disa raste konsiderojnë se njëri nga faktet që mund të çojë në rastin prima facie të diskriminimit është kur sjellja e paditësit ndryshon nga praktika standarde në lidhje me sigurimin e shërbimit konkret për të cilin bëhet fjalë.

Shembull: Në rastin *A Nigerian National v A Financial Institution*,⁴⁵ një shtetas nigerian u ankua se aplikimi i tij për një kredi të përkohshme ishte refuzuar edhe pse ai i kishte plotësuar të gjitha kriteret. Një gjë e këtillë vetvetiu ishte e mjaftueshme për të nxjerrë një konkluzion për diskriminimin e pretenduar në bazë të racës dhe përkatësisë etnike, e që më vonë nuk u përgënjeshtroa me asnjë provë të paraqitur nga i padituri.

Gjithashtu, siç u shpjegua më lart, diskriminimi i drejtpërdrejtë ndodh në rastet kur punëdhënësi deklaron publikisht se nuk do të punësojë punëtorë nga një komuniteti të caktuar etnik, sepse deklarata të tilla zakonisht do t'i zbrapsnin punëtorët ose punëtorët e caktuara të konkurrojnë, me ç'rast do të pengohej akses i tyre në tregun e punës, si në rastin *Feryn*, të shpjeguar më sipër. Në këtë rast, me vetë deklaratën e dhënë, barra e provës kalon, së këtejmi pa pasur nevojë për një viktimitë identifikuese. Në raste të tilla, në shumicën e rasteve, organizatat qytetare do të paraqiteshin si parashtruese të parashtrësës para KPMD-së, ose do të mund të ngrihej një procedurë sipas detyrës zyrtare.

Shembull: Në rastin *Makuchyan dhe Minasyan*, duke i pasur parasysh tiparet e veçanta të çështjes të cilat konsistojnë me avancimin e një vrasësi të dënuar për vrasjen e një ushtari armen, duke i dhënë atij më shumë përfitime pa asnjë bazë ligjore, duke e madhëruar atë si hero nga një numër të madh funksionarësh të lartë të Azerbajxhanit, si dhe duke krijuar një faqe të veçantë në faqen e internetit të Presidentit, sipas opinionit të GJEDNJ-së, parashtruesit kishin paraqitur argumente mjaft të fuqishme, të qarta dhe koherente për të treguar ekzistencën e një rasti bindës prima facie në të cilin masat e kontestuara të cilat shqyrtohen ishin të motivuara nga origjina etnike e viktimave. Duke pasur parasysh vështirësinë e parashtruesve për të provuar këtë njëanshmëri përtej dyshimit të arsyeshëm, Gjykata, në rrethanat konkrete të rastit, e kaloi barrën e provës në mënyrë që Azerbajxhanit iu kërkua të përgënjeshtronte pretendimin e kontestuar për diskriminim, të cilën gjë përfundimisht nuk arriti ta realizonte. (GJEDNJ, rasti *Makuchyan dhe Minasyan*).⁴⁶

45. Shih: Gjykata e kontesteve të punës e Irlandës, *A Nigerian National v Financial Institution*, DEC-S2005-114.

46. Shih: GJEDNJ, *Makuchyan dhe Minasyan v. Azerbaijan and Hungary*, Aplikacioni nr. 17247/13, 26 maj 2020.

Të drejtat e minoriteteve kundrejt mbrojtjes së tyre nga diskriminimi në të drejtën dhe praktikën ndërkombëtare

Në të drejtën dhe praktikën ndërkombëtare dhe në literaturën akademike, bëhet fjalë për mbrojtjen e minoriteteve, e cila mbështetet në dy shtylla. Është e rëndësishme që praktikuesit dhe praktikueset t'i kenë parasysh dallimet midis këtyre dy shtyllave në mënyrë që të kuptojnë siç duhet të drejtën dhe praktikën ndërkombëtare, dhe prandaj ato janë prezantuar shkurtimisht këtu.

Njëra shtyllë është shtylla e mosdiskriminimit, e cila përfshin gëzimin e të drejtave të njeriut dhe barazinë përpara ligjit pa diskriminim, si dhe zbatimin e masave afirmative dhe masave pozitive të trajtimit për arritjen e barazisë materiale. Shtylla tjetër është ajo e identitetit; ajo i përmban të drejtat e identitetit që synojnë t'u ofrojnë komuniteteve kushte të nevojshme për ta bartur, ruajtur dhe zhvilluar kulturën e tyre dhe elementet e tjera thelbësorë të identitetit të tyre.⁴⁷

1.1.3. Diskriminimi i drejtpërdrejtë në bazë të aftësive të kufizuara

Për të pasur një rast prima facie të diskriminimit të drejtpërdrejtë në bazë të aftësive të kufizuara, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet të tregojë:

- 1) trajtim të pafavorshëm të kryer me veprim ose mosveprim,
- 2) ekzistim të bazës diskriminuese të aftësive të kufizuara dhe lidhje kauzale midis bazës së aftësive të kufizuara dhe trajtimit të pafavorshëm,
- 3) një komparator, përkatësisht një situatë krahasuese, edhe pse shumë shpesh përdoret edhe krahasimi hipotetik (nëse nuk mund të gjendet një i vërtetë).

Baza e aftësive të kufizuara ka një interpretim evolutiv, ndërkohë madje as Konventa Ndërkombëtare e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara nuk e përkufizon aftësinë e kufizuar për shkak të kompleksitetit të kësaj çështjeje, në nenin 1 paragrafin 2 të saj specifikohet se çfarë nënkuptohet me termin “persona me aftësi të kufizuara”. Nga kjo rezulton se, “personat me aftësi të kufizuara i përfshijnë ata që kanë aftësi të kufizuara afatgjatë fizike, mendore, intelektuale ose shqisore, të cilat, në ndërveprim me pengesa të ndryshme, mund ta pengojnë përfshirjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.” Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në S.C. v. Brazili,⁴⁸ konsideronte se ndryshimi midis sëmundjes dhe aftësisë së kufizuar është në ndryshimin e shkallës, dhe jo në ndryshimin

47. Kotevska, B., Udhëzues për bazat e diskriminimit, Misioni i OSBE-së në Shkup dhe Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi, Shkup, 2013, f. 25.

48. Shih: Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, S.C. v. Brazil, Communication No. 10/2013, CRPD/C/12/D/10/2013, vendim i datës 28 tetor 2014.

e llojit. Një gjendje shëndetësore e konceptuar fillimisht si sëmundje mund të zhvillohet në një paaftësi në kontekstin e aftësisë së kufizuar si pasojë e kohëzgjatjes ose kronizmit të saj. Modeli i aftësisë së kufizuar i bazuar në të drejtat e njeriut pretendon të merret parasysh diversiteti i personave me aftësi të kufizuara (preambula, paragrafi z), së bashku me ndërveprimin midis individit me aftësi të kufizuar dhe barrierave në shoqëri dhe mjedis (preambula, alineja d) (paragrafi 6.3).⁴⁹

Shembull: Në një rast në të cilin një menaxher i një qendre fitness u përjashtua nga puna një ditë pasi ai informoi punëdhënësin dhe kolegët e tij përmes postës elektronike se fëmija i tij i porsalindur është me aftësi të kufizuara, Tribunali i Punësimit në Leuven mori parasysh afërsinë kohore të deklaratës së bërë nga paditësi në mesazhin e tij elektronik dhe përjashtimin e tij nga puna, dhe ishte i mendimit se kjo ishte e mjaftueshme për përcaktimin e prezumimit të diskriminimit të bazuar në aftësitë e kufizuara sipas asociacionit.⁵⁰

Shembull: Gjykata Federale Gjermane për Konteste të Punës në rastin nr. 8 AZR 170/19,⁵¹ në të cilin bëhet fjalë për një parashtrues me shkalël të rëndë të aftësisë së kufizuar, i cili ka aplikuar për punësim në një ndërmarrje publike të sigurimeve shëndetësore, por nuk është ftuar në intervistë, konsideron se vetë mosftimi i tij në intervistë është i mjaftueshëm që të përcaktohet supozimi si i mundshëm se ai nuk është marrë në konsideratë për atë vend pune për shkak të aftësisë së tij të kufizuar. Gjykata konsideroi se, vetëm me atë pohim, barra e provës i kaloi të paditurit, i cili nuk e përgënjeshtroi supozimin për diskriminim (Gjykata Federale Gjermane për Konteste të Punës, rasti nr. 8 AZR 170/19).

Duhet të dihet!

Diskriminimi me asocim për herë të parë u shpjegua juridikisht në rastin *Coleman v Attridge Law dhe Steve Law*,⁵² të GJDBE-së, në të cilin nëna e një fëmije me aftësi të kufizuar u ekspozua ndaj një sërë fyerjesh në vendin e saj të punës për shkak të mungesave të shpeshta nga puna, sepse ajo kishte një fëmijë me aftësi të kufizuar. Edhe pse ajo personalisht nuk e posedonte tiparin e mbrojtur, mirëpo pikërisht për faktin se aftësia e kufizuar e fëmijës së saj ishte arsyeja e sjelljes së tillë të kolegëve dhe eprorëve në kompani ndaj saj, ajo ngriti procedurë për diskriminim dhe ngacim të drejtpërdrejtë në bazë të aftësisë së kufizuar të fëmijës së saj dhe lidhjes së tyre të qenësishme. GJDBE-ja vlerësoi se dinjiteti i saj ishte cenuar, dhe për këtë arsye konstatoi se ajo ishte diskriminuar në bazë të aftësisë së kufizuar me asocim, duke theksuar se Direktiva 2000/78/EC nuk mbron nga diskriminimi vetëm personat me aftësi të kufizuara, por mbron nga diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar për se, duke i përfshirë këtu edhe personat që janë në një marrëdhënie të ngushtë dhe të pandashme me personat me aftësi të kufizuara.

49. Shih: Poposka, Zh., Interpretues i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Polio Plus – Lëvizja kundër handikapit, Shkup, 2018, f.26

50. Shih: Tribunali i Punësimit në Leuven, AR 12/1064/1, 12 dhjetor 2013. Për më shumë informacione shih: Ringelheim, J. The burden of proof in anti-discrimination proceedings. A focus on Belgium, France and Ireland, in European equality law review, European network of legal experts in gender equality and non-discrimination, Publications Office of the European Union, Luxembourg, 2019, f. 53-54.

51. Shih: Gjykata Federale Gjermane për Konteste të Punës, nr. 8 AZR 170/19, 25 mars 2003.

52. Shih: GJDBE, C-303/06, *Coleman V Attridge Law dhe Steve Law*, 17 korrik 2008.

Lexo më tepër!

Në Interpretuesin e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për bazën e aftësisë së kufizuar dhe për praktikën e Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

1.1.4. Diskriminimi i drejtpërdrejtë në bazë të religjionit ose besimit

Për të pasur një rast prima facie të diskriminimit të drejtpërdrejtë në bazë të religjionit ose besimit, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet të tregojë:

- 1) trajtim të pafavorshëm të kryer me veprim ose mosveprim,
- 2) ekzistim të bazës diskriminuese religjioni ose besimi dhe lidhjes kauzale ndërmjet bazës së religjionit ose besimit dhe trajtim të pafavorshëm,
- 3) një komparator, përkatësisht një situatë krahasuese.

Kur flasim për këtë bazë, duhet theksuar se në të drejtën ndërkombëtare dhe në asnjë nga vendet evropiane nuk ekziston një përkufizim për religjionin. Prandaj, zakonisht bëhet një shqyrtim i përmbajtjes së të drejtës së religjionit ose besimit në mënyrë që të përcaktohet nëse kjo bazë mund të zbatohet në një rast konkret. Kjo bazë përfshin të drejtën e predikimit të religjionit ose besimit sipas zgjedhjes personale, duke përfshirë edhe mospërkatësinë në ndonjë religjion ose besim, që mund të manifestohet publikisht ose privatisht nëpërmjet adhurimit, praktikimit ose predikimit.⁵³

Shembull: *Në rastin para Gjykatës së Qarkut në Lubjanë, parashtruesja pohoi se ekziston diskriminimi në bazë të religjionit ose besimit sepse si kandidatë për specializim mjekësor në gjinekologji dhe obstetrikë, asaj iu refuzua vendi i punës nga komisioni përzgjedhës. Ajo pohoi se qëndrimi i Komisionit ndryshoi pas paralajmërimit të saj se i referohet kundërshtimit sa i përket ndërgjegjes në rastet e abortit dhe disa formave të kontracepsionit. Ajo ngriti padi duke pohuar se është diskriminuar. Gjykata e shkallës së parë vlerësoi se paditësja bëri një rast prima facie të diskriminimit dhe barra e provës i kaloi të paditurit, Shoqata e Mjekëve të Sllovenisë, e cila nuk arriti të provonte, përmes deklaratave të dëshmitarëve që ishin anëtarë të Komisionit Përzgjedhës, të cilët e zhvilluan intervistën me kandidaten, se arsyet për vlerësimin e kandidatës janë të arsyeshme (Gjykata e Qarkut në Lubjanë, rasti nr. III P 7/2021).⁵⁴*

Sipas Kotevskës, ndryshe nga e drejta ndërkombëtare, ku religjioni si bazë diskriminimi zakonisht shkon në kombinim me besimin, LPMD-ja ato i përcakton si baza të veçanta. Sipas GJEDNJ-së, besimi do të

53. Shih: General Comment No. 20, Non-discrimination in economic, social and cultural rights, United Nations Committee on Economic, Social and Cultural Rights, E/C.12/GC/20, 2 July 2009, paragrafi 22.

54. Shih: Gjykata e Qarkut në Lubjanë, nr. III P 7/2021, vendim i datës 25.02.2021.

thotë shumë më tepër sesa një mendim i rëndomtë apo ndjenja të thella. Nevojitet një gjë e këtillë të lidhet me bindjen shpirtërore ose filozofike që do të ketë një përmbajtje formale e cila mund të identifikohet (në rastin McFeeley), i cili do të ketë një nivel të caktuar serioziteti, kohezioni dhe kuptimi të shprehur (në rastin Campbell and Cosans). Llojet e tjera të besimeve mund të jenë ateizmi, agnosticizmi, si dhe besimet pozitive jofetare. Në rastin Kokkinakis, GJEDNJ-ja shpjegoi në detaje lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar, e cila është thelbësore për bazën e religjionit dhe besimeve të tjera fetare, si dhe për bazën e llojeve të tjera të besimit. Sipas Gjykatës, kjo liri në dimensionin e saj fetar është një nga elementët kyç për ndërtimin e identitetit të besimtarëve dhe konceptin e tyre për jetën, por nga ana tjetër është një mundësi jashtëzakonisht e rëndësishme për ateistët, skeptikët dhe të painteresuarit.⁵⁵

1.1.5. Diskriminimi i drejtpërdrejtë mbi një bazë tjetër

Ekzistojnë shumë baza diskriminimi në përputhje me LPMD-në, ndërkohë Komisioni, duke e vlerësuar secilin rast veçmas, do të përcaktojë se kur do të kalojë barra e provës. Ashtu si në bazat e shpjeguara më sipër, për kalimin e barrës së provës në rastin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, pavarësisht bazës në fjalë, do të vlerësohen të tre elementët konstituivë, si vijon: trajtimi i pafavorshëm dhe lëndimi i pësuar, përkatësisht dëmi, kauzaliteti me bazë diskriminuese dhe ekzistenca e krahasimit (real ose hipotetik, rast pas rasti).

Shembull: Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi në rastin nr. 0801 -273,⁵⁶ i ka shqyrtuar pretendimet e parashtrueses së parashtrësës, e cila ka pohuar se ekziston një diskriminim i drejtpërdrejtë në bazë të arsimit ndaj Gjykatës Themelore Penale Shkup. Me parashtrësën janë paraqitur fakte dhe prova të shumta të cilat sipas KPMD-së kanë bërë të mundur pretendimin për diskriminim dhe për këtë arsye barra e provës i kaloi personit kundër të cilit është paraqitur parashtrësja për të provuar se nuk e ka diskriminuar parashtruesen e parashtrësës. Gjatë analizës së të gjitha fakteve dhe provave të rastit, Komisioni konstatoi diskriminim të drejtpërdrejtë në bazë të arsimit në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës (KPMD, rasti nr. 0801-273).

Shembull: Në rastin Maruko, një çift homoseksual ka lidhur “partneritet jetë”. Partneri i parashtruesit kishte ndërruar jetë dhe ai donte të kërkonte një pension trashëgimie nga kompania që menaxhonte Fondin Pensional të partnerit të ndjerë. Kompania refuzoi t’i paguante një pension të tillë me arsyetimin se pensioni familjar u paguhet vetëm bashkëshortëve kurse ai nuk ishte i martuar me të ndjerin. GJDBE-ja pranoi se mospagimi i pensionit është një trajtim i pafavorshëm ndërsa një trajtim i këtillë e vendos parashtruesin ndryshe nga komparatori “çifti bashkëshortor”. Gjykata konstatoi se partneriteti i të njëjtit seks në Gjermani në masë të madhe krijoi të drejta dhe detyrime të njëjta për partnerët e jetës dhe për bashkëshortët, veçanërisht në aspektin e fondeve pensionale shtetërore. Së këtejmi, në këtë rast GJDBE-ja vendosi se partnerët e jetës janë në një situatë të ngjashme me atë të bashkëshortëve, duke gjetur diskriminim në bazë të orientimit seksual. Me fjalë të tjera, fakti që ata nuk ishin në gjendje të martoheshin është pjesë e pandashme e orientimit të tyre seksual (GJDBE, rasti Maruko)⁵⁷

55. Kotevska, B., Udhëzues i bazave të diskriminimit, Misioni i OSBE-së në Shkup dhe Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi, Shkup, 2013, f. 35.

56. Shih: Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, nr. 0801-273, 19 korrik 2021.

57. Shih: GJDBE, C-267/06, Maruko v. Versorgungsanstalt der deutschen Bühnen, ECR I-1757, 1 prill 2008.

Shembull: Në rastin para Gjykatës së Qarkut në Varshavë, paditësi pohoi se ka diskriminim me asocim bazuar në orientimin seksual. Rasti ka të bëjë me një punonjës, i cili punonte në një dyqan si roje sigurimi dhe pas pjesëmarrjes së tij në paradën e krenarisë, të shfaqur në televizion, u njoftua nga punëdhënësi për përjashtimin e tij nga puna. Punëdhënësi i tij deklaroi se „nuk mund të imagjinoje një homoseksual të punonte për kompaninë e tij“. Gjykata është e mendimit se diskriminimi mund të ndodhë pavarësisht nëse viktima në të vërtetë ka poseduar një tipar të caktuar të mbrojtur apo jo. Prandaj, orientimi seksual i paditësit ishte jorelevant. Pastaj, gjykata konstatoi se paditësi ishte diskriminuar për shkak të pjesëmarrjes së tij në marshin lidhur me komunitetin LGBTI. Rrjedhimisht me këtë u konstatua diskriminim me asocim ndërsa paditësit i përcaktuan kompensim të drejtë (Gjykata e Qarkut në Varshavë, rasti nr. V Ca 3611/14).⁵⁸

Shembull: Në rastin Carvalho Pinto de Sousa Morais, parashtruesja u ankua se për shkak të një gabimi mjekësor gjatë një ndërhyrjeje gjinekologjike, ajo u pamundësua të kishte marrëdhënie seksuale, dhe për këtë arsye kërkoi kompensim të dëmit në procedurë gjyqësore. Fillimisht asaj iu akorduan 80.000 euro, kurse Gjykata e Shkallës së Dytë e uli shumën në 50.000 euro me arsyetimin se seksualiteti nuk është një aspekt aq i rëndësishëm i jetës së një gruaje pesëdhjetëvjeçare dhe nënë e dy fëmijëve, krahasuar me një grua më të re. Paraprakisht, një gjykatë në Portugali dy burrave viktima të gabimit mjekësor të një natyre të ngjashme, të moshës 55 dhe 59 vjeç, iu akordoi 224.459 euro dhe 100.000 euro, me arsyetimin se fakti se burrat nuk mund të kryenin marrëdhënie normale seksuale dhe se një gjë e këtillë ndikon në vetëbesimin e tyre dhe rezulton në traumë serioze psikologjike. Në arsyetimin e aktgjyqimit, gjykatat vendase e pasqyrojnë idenë tradicionale të seksualitetit femëror që lidhet me riprodhimin, lindjen dhe rritjen e fëmijëve dhe neglizhon rëndësinë e përmbushjes fizike dhe psikologjike të gruas. Kjo vetvetiu kontribuoi në kalimin e barrës së provës tek shteti i cili nuk arriti ta përgënjeshtrojë prezumimin e diskriminimit. Për shkak të kësaj, GJEDNJ vlerësoi se ka diskriminim në bazë të gjinisë, duke argumentuar se ai është në lidhje të ngushtë me moshën e parashtrueses (GJEDNJ, rasti Carvalho Pinto de Sousa Morais).⁵⁹

58. Shih: Gjykata e Qarkut në Varshavë (Gjykata e Shkallës së Dytë), nr. V Ca 3611/14, 18 nëntor 2005.

59. Shih: GJEDNJ, Carvalho Pinto de Sousa Morais v. Portugal, Aplikimi nr. 17484/15, 25 korrik 2017.

Shembull: Në rastin Kiyutin, parashtruesi, i cili është shtetas i Uzbekistanit, mbërriti në Rusi në vitin 2003 dhe u martua me një shtetase ruse me të cilën kishte një vajzë. Megjithatë, kërkesa e tij për leje qëndrimi u refuzua për shkak se ai ishte HIV pozitiv. GJEDNJ-ja vlerësoi se parashtruesi ishte në një situatë të ngjashme me personat e tjerë të huaj, të cilët kërkonin leje qëndrimi në Rusi në bazë të statusit familjar, por ndaj tij kanë vepruar ndryshe për shkak të statusit të një personi HIV pozitiv. Hapësira për vlerësimin diskrecional të shtetit në këtë sferë është e ngushtë sepse personat që jetojnë me HIV janë një grup veçanërisht vulnerabil që ka pësuar diskriminim të konsiderueshëm në të kaluarën, ndërsa në nivel evropian nuk ka konsensus për përjashtimin e këtij grupi nga e drejta e qëndrimit. Ndonëse pranohet se masa e kritikuar ka një qëllim legjitim për të mbrojtur shëndetin publik, ekspertët mjekësorë dhe organet ndërkombëtare kanë rënë dakord që kufizimi i udhëtimit të personave HIV pozitiv nuk mund të justifikohet përmes shqetësimeve për shëndetin publik. Për më tepër, kufizimet e këtilla mund të jenë efektive në rastin e një numri të madh të sëmundjeve infektive me një periudhë të shkurtër inkubacioni, siç është kolera ose ethet e verdha, prania e një personi HIV pozitiv në vend, vetvetiu, nuk paraqet kërcënim për shëndetin publik. HIV nuk transmetohet në përgjithësi, por përmes sjelljes specifike edhe mënyrat e transmetimit të kësaj sëmundjeje janë të njëjta, pavarësisht kohëzgjatjes së qëndrimit të personit në vend apo shtetësisë së tij/saj. Për shkak të kësaj dhe fakteve të tjera të argumentuara nga GJEDNJ-ja, ajo konstatoi se parashtruesi ishte viktimë e diskriminimit në bazë të statusit shëndetësor (GJEDNJ, rasti Kiyutin).⁶⁰

Shembull: Në rastin B.S., parashtruesja e cila është punonjëse seksi me origjinë nigeriane, u keqtrajtua fizikisht dhe verbalisht nga policia. Ndonëse parashtruesja ka kërkuar të aplikohen mjete të ndryshme për mbledhjen e provave, gjykatat vendase kërkuan vetëm raporte të cilat përpiloheshin nga eprori i drejtpërdrejtë i nëpunësve kundër të cilëve zhvillohej procedura, ndërsa urdhrat e lirimimit i bazuan vetëm mbi raportet e këtilla. Sipas GJEDNJ-së, kur shteti heton incidente të dhunshme, e ka detyrimin t'i ndërmarrrë të gjitha masat e arsyeshme për të përcaktuar nëse ka pasur motive raciste dhe nëse urrejtja etnike apo paragjykimet kanë luajtur ndonjë rol në ngjarjet. Gjykatat vendase nuk i shqyrtuan pretendimet e parashtrueses se nëpunësit iu drejtuan asaj me fjalët „largohu nga këtu, lavire e zezë“ dhe se gratë e tjera që bënin të njëjtën punë si parashtruesja nuk u ndaluan dhe nuk u morën në pyetje thjesht për shkak të „fenotipit të tyre evropian“. Pretendimet e këtilla të parashtrueses nuk u hetuan mjaftueshëm nga gjykatat vendase, të cilat vendimet e tyre i bazuan vetëm mbi përmbajtjen e raporteve të shefit të policisë, pa kryer një hetim më të detajuar për sjelljen e pretenduar raciste. Gjykata, gjatë vendimmarrjes, e theksoi interseksionin e disa tipareve identitare siç është raca, gjinia dhe profesioni i parashtrueses, të cilat krijojnë një barrë specifike për viktimën dhe e bëjnë atë më fragjile në krahasim me të tjerët. Pikërisht kjo është arsyeja pse Gjykata potencoi se gjykatat vendase nuk e morën parasysh fragjilitetin e veçantë të parashtrueses, që korrespondon me pozitën e saj si një grua afrikane që punon si punonjëse seksi, me çrast kanë bërë diskriminim në bazë të racës, gjinisë dhe statusit të punës së saj (GJEDNJ, rasti B.S.).⁶¹

60. Shih: GJEDNJ, Kiyutin k. Russia, Aplikimi nr. 2700/10, 10 mars 2011.

61. Shih: GJEDNJ, B.S. v. Spain, Aplikimi nr. 47159/08, 24 korrik 2012.

Shembull: Në rastin *Gaygusuz*, kërkesa për pagesën e shtesave në rast të papunësisë e paraqitur nga një shtetas turk i cili ka punuar në Austri u refuzua me arsyetimin se ai nuk kishte shtetësi austriake. GJEDNJ-ja vendosi se parashtruesi ishte në situatë të krahasueshme me shtetasit austriakë, sepse ai ishte banor i përhershëm i Austrisë dhe paguante kontribute në sistemin e sigurimeve sociale nëpërmjet tatimeve. Gjykata konstatoi se mungesa e një marrëveshjeje reciproke të sigurimeve sociale midis Austrisë dhe Turqisë nuk e arsyeton trajtimin e ndryshëm (të pafavorshëm), sepse gjendja e parashtruesit ishte në fakt shumë e afërt me gjendjen e shtetasve austriakë (GJEDNJ, rasti *Gaygusuz*).⁶²

Lexo më tepër!

Në Udhëzuesin e bazave të diskriminimit për bazat diskriminuese përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, GJDBE-së dhe organeve ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut.

1.1.6. Diskriminimi i shumëfishtë i drejtpërdrejtë

Për të pasur një rast prima facie të diskriminimit të drejtpërdrejtë mbi më shumë baza njëkohësisht, pavarësisht nëse ato janë kumulative apo interseksionale midis tyre, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet të tregojë:

- 1) trajtim të pafavorshëm të kryer me veprim ose mosveprim,
- 2) ekzistim të bazave diskriminuese dhe lidhjes kauzale ndërmjet bazave dhe trajtimit të pafavorshëm, edhe atë nëse bëhet fjalë për diskriminim të shumëfishtë kumulativ mbi secilën bazë veçmas, ose nëse bëhet fjalë për diskriminim interseksional bashkë mbi dy bazat ose mbi më shumë baza të kryqëzuara,
- 3) një komparator, përkatësisht një situatë krahasuese, edhe pse shpesh përdoret edhe komparatori hipotetik, veçanërisht për diskriminimin interseksional, sepse do të ishte e vështirë të diferencuhej nënsegmentimi i grupit të lidhur me bazat diskriminuese në fjalë.

Shembull: Në rastin *Meister*, parashtruesja pohoi se ka diskriminim në bazë të seksit, moshës dhe origjinës etnike gjatë përzgjedhjes së kandidatit ose kandidates për punësim me çrast nga gjykata ka kërkuar që punëdhënësi informacionin ta bëjë publik se a ka punësuar ndonjë kandidat ose kandidate tjetër në fund të procesit. GJDBE-ja vlerësoi se ndonëse direktivat kundër diskriminimit nuk e parashikojnë të drejtën e aksesit në këtë lloj të informacioneve, megjithatë, Gjykata nuk mund të përjashtojë se refuzimi i të paditurit për t'i dhënë akses në informacionet parashtrueses mund të jetë një nga faktorët që duhet të merren parasysh në kontekstin e përcaktimit të fakteve nga të cilat mund të supozohet se ka ndodhur diskriminim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë. GJDBE-ja nënvizoi se Gjykata kombëtare është ajo që duhet të përcaktojë nëse është kështu në rastin konkret, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit i cili shqyrtohet përpara saj (GJDBE, rasti *Meister*).⁶³


62. Shih: GJEDNJ, *Gaygusuz v. Austri*, Aplikimi nr. 17371/90, 16 shtator 1996.

63. Shih: GJDBE, C-415/10, *Galina Meister v. Speech Design Carrier Systems GmbH*, 19 prill 2012, paragrafët 45 deri 48


Shembull: Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi në rastin nr. 0801 -136,⁶⁴ i shqyrtoi pretendimet e parashtruesit të parashtrësës, i cili pohon se ka diskriminim kundër Ndërmarrjes së Transportit Publik Shkup për shkak se shoferi i autobusit në linjën urbane nr. 22 nxori me forcë nga autobusi një grua dhe dy fëmijët e saj të mitur, njëri prej të cilëve në karrocë, të gjithë pjesëtarë të bashkësisë etnike rome. KPMD-ja konsideron se parashtruesi i parashtrësës pohimin për diskriminim e ka bërë të mundshëm dhe për këtë arsye barra e provës kaloi tek personi kundër të cilit është paraqitur parashtrësja për të provuar se nuk ka ushtruar diskriminim. Gjatë analizës së të gjitha fakteve dhe provave në këtë rast, Komisioni përcaktoi diskriminim të drejtpërdrejtë interseksional bazuar në racën, ngjyrën e lëkurës, origjinën sociale, përkatësinë etnike dhe përkatësinë në një grup të marginalizuar në fushën e aksesit në mallra dhe shërbime publike nga Ndërmarrja e Transportit Publik Shkup (KPMD, rasti Nr. 0801-136).

1.2. Diskriminimi i tërthortë


Në rastet e diskriminimit të tërthortë, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës, ashtu si edhe në rastet e diskriminimit të drejtpërdrejtë, duhet të bëjë prezumimin e diskriminimit, duke treguar:



pozitë të pafavorshme, përkatësisht efekt negativ joproporcional nga zbatimi i akteve normative, dispozitave, kriterëve, programeve ose praktikave në shikim të parë neutrale,



ekzistimin e bazës diskriminuese në përputhje me nenin 5 të LPMD-së,



komparatorin, përkatësisht një situatë krahasuese që nuk ka të bëjë me një person, por me një grup personash.

Duhet të dihet!

Në rastet e diskriminimit të tërthortë, nuk ka nevojë të demonstrohet lidhja kauzale ndërmjet bazës diskriminuese dhe trajtimit. Këtu është i rëndësishëm efekti i trajtimit.

Kur dallimi bëhet me ndonjë dispozitë ligjore dhe nëse efekti i zbatimit të kësaj dispozite kontestohet para KPMD-së, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës vetëm duke e vënë në pah këtë dispozitë dhe efektin e saj në grupin e lidhur me bazën diskriminuese vendos rastin prima facie të diskriminimit. Për më tepër, personi kundër të cilit është paraqitur parashtrësja e ka detyrimin të provojë se kjo dispozitë nuk është diskriminuese ndaj personit konkret apo grupit të personave.

64. Shih: Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, nr. 0801-136, 30 gusht 2021

Në diskriminimin e tërthortë, nevojitet të përdoret një numër i konsiderueshëm i llojeve të provave, duke e vënë në pah elementin e parë dhe të tretë konstituiv të diskriminimit, në mënyrë që të krijohet prezumimi i diskriminimit, veçanërisht duke e theksuar grupin joproportional në fjalë (elementi numër 1) dhe krahasimin (elementi numër 3). Praktika tregon përdorimin e të dhënave statistikore, bazave të të dhënave, raporteve mbi tendencat e vazhdueshme nga institucionet ndërkombëtare dhe burimet përkatëse kombëtare si dhe burimeve të tjera.

Ringelheim në punimin e tij shpjegon një metodë të veçantë statistikore, të quajtur “metoda e panelit”, e cila u zhvillua në Francë në vitet ‘90 të shekullit të kaluar për të shërbyer si një mjet provues në rastet e diskriminimit. Fillimisht e krijuar në kontekstin e diskriminimit të bazuar në anëtarësimin në sindikatë, ajo ka të bëjë me krahasimin e zhvillimit të karrierës së punonjësve meshkuj dhe femra te i njëjti punëdhënës që të përcaktohet nëse një ose disa punëtorë/e të veçantë/a kanë përjetuar rënie ose ndryshim në zhvillimin e tyre në krahasim me punëtorët mesatarë ose punëtorët mesatare, që nga momenti i zgjedhjes së tyre si përfaqësues/e të sindikatave. Pastaj e njëjta metodë mutatis mutandis u aplikua në rastet e diskriminimit në bazë të seksit dhe, në një masë më të vogël, edhe në rastet e diskriminimit në bazë të origjinës. Kjo metodë u njoh nga Gjykata Supreme e Francës dhe nga Këshilli i Shtetit si një bazë e besueshme mbi të cilën mund të konkludohet se ekziston prezumimi i diskriminimit.⁶⁵

Megjithatë, sigurimi i provave statistikore nuk është një detyrim, por një mundësi që mund të përdoret ose jo në rastin konkret për të bërë një prezumim të diskriminimit të tërthortë. Dhe nuk është gjithmonë e nevojshme të prezantohen prova statistikore për të krijuar një rast *prima facie* të diskriminimit. De Schutter pajtohet me të njëjtën, duke pohuar se elementi i pafavorshëm nuk duhet të përcaktohet statistikisht për të demonstruar një efekt negativ joproportional te grupi i prekur, sepse ndonjëherë njohuritë e përgjithshme janë të mjaftueshme për të krijuar prezumimin e diskriminimit.⁶⁶

Shembull: Në një ndërmarrje që merret me prodhimin e pjesëve të këmbimit të makinave, për një punëtor/e krahu kërkohet që të flasë rrjedhshëm gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, ndërkohë si njohuri e përgjithshme mund të konkludohet se një person nga bashkësia jo shumicë do të vihet në pozitë të pafavorshme në krahasim me ndonjë person tjetër gjuha amtare e të/së cilit/ës është maqedonishtja. Në këtë rast, nëse gjuha merret si bazë, bëhet fjalë për diskriminim të drejtpërdrejtë, por nëse gjuha merret vetëm si kriter neutral, kur analizohet rasti mund të tregohet se, në të vërtetë, bëhet fjalë për diskriminim të tërthortë në bazë të përkatësisë etnike për shkak të efektit negativ joproportional nga aplikimi i kriterit neutral në shikim të parë ndaj bashkësive jo shumicë.

65. Shih: Gjykata Supreme e Francës, Seksioni për të Drejta Sociale, P+B Fluchère, Dick v CFDT v SNCF, nr. 1027, 28 mars 2000; Këshilli i Shtetit i Francës, nr. 16-102017, 16 tetor 2017. Për më shumë informacione shih: Ringelheim, J. The burden of proof in anti-discrimination proceedings. A focus on Belgium, France and Ireland, in European equality law review, European network of legal experts in gender equality and non-discrimination, Publications Office of the European Union, Luxembourg, 2019, f. 58

66. Shih: De Schutter, O., Methods of proof in the context of combatting discrimination, in Cormack, J. (ed), Proving discrimination. Zbatimi dinamik i ligjit të BE-së kundër diskriminimit: The role of specialised bodies, Bruxelles, Migration Policy Group, 2003, f. 24.

1.2.1. Diskriminimi i tërthortë në bazë të seksit

Për të pasur një rast prima facie të diskriminimit të tërthortë në bazë të seksit, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet të tregojë:

- 1) pozitë të pafavorshme, përkatësisht efekt negativ joproportional nga zbatimi i akteve normative, dispozitave, kriterëve, programeve ose praktikave në shikim të parë neutrale,
- 2) ekzistim të bazës diskriminuese të seksit,
- 3) një komparator, përkatësisht një situatë krahasuese që nuk ka të bëjë me një person, por me një grup burrash kundrejt një grupi grash.

Shembull: Në rastin *Hoogendijk*, GJEDNJ-ja konsideron se kur parashtruesja mund të tregojë, në bazë të statistikave zyrtare të padiskutueshme, ekzistencën e kallëzimit prima facie se rregulli specifik, edhe pse i formuluar në mënyrë neutrale, në fakt ndikon qartë në përqindjen më të madhe të grave sesa të burrave, përgjegjësia i takon qeverisë të tregojë se kjo është rezultat i faktorëve objektivë që nuk janë të lidhur me ndonjë diskriminim në bazë të seksit (GJEDNJ, rasti *Hoogendijk*).⁶⁷

Shembull: Shembull: Në rastin *Seymour-Smith dhe Perez*, i cili ka të bëjë me përjashtimin e padrejtë nga puna, me çrast u jepet mbrojtje e veçantë atyre që kanë punuar për më shumë se dy vjet vazhdimisht tek punëdhënësi konkret. GJDBE-ja konsideron se kushtet për fitimin e disa të drejtave nga marrëdhënia e punës ose privilegjet do të ishin një rast prima facie diskriminimi të tërthortë, nëse të dhënat statistikore të aksesueshme tregojnë se një përqindje dukshëm më e ulët e grave sesa e burrave ishin në gjendje t'i përmbushnin kushtet. (GJDBE, rasti *Seymour-Smith and Perez*).⁶⁸

Shembull: Në rastin *Schönheit*, pensionet e punonjësve me orar të shkurtuar të punës janë përlllogaritur me shkallë të ndryshme në krahasim me atë që zbatohet për punonjësit me orar të plotë të punës. Aplikimi i një tarife të ndryshme nuk bazohet në dallimet në kohën e kaluar në punë. Së këtejmi, punonjësit me orar të shkurtuar të punës merrnin pension më të ulët se punonjësit me orar të plotë të punës, madje edhe kur do të merret parasysh kohëzgjatja e ndryshme e kaluar në punë, që në të vërtetë do të thotë se punonjësit me orar të shkurtuar të punës merrnin pensione më të ulëta. Me sa duket, rregulli neutral për përlllogaritjen e pensioneve zbatohet në mënyrë të njëjtë për të gjithë punonjësit me orar të shkurtuar të punës. Megjithatë, duke qenë se rreth 88% e punonjësve me orar të shkurtuar të punës ishin gra, efekti i këtij rregulli ishte joproportionalisht negativ për gratë në krahasim me burrat. Me këtë vetvetiu vendoset prezumimi i diskriminimit ndërsa barra e provës i kalon palës tjetër për të provuar se ajo nuk ka diskriminuar (GJDBE, rasti *Schönheit*).⁶⁹

67. Shih: GJEDNJ, *Hoogendijk* k. Holanda (dec.), Aplikimi nr. 58641/00, 6 janar 2005.

68. Shih: GJDBE, C-167/97, *Regina v. Secretary of State for Employment, ex parte Seymour-Smith and Perez*, [1999], ECR I-623, 9 shkurt 1999.

69. Shih: GJDBE, C-4/02 dhe C-5/02, *Hilde Schönheit* k. *Stadt Frankfurt am Main* dhe *Silvia Becker* k. *Land Hessen*, ECR I-12575, 23 tetor 2003.

1.2.2. Diskriminimi i tërthortë në bazë të përkatësisë etnike

Për të pasur një rast prima facie të diskriminimit të tërthortë në bazë të përkatësisë etnike, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet të tregojë:

- 1) pozitë të pafavorshme, përkatësisht efekt negativ joproportional nga zbatimi i akteve normative, dispozitave, kritereve, programeve ose praktikave në shikim të parë neutrale,
- 2) ekzistim të bazës diskriminuese të përkatësisë etnike,
- 3) një komparator, përkatësisht një situatë të krahasueshme që nuk ka të bëjë me një person, por me një grup personash nga një grup i caktuar etnik (për shembull, një bashkësi më pak e përfaqësuar) kundrejt një grupi personash nga një grupi tjetër etnik (komuniteti shumicë).

Shembull: Në rastin *Horváth and Kiss*, ku dy aplikantë romë në fëmijëri u diagnostikuan me një aftësi të kufizuar të lehtë mendore për shkak të së cilës u vendosën në një „shkollë speciale“, GJEDNJ-ja konstatoi se shteti kreu diskriminim të tërthortë (ky është një rast i segregimit në GJEDNJ). Në këtë rast, Gjykata shqyrtoi me vëmendje të veçantë nëse dhe në çfarë mase janë përdorur masat e posaçme mbrojtëse për të parandaluar një diagnozë të gabuar për shkak të së cilës fëmijët do të përfundonin në shkolla speciale ose klasa me plane mësimore dhe plan-programe që mund të kenë ndikim negativ në procesin e tyre arsimor në të ardhmen. Gjykata vërejti se fëmijët romë janë me numër më të madh në shkollat „speciale“ dhe se kjo ishte pasojë e një mase në shikim të parë neutrale që nuk kishte për qëllim konkretisht romët, por që i prekte në mënyrë joproportionale ata si një grup veçanërisht vulnerabil. GJEDNJ-ja theksoi se kjo ishte e dukshme madje edhe gjatë krahasimit të efektit të kësaj praktike lidhur me grupet e tjera të marginalizuara sociale. Gjykata konstatoi se parashtruesit mësonin në shkolla për fëmijë me aftësi të kufizuara të lehta mendore ku ndiqej një proces mësimor më i thjeshtuar dhe ku ata ishin të izoluar nga pjesa tjetër e popullsisë. Si pasojë, ata fituan një arsim që nuk ofronte garancitë e nevojshme që rezultojnë nga detyrimi pozitiv i shtetit për të shmangur pasojat e segregimit racor në shkollat „speciale“. Gjykata mes tjerash vuri në dukje se një arsim i këtillë në mënyrë plotësuese mund t'i ketë komplikuar problemet e tyre dhe e ka kompromentuar zhvillimin e mëvonshëm personal, në vend që t'i ndihmonte ata të integroheshin në shkollat e rregullta dhe t'i zhvillonin aftësitë e tyre (GJEDNJ, rasti *Horváth and Kiss*).⁷⁰

70. Shih: GJEDNJ, *Horvath and Kiss v. Hungary*, Aplikimi nr. 11146/11, 29 janar 2013.

Shembull: Për shembull, në një rast në të cilin banka refuzon të japë fonde në shumën e hipotekës për një pasuri të paluajtshme (shtëpi) të vendosur në një pjesë të caktuar të qytetit, nëse parashtruesi ose parashtruesja të cilit/ës i është refuzuar kredia paraqiti të dhëna statistikore që tregojnë se shumica e banorëve të asaj pjese të qytetit i përkasin një komuniteti të caktuar etnik, e njëjta gjë mjafton për të kaluar barrën e provës dhe për të bërë një rast *prima facie* të diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike. Në rastin konkret, parashtruesi dhe parashtruesja duhet të tregojë se: të dhënat statistikore që ai/ajo i ka siguruar janë përkatëse për të prezantuar fakte nga të cilat rezulton prezumimi i diskriminimit dhe duhet të bindë KPMD-në se statistikatat janë kredibile dhe të besueshme.⁷¹

Shembull: Në rastin *Binderen v. Kaya*, Gjykata Supreme e Holandës konsideron se parashtruesi tregoi se në vitet e kaluara ndërmarrja për apartamente sociale Binder kishte shpërndarë 157 apartamente sociale, nga të cilat vetëm një i ishte ndarë një familjes me prejardhje imigrantë, megjithëse përqindja e familjeve imigrantë në atë qytet ishte 4.6%, ndërsa nga numri i përgjithshëm i familjeve të regjistruara për strehim social ky numër ishte 10.2%. Nga ana tjetër, te ndërmarrjet e tjera për apartamente sociale, përqindja e apartamenteve të akorduara sociale për familjet imigrantë ishte 7.2%. Gjykata Supreme është e mendimit se faktet e bashkangjitura janë të mjaftueshme për ekzistimin e rastit *prima facie* të diskriminimit ndërkaq barrën e provës ia kaloi ndërmarrjes së apartamenteve sociale “Binder” që ta justifikojë politikën jodiskriminuese ndaj imigrantëve. Provat nuk u propozuan kështu që Gjykata Supreme konsideroi se ndërmarrja ka bërë diskriminim (Gjykata Supreme e Holandës, rasti NJ 1983, 687 (*Binderen v. Kaya*)).⁷²

Shembull: Në rastin *Noonan Services v. A Worker*,⁷³ Gjykata për Kontestet e Punës e Irlandës vendosi se kushti për zotërimin e gjuhës angleze qartas i vë personat në pozitë joproporcionale negative gjuha amtare e të cilëve është ndryshe nga gjuha angleze në krahasim me personat gjuhë amtare e të cilëve është anglishtja. Së këtejmi, Gjykata konsideron se kërkesa për zotërimin e gjuhës angleze vetvetiu paraqet rast *prima facie* të diskriminimit të tërthortë (Gjykata për Kontestet e Punës e Irlandës, rasti *Noonan Services v. A Worker*).

71. Shih: European Network Against Racism, *Changing Perspective: Shifting of the burden of proof in racial equality cases*, Bruxelles, 2006 година, стр. 11.

72. Shih: Gjykata Supreme e Hollandës, *Binderen v. Kaya*, NJ 1983, 687, 10 dhjetor, 1982

73. Shih: Gjykata për Kontestet e Punës e Irlandës, *Noonan Services v A Worker*, EDA1126, 29 korrik 2011.

1.2.3. Diskriminimi i tërthortë në bazë të aftësive të kufizuara

Për të pasur një rast *prima facie* të diskriminimit të tërthortë në bazë të aftësive të kufizuara, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet të tregojë:

- 1) pozitë të pafavorshme, përkatësisht efekt negativ joproporcional nga zbatimi i akteve normative, dispozitave, kritereve, programeve ose praktikave në shikim të parë neutrale,
- 2) ekzistim të aftësisë së kufizuar në bazë të diskriminimit,
- 3) një komparator, përkatësisht një situatë krahasuese që nuk ka të bëjë me një person, por me një grup personash me aftësi të kufizuara (lloji i caktuar i aftësisë së kufizuar - fizike, mendore, shqisore ose intelektuale) kundrejt një grupi personash pa aftësi të kufizuara ose me ndonjë lloj tjetër të aftësisë së kufizuar.

Shembull: Në rastin *European Action of the Disabled*, Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale konsideron se mjetet e kufizuara në buxhetin e shtetit në fushën e mirëqenies sociale, të destinuara për arsimin e fëmijëve dhe adoleshentëve me autizëm, në mënyrë të tërthortë iu shkaktën padrejtësi personave me aftësi të kufizuara. Komiteti nga njëra anë vlerësoi se financimi i kufizuar publik për mbrojtje sociale mund të ndikojë në mënyrë të barabartë mbi të gjithë personat e përfshirë me këtë mbrojtje, megjithatë, nga ana tjetër personat me aftësi të kufizuara ka shumë gjasa të varen nga kujdesi komunitar i financuar nga buxheti i shtetit për të jetuar të pavarur dhe me dinjitet, krahasuar me personat e tjerë. Kështu, kufizimet buxhetore në lidhje me politikën sociale i vendosin personat me aftësi të kufizuara në një pozitë joproporcionale të pafavorshme. Rrjedhimisht me këtë, EKSP përcaktoi se kufizimet buxhetore në shtet, në fushën e mirëqenies sociale, paraqesin diskriminim të tërthortë ndaj personave me aftësi të kufizuara (EKSP, rasti *European Action of the Disabled*).⁷⁴

Përshembull, në shpalljen për punësimin e nëpunësit/es administrativ/e kërkohet patentë shoferi. Në këtë rast, kriteri i vendosur në këtë mënyrë joproporcionalisht prek personat me aftësi të kufizuara, të cilët në një numër të madh nuk mund të pajisen me patentën e shoferit, me përjashtim të disa grupeve të personave me aftësi të kufizuara fizike.

1.2.4. Diskriminimi i tërthortë në bazë të religjionit ose besimit

Për të pasur një rast *prima facie* të diskriminimit të tërthortë në bazë të religjionit ose besimit, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet të tregojë:

74. Shih: EKSP, *European Action of the Disabled (AEH) v. France*, Aplikimi nr. 81/2012, 11 shtator 2013.

- 1) pozitë të pafavorshme, përkatësisht efekt negativ joproporcional nga zbatimi i akteve normative, dispozitave, kriterëve, programeve ose praktikave në shikim të parë neutrale,
- 2) ekzistencë të bazës diskriminuese të religjionit ose besimit,
- 3) një komparator, përkatësisht një situatë të krahasueshme që nuk ka të bëjë me një person, por me një grup personash me një religjion ose besim të caktuar (për shembull, një grup minoritar) kundrejt një grupi personash me një religjion ose besim tjetër (për shembull, grupi shumicë).

Shembull: Rasti nr. UEM-0921-1/2008-3, para Avokatit të Popullit të Sllovenisë për trajtim të barabartë, ka të bëjë me një punëdhënës, i cili siguronte racione/shujta për punonjësit, me çrast racionet e këtilla shpesh përfshinin produkte me mish derri ose ushqim të përgatitur me gjalpë derri. Si alternativë ndaj racioneve të ofruara, një punonjës mysliman kërkoi një pagesë mujore për të blerë ushqimin e tij, që është shtesë e pagës, e paguar nga punëdhënësi për punonjësit që mund të provonin nevojën për ushqim alternativ për arsye shëndetësore. Avokati i Popullit konsideron se kjo përbënte diskriminim të tërthortë, sepse një praktikë që në dukje ishte neutrale në të vërtetë prekte në mënyrë negative joproporcionale myslimanët, të cilëve nuk u lejohet të hanin prodhime dhe mish derri. Për shkak të rrethanave në rastin konkret, nuk kishte nevojë të paraqiten prova statistikore për të treguar se rregulli ndikon joproporcionalisht në mënyrë negative tek myslimanët, meqë është e lehtë të konfirmohet se myslimanët nuk guxojnë të hanë mish derri, duke iu referuar provave të praktikave të tyre religjioze. Barra e provës i kaloi personit kundër të cilit u parashtrua parashtrësja për ta provuar të kundërtën. (Avokati i Popullit për trajtim të barabartë, rasti nr. UEM-0921-1/2008-3).⁷⁵

Shembull: Rasti Eweida, për të cilin vendos Gjykata e Apelit e Mbretërisë së Bashkuar, kishte të bënte me një punëdhënës, i cili e ndaloi mbajtjen e aksesorëve (përfshirë këtu edhe për motive religjioze) në uniformën e punonjësve. Një punonjëse e krishterë pohonte se kjo përbënte diskriminim në bazë të religjionit të saj, sepse nuk i lejohej të mbante kryq. Gjatë procesit gjyqësor dhe ankesave të njëpasnjëshme, gjykatat kompetente pranuan se një ndalim i këtillë mund të përbëjë diskriminim të tërthortë në bazë të religjionit, nëse mund të provohet se mbajtja e kryqit është parakusht në kuadrin e besimit të krishterë. Për këtë qëllim, Gjykata e Kontesteve të Punës kërkoi prova nga ekspertët mjeko-ligjor në lidhje me praktikën e krishterë, ndërsa jo prova statistikore në lidhje me numrin e të krishterëve që mbajnë simbole religjioze në punë. Me vetë ndalimin e mbajtjes së aksesorëve të vendosur në mënyrë neutrale krijohet rasti prima facie i diskriminimit të tërthortë në bazë të religjionit ose besimit kurse barra e provës i kalon të paditurit për të provuar se nuk ka bërë diskriminim (Gjykata e Apelit të Mbretërisë së Bashkuar, rasti Eweida).⁷⁶

75. Shih: Avokati i Popullit për trajtim të barabartë të Sllovenisë, nr. UEM-0921-1/2008-3, 28 gusht 2008.

76. Shih: Gjykata e Apelit e Mbretërisë së Bashkuar, Eweida v. British Airways Plc., EWCA çështje nga e drejta civile nr. 80, 12 shkurt 2010.

1.2.5. Diskriminimi i tërthortë mbi një bazë tjetër

Për të pasur një rast *prima facie* të diskriminimit të tërthortë mbi ndonjë bazë tjetër të LPMD-së, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet të tregojë:

- 1) pozitë të pafavorshme, përkatësisht efekt negativ joproportional nga zbatimi i akteve normative, dispozitave, kritereve, programeve ose praktikave në shikim të parë neutrale,
- 2) ekzistim të bazës diskriminuese e cila konsiderohet se është prekur në rastin konkret,
- 3) një komparator, përkatësisht një situatë krahasuese që nuk ka të bëjë me një person, por me një grup personash me bazë diskriminuese të prekur në rastin konkret (për shembull, një moshë e caktuar, statusi social, statusi pronësor, etj.) kundrejt një grupi personash që nuk e posedon atë bazë të prekur.

1.2.6. Diskriminimi i shumëfishtë i tërthortë

Për të pasur një rast *prima facie* të diskriminimit të tërthortë mbi dy apo më shumë baza, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet të tregojë:

- 1) pozitë të pafavorshme, përkatësisht efekt negativ joproportional nga zbatimi i akteve normative, dispozitave, kritereve, programeve ose praktikave në shikim të parë neutrale,
- 2) ekzistencë të dy ose më shumë bazave diskriminuese në të njëjtën kohë (pavarësisht nëse ato janë të lidhura në mënyrë kumulative ose interseksionale),
- 3) një komparator, përkatësisht një situatë krahasuese që nuk ka të bëjë me një person, por me një grup personash me aftësi të kufizuara, që kryesisht është hipotetike për shkak të vështirësive të nënsegmentimit të grupit.

1.3. Forma dhe lloje të tjera të diskriminimit

1.3.1. Ngacmimi

Për të pasur një rast *prima facie* të ngacmimit në bazë të diskriminimit, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet të tregojë:

→ trajtim të padëshiruar (trajtimi verbal, joverbal ose fizik) që ka si qëllim ose pasojë cenimin e dinjitetit të personit ose grupit të personave të cilit i përket personi përkatës ose krijimin e një mjedisi, qasjeje ose praktike kërcënuese, armiqësore, poshtëruese ose frikësuese,

→ ekzistim të bazës apo bazave diskriminuese.

Duhet të dihet!

Gjatë përcaktimit të ngacmimit, nuk ka nevojë të identifikohet komparatori, përkatësisht situata krahasuese.

Gjatë përcaktimit të ekzistimit të ngacmimit dhe kalimit të barrës së provës, duhet të merret parasysh si më poshtë:





- » trajtimi “i padëshiruar” në të vërtetë është i njëjtë si edhe trajtimi “jo i mirëseardhur” ose “i paaprovuar”,
- » trajtimi i padëshiruar mund të përfshijë çdo lloj të sjelljes, duke e përfshirë fjalimin ose fjalën e shkruar apo keqtrajtimin, fotografitë, grafitit, gjestet fizike, shprehjet e fytyrës, mimikën, shakatë ose kontaktin fizik,
- » edhe një incident i cili është mjaft serioz mund të paraqesë ngacmim,
- » trajtimi do të ndërlidhet me bazën karakteristike/diskriminuese të mbrojtur, nëse baza zbatohet mbi personin (B) ose nëse ka ndonjë lidhje me bazën diskriminuese. Personi (B) mund të ketë përjetuar ngacmim sepse ai gabimisht mund të konsiderohet si person mbi të cilin zbatohet kjo bazë, ose për shkak të lidhjes së tij me ndonjë person mbi të cilin zbatohet kjo bazë, si p.sh. anëtar i familjes ose mik, ose për shkak të faktit se personi (B) njihet për mbështetjen e personave mbi të cilët është zbatuar kjo bazë,
- » nëse personi (A) përfshihet në sjellje të padëshiruar me qëllim që ta cenojë dinjitetin e personit (B) dhe të krijojë një mjedis kërcënues, armiqësor, poshtërues ose frikësues, atëherë kjo konsiderohet ngacmim, pavarësisht rezultateve konkrete mbi personin (B),
- » madje edhe nëse personi (A) nuk e ka atë qëllim, trajtimi i padëshiruar i personit (A) do të konsiderohet si ngacmim nëse e ka atë rezultat. Gjatë përcaktimit nëse trajtimi e ka arritur atë rezultat, gjykata do të marrë parasysh perceptimin e personit (B) dhe rrethanat e tjera relevante.

Shembull: Autoriteti i Barazisë i Hungarisë në rastin nr. 654/2009,⁷⁷ e ka shqyrtuar sjelljen e mësimit të romëve që u thanë nxënësve romë se sjellja e tyre e keqe në shkollë i është raportuar “Gardës Hungareze”, një organizatë nacionaliste e njohur për akte të dhunës ekstreme ndaj romëve. Vetë deklaratat e mësimit ishin të mjaftueshme për të kaluar barrën e provës. U konstatua se mësimit i mbështetën padyshim qëndrimet raciste të Gardës dhe në këtë mënyrë krijuan një klimë frike dhe frikësimi, që nënkupton ngacmim (Autoriteti i Barazisë i Hungarisë, rasti 654/2009).

Shembull: Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi në rastin nr. 0801 -312,⁷⁸ i shqyrtoi pretendimet e parashtrueses së parashtrësës e cila ka pohuar se është bërë një ngacmim në bazë të seksit dhe gjinisë ndaj një personi fizik, kandidat i atëhershëm për kryetar të njëjës prej komunave të shtetit. Në një emision debati, në të cilin mori pjesë edhe parashtruesja e parashtrësës, ai përdori një vokabular shqetësues të bazuar në seks dhe gjini, drejtpërdrejt të drejtuar parashtrueses së parashtrësës. KPMD-ja vlerësoi se pretendimet nga parashtrësja, provat dhe regjistrimet e bashkëngjitura të deklaratave të bëra në emision, e bënë pohimin të mundshëm dhe për këtë arsye barrën e provës ia kaloi personit kundër të cilit ishte paraqitur parashtrësja. Gjatë analizës së të gjitha fakteve dhe provave të rastit, Komisioni konstatoi ngacmim në bazë të seksit dhe gjinisë në fushën e mediave dhe informimit publik (KPMD, rasti nr. 0801-312).

1.3.2. Segregimi

Për të pasur një rast prima facie të segregimit në bazë të diskriminimit, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet të tregojë:

-  ndarje fizike,
-  ekzistim të bazës apo bazave diskriminuese,
-  një komparator, përkatësisht një situatë krahasuese,
-  mosekzistim të qëllimit legjitim ose objektivisht të justifikuar,

Sipas LPMD-së, neni 4 paragrafi 1 pika 7 përcakton se çfarë nënkuptohet me “qëllim legjitim dhe objektivisht të justifikuar”, përkatësisht e përkufizoi si një qëllim për realizimin e të cilit mjetet duhet

77. Shih: Autoriteti i Barazisë i Hungarisë, nr. 654/2009, 20 dhjetor 2009.

78. Shih: Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, nr. 0801-312, 13 dhjetor 2021.

të përkojnë me nevojat reale në rastin konkret, në mënyrë precize të përcaktohen paraprakisht, të jenë të domosdoshme për realizimin e këtij qëllimi, si dhe të jenë proporcionale me efektet që duhet të arrihen, përkatësisht e lidh ngushtë me testin e proporcionalitetit dhe dy elementët e tij: përshtatshmërinë dhe domosdoshmërinë.

Shembull: Në rastin *Oršuš and Others*, në të cilin bëhet fjalë për segregimin e fëmijëve romë në klasa të veçanta me një vëllim të reduktuar të programit mësimor, GJEDNJ-ja konstatoi se ka mundësi të vendoset për një pohim për diskriminim të tërthortë pa u mbështetur në të dhëna statistikore. Në rastin konkret, fakti që masa e sistemimit të fëmijëve në klasa të veçanta për shkak të njohjes së pamjaftueshme të gjuhës kroate zbatohet vetëm për nxënësit romë. Sipas kësaj, kjo njohuri vetvetiu çon në krijimin e supozimit për një trajtim të ndryshëm të pafavorshëm, përkatësisht diskriminim (GJEDNJ), rasti *Oršuš and Others*.⁷⁹

1.3.3. Përshtatja përkatëse

Sipas LPBD-së, pamundësimi i përshtatjes përkatëse është diskriminim. E njëjta gjë është përcaktuar me nenin 4 paragrafin 1 pikën 4, si ndryshim i domosdoshëm dhe përkatës dhe përshtatshmëri e nevojshme në një rast të caktuar, që nuk shkakton barrë joproporcionale ose të panevojshme, por me qëllim sigurimi i gëzimit ose ushtrimit i të gjitha të drejtave dhe lirive të personave me aftësi të kufizuara, mbi bazë të barabartë me të tjerët.

Rregullimi i përshtatshëm njihet edhe si detyrim për të bërë aranzhime, rregullime, përshtatje apo masa të arsyeshme, ose modifikime efektive ose të përshtatshme/përkatëse. T'i mundësohet personit përshtatje përkatëse nënkupton, për shembull, të përshtatet mjedisi i punës, sistemi i shkollimit, kapacitetet e kujdesit shëndetësor ose shërbimeve të transportit, me qëllim shmangia e barrierave që e pengojnë personin me aftësi të kufizuara të marrë pjesë në aktivitete ose të marrë shërbime në të njëjtën bazë si të tjerët. Në rast të punësimit, kjo mund të nënkuptojë ndryshim fizik të kushteve, blerje ose modifikim të pajisjeve, sigurim të lexuesit ose interpretuesit apo, trajnim ose mbikëqyrje përkatëse, rregullim të procedurave të provës ose vlerësimit, ndryshim të orëve standarde të punës ose ritransferimin e një personi tjetër në disa detyra marginale që rezultojnë nga vendi i punës.

79. Shih: GJEDNJ, *Oršuš and Others v. Croatia* [GC], Aplikimi nr. 15766/03, 16 mars 2010, paragrafi 152 dhe 153. Shih më tepër në European Union Agency for Fundamental Rights and Council of Europe, *Handbook on European non-discrimination law*, 2018 edition, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2018, crp. 247.

Shembull: Në rastin *Michael Lockrey*, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara theksoi se Shteti-Palë kontraktues nuk i ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar përshtatje përkatëse. Ai konkludoi se refuzimi për të siguruar interpretim në gjuhën e shenjave „auslan“ ose shënime stenografike pa bërë një vlerësim rrënjësor a do të nënkuptonte kjo një barrë joproporcionale ose të panevojshme përbën diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar dhe shkelje të nenit 5 të Konventës. Komiteti në vendimin e tij, veç tjerash, përcaktoi nëse një shtet pohon se përshtatja përkatëse të cilën e kërkon individ i krijon një barrë joproporcionale ose të panevojshme (si në këtë rast, kur shteti pohon se përdorimi i stenografëve „ndikon mbi kompleksitetin, çmimin dhe kohëzgjatjen e gjykimeve“), duhet të sigurojë „të dhëna ose analiza për të treguar se kjo do të ishte një barrë joproporcionale ose e panevojshme“ (Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, rasti *Michael Lockrey*).⁸⁰

Shembull: Në rastin *Guberina*, GJEDNJ-ja konsideron se autoritetet kroate nuk i morën parasysh nevojat e fëmijës me aftësi të kufizuar kur përcaktuan se babai nuk duhet të lirohet nga pagesa e tatimit mbi qarkullim për pronën e paluajtshme të cilën e ka ble, ndërkaq është e aksesueshme për fëmijën e tij me aftësi të kufizuar. Për më tepër, në përputhje me legjislacionin kroat, ky përjashtim, në të vërtetë, ishte në dispozicion të blerësve të cilët u shpërngulën me qëllim që t'i zgjidhin nevojat e tyre të banimit; përkatësisht kur prona e tyre e mëparshme nuk e posedonte „infrastrukturën bazë“ (përkatësisht nuk i ka përmbushur kushtet elementare higjienike teknike). Parashtruesi pohonte se aksesimi është element i „infrastrukturës bazë“ dhe se apartamenti i tij i mëparshëm nuk i plotësonte nevojat e banimit të familjes së tij. Nga ana tjetër, autoritetet kroate ishin të mendimit se apartamenti i vjetër i parashtruesit i posedonte të gjitha veçoritë bazë të infrastrukturës kështu që ato e refuzuan kërkesën e tij pa marrë parasysh rrethanat e veçanta të djalit të tij. GJEDNJ-ja e konfirmoi nevojën për t'i dhënë një interpretim të gjerë konceptit të mosdiskriminimit në bazë të aftësisë së kufizuar, duke përfshirë edhe diskriminimin në bazë të asociimit, kurse në rastin konkret konstatoi se kishte diskriminim ndaj babait në bazë të aftësisë së kufizuar të fëmijës, sepse autoritetet kroate nuk arritën ta përgënjeshtrojnë supozimin e diskriminimit (GJEDNJ, çështja *Guberina*).⁸¹

80. Shih: Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, *Michael Lockrey v. Australia*, Aplikimi nr. 13/2013, CRPD/C/15/D/13/2013, 25 Prill 2016, paragrafi 8.5.

81. Shih: GJEDNJ, *Guberina v. Croatia*, Aplikimi nr. 23682/13, 22 mars 2016.

Duhet të dihet!

Ekzistojnë një sërë faktorësh që duhen marrë parasysh kur vlerësohet nëse përshtatja është përkatëse ose jo:

- » efekti i përshtatjes duhet ta ndihmojë të punësuarin/en me aftësi të kufizuara që ta kryejë detyrën e tij/saj të punës,
- » zbatueshmëria e përshtatjes,
- » shpenzimet monetare ose shpenzimet e tjera të përshtatjes,
- » vëllimi i burimeve financiare të organizatës dhe i burimeve të tjera financiare,
- » vëllimi i çrregullimeve të shkaktuara,
- » vëllimi i ndihmës financiare ose i ndihmës tjetër nga ana e shtetit për realizimin e përshtatjes,
- » • natyra e aktiviteteve dhe madhësia e organizatës.

Dallimi midis diskriminimit të tërthortë dhe përshtatjes përkatëse ndërlidhet me përfshirjen dhe qasjen. Përkatësisht, përfshirja e diskriminimit të tërthortë është përqendruar mbi “një grup më të gjerë njerëzish që ndajnë dhe kanë një tipar të caktuar mbrojtës, të cilëve u është bërë padrejtësi ose potencialisht do t’u bëhej padrejtësi nga masa e kontestuar”, ndërkaq përshtatja përkatëse është fokusuar mbi personin me aftësi të kufizuara në një situatë të caktuar dhe konkrete. Për sa i përket efektit të zbatimit, diskriminimi i tërthortë kërkon përcaktimin nëse dispozita, kriteri apo praktika kanë efekt diskriminues, përkatësisht efekt negativ joproporcional. Nga ana tjetër, detyrimi i përshtatjes përkatëse kërkon miratimin e masave specifike për shmangien e pamundësisë me të cilën ballafaqohet personi në fjalë me aftësi të kufizuara në një situatë të caktuar *ad hoc*.

Lexo më tepër!

Në Udhëzuesin për Përshtatje Përkatëse mbi përshtatjen përkatëse të personave me aftësi të kufizuara.

Megjithatë, sipas LPMD-së mossaigurimi i aksesit paraqet diskriminim. E njëjta gjë është përcaktuar me nenin 4 paragrafin 1 pikën 5, si “akses në infrastrukturë, mallra dhe shërbime” që nënkupton ndërmarrjen e masave të duhura që garantojnë se personat me aftësi të kufizuara kanë akses, në baza të barabarta me të tjerët, në mjedisin fizik, transportin, informacionet dhe komunikimit, duke përfshirë teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, në objekte dhe shërbime të tjera publike në zonat urbane dhe rurale. Ndryshe nga përshtatja përkatëse e shpjeguar më lartë, detyrimet për të siguruar akses janë të përgjithshme, të parashikueshme dhe nuk bazohen në një kërkesë individuale. Sipas Komentit të Përgjithshëm Nr. 2 të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara pranë Kombeve të Bashkuara, ato duhet të “harmonizohen me standardet e disenjit universal, për shembull, vendosja ose ndërtimi i rampave ose sigurimi i informacioneve me Alfabetin Braj ose me formate lehtësisht të kuptueshme.” Detyrimi për të siguruar akses synon

rikonstruksionin e mjedisit të drejtpërdrejt dhe mjedisit më të gjerë në përgjithësi dhe transformimin e strukturave sociale.

Shembull: Rasti i R.M.-së kundër Komunës së Dellçevës, të cilin e udhëhoqi Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj, është rasti i parë në praktikën gjyqësore kombëtare në lidhje me të cilin u miratua një aktgjykim i formës së prerë me të cilin konstatohet diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar mendore dhe fizike. Rasti ka të bëjë me një 17-vjeçar me aftësi të kufizuara të kombinuara, i cili tanimë për një kohë të gjatë nuk mund të dalë nga shtëpia e tij familjare pa shoqërim për shkak se në dalje nga oborri nuk ka bordurë dhe trotuar, përkatësisht menjëherë dilet në rrugë në të cilën ka trafik të ngarkuar. Është karakteristike se babai dhe gjyshi i personit, në periudhën nga viti 2012 deri në paraqitjen e padisë në vitin 2014, disa herë i janë drejtuar Komunës së Dellçevës me kërkesë për vendosjen e bordurave dhe trotuarit në rrugën përreth shtëpisë që personi të mund të dalë nga shtëpia pa pasur nevojë për shoqërim të vazhdueshëm. Pavarësisht premtimeve të vazhdueshme, komuna nuk ndërmoi hapa për zgjidhjen e problemit.

Në këtë rast, Gjykata Themelore në Dellçevë konstatoi diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar për shkak të pamundësisë së aksesit dhe disponueshmërisë së infrastrukturës, mallrave dhe shërbimeve. Në aktgjykim përcaktohet se diskriminimi është kryer për shkak të mosndërmarrjes së veprimeve (ndërtim i trotuarit dhe bordurës) për përshtatjen e infrastrukturës dhe hapësirës rreth shtëpisë së paditësit - personit me aftësi të kufizuara. Rrjedhimisht, Gjykata e ngarkoi Komunën e Dellçevës, si palë e paditur, që të përshtatë infrastrukturën dhe hapësirën dhe t'i marrë të gjitha masat e nevojshme e përshtatjes me anë të ndërtimit të trotuarit dhe bordurës në përputhje me standardet teknike për hyrje-dalje.



Duhet të dihet!

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara e sublimoi dallimin midis përshtatjes përkatëse dhe hyrje-daljes si më poshtë: „Hyrje-dalja ka të bëjë me grupe, ndërsa përshtatja përkatëse ka të bëjë me individë.“ Komiteti në mënyrë plotësuese theksoi se: „sigurimi i hyrje-daljes është detyrim ex ante. Shtetet duhet t'i përcaktojnë standardet e hyrje-daljes dhe ato duhet të vlejnjë për të gjitha institucionet ose organizatat publike dhe private.“ Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara konfirmoi se shtetet „kanë detyrimin të sigurojnë hyrje-dalje përpara se të marrin një kërkesë individuale për të përdorur një vend ose shërbim“. Ndërkaq përshtatja përkatëse është detyrim ex nunc, përkatësisht “kryhet nga momenti kur personi me aftësi të kufizuara ka nevojë për përshtatje në situatën e dhënë”.

Dallimi tjetër është aspekti pjesëmarrës i personave me aftësi të kufizuara. Për të përmbushur detyrimin e përshtatjes përkatëse, nevojitet dialogu ndërmjet individit me aftësi të kufizuar dhe bartësit të detyrimit (subjekt publik ose privat). Së këtejmi, duhet pasur parasysh se „modifikimet që do të rezultojnë dhe do t'i referohen zgjidhjes së paaftësisë konkrete në një mënyrë të përshtatshme për personin, mund të nënkuptojnë marrjen e masave që nuk do të ishin të dobishme për personat me të njëjtën ose me një paaftësi të ngjashme“. Për sa i përket hyrje-daljes, nevojitet një dialog ndërmjet vendimmarrësve dhe organizatave të personave me aftësi të kufizuara, ndërsa masat dhe standardet e përgjithshme për akses, si dhe mekanizmat për zbatimin e masave dhe standardeve të këtylla, do të sigurojnë akses të plotë në një mjedis të caktuar fizik, transport, informacione dhe komunikim dhe në shërbimet publike.

1.3.4. Thirrje, nxitje dhe instruksione për diskriminim

Për të pasur një rast prima facie të thirrjes, nxitjes dhe udhëzimeve për diskriminim, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet të tregojë:

-  aktivitet me të cilin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë bëhen thirrje, inkurajohen, artikulojnë udhëzime ose nxitje që të kryhet diskriminim,
-  ekzistim të bazës apo bazave diskriminuese.

Udhëzimi për diskriminim e nënkupton si të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë thirrjen, inkurajimin, udhëzimin ose nxitjen e një personi tjetër për kryer diskriminim.



Shembull: Gjykata e Qarkut në Sofje e shqyrtoi rastin nr. 2860/2006,⁸² në të cilin një deputet ka bërë disa deklaratat, në të cilat ka sulmuar verbalisht komunitetin rom, hebre dhe turk dhe “të huajt” në përgjithësi. Konkretisht, ai kishte deklaruar se komunitetet e përmendura i pengojnë bullgarët të drejtojnë vendin e tyre, kryejnë vepra penale dhe mbeten të pandëshkuar, si dhe i privojnë bullgarët nga kujdesi adekuat shëndetësor, me çrast u ka bërë thirrje njerëzve që të mos lejojnë që vendi të bëhet „koloni“ e grupeve të këtilla dhe të grupeve të tjera të ngjashme. Vetë deklaratat ishin të mjaftueshme për të krijuar një rast prima facie të diskriminimit dhe në këtë mënyrë barra e provës t’i kalojë të paditurit për të provuar se ai nuk ka bërë diskriminim. Gjykata e Qarkut në Sofje përcaktoi se deklaratat dhe sjelljet e tilla përbëjnë thirrje dhe nxitje për diskriminim si dhe ngacnim (Gjykata e Qarkut në Sofje, nr. 2860/2006).

Duhet të dihet!

Si te ngacmimi ashtu edhe te udhëzimi për diskriminim, nuk ka nevojë të detektohet komparatori në mënyrë që të provohet ekzistimi i diskriminimit.

1.3.5. Viktimizimi

Viktimizimi është një formë diskriminimi, i cili shfaqet si pësim i pasojave të dëmshme nga një person për shkak të ndërmarrjes së veprimeve për mbrojtje nga diskriminimi, ndërkaq i përfshin personat të cilët e denoncojnë diskriminimin, personat të cilët paraqesin parashtrësia për diskriminim, si dhe dëshmitarët në rastet e diskriminimit.

-  pësim të pasojave të dëmshme,
-  shkakun e ndërmarrjes së veprimeve për mbrojtje nga diskriminimi.

82. Shih: Gjykata e Qarkut në Sofje, nr. 2860/2006, 21 qershor 2006.

Si viktimizim përshkruhet çdo masë kundërshtuese që ndërmerret nga një organizatë (përfshirë këtu edhe punëdhënësit dhe institucionet publike) ose nga një individ si hakmarrje për përpjekjet për të zbatuar legjislacionin kundër diskriminimit. Shembulli më i zakonshëm është kur një punonjës ose punonjëse ankohet për trajtim të pabarabartë ndërsa punëdhënësi përgjigjet duke e përjashtuar nga puna ose duke mos e avancuar edhe pse ai/ajo e meriton.

1.3.6. Forma më të rënda të diskriminimit

Diskriminimi i shumëfishtë, diskriminimi ndërsektorial, diskriminimi i përsëritur dhe diskriminimi i vazhdueshëm, të përcaktuar me nenin 4 paragrafin 1 pikat 10, 11, 12 dhe 13, konsiderohen si forma më të rënda të diskriminimit, sipas LPMD-së. Karakteristikë e formave më të rënda të diskriminimit është ajo se ndonjë nga format dhe llojet e diskriminimit mund të përkufizohen si më të rënda, nëse diskriminimi është kryer mbi disa baza diskriminuese (diskriminim i shumëfishtë), nëse është kryer mbi dy ose më shumë baza diskriminuese, të cilat janë, njëkohësisht të ndërlidhura në mënyrë të pandashme (ndërsektoriale), nëse është kryer disa herë mbi të njëjtën bazë ose baza diskriminuese (diskriminim i përsëritur), dhe nëse është kryer vazhdimisht për një periudhë më të gjatë kohore (diskriminim i vazhdueshëm).

Për të pasur rast prima facie të formës më të rëndë të diskriminimit, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës, përveç elementeve të tjerë përbërës të formës që e pohon, duhet të tregojë se është i mundshëm edhe elementi plotësues i:

- » veprimit ose trajtimit të pandërprerë për një periudhë më të gjatë kohore (tek diskriminimi i vazhdueshëm), përkatësisht
- » kryerjes së shumëfishtë të veprimit mbi bazën ose bazat e njëjta diskriminuese (tek diskriminimi i përsëritur), ose
- » ekzistimit të dy ose më shumë bazave (tek diskriminimi i shumëfishtë) që janë, njëkohësisht të lidhura në mënyrë të pandashme (tek diskriminimi ndërsektorial).

Shembull: Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi në rastin nr. 0801-265⁸³ i shqyrtoi pretendimet e parashtruesve të parashtrësës, kundër Ministrisë së Shëndetësisë, të cilët pohonin se ka diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar në ushtrimin e së drejtës për vaksinim. Në parashtrësë është specifikuar se personave me aftësi të kufizuara u është pamundësuar qasja fizike në pikat e vaksinimit, informimi i tyre në lidhje me procesin e imunizimit nuk është si duhet, ndërsa autoritetet shëndetësore nuk u lëshojnë certifikata përkatëse personave me aftësi të kufizuara, të cilët për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore nuk guxojnë të vaksinohen. KPMD-ja konsideron se pretendimet e parashtrësës dhe provat e paraqitura, pohimin e kanë bërë të mundshëm, kështu që barrën e provës ia kaloi personit kundër të cilit është paraqitur - Ministria e Shëndetësisë ta përgënjeshtrojë prezumimin e diskriminimit. Gjatë analizës së të gjitha fakteve dhe provave të rastit, Komisioni përcaktoi diskriminim të vazhdueshëm të drejtpërdrejtë mbi bazën e aftësisë së kufizuar në fushën e aksesit në të mirat (shëndetësore) dhe shërbimet që kanë të bëjnë me vaksinimin (KPMD, rasti nr. 0801-265).

83. Shih: Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, nr. 0801-265, 9 dhjetor 2021.

Shembull: Në rastin *Sejdić and Finci*, GJEDNJ-ja përcaktoi diskriminim, sepse me Kushtetutën e Bosnjë e Hercegovinës parashikohet që anëtarët e Dhomës së Ulët të Parlamentit dhe Kryesisë të jenë pjesëtarë të bashkësive më të mëdha etnike (si popuj konstituiivë edhe atë: boshnjakë, kroatë dhe serbë), dhe në mënyrë automatike i përjashton anëtarët e bashkësive më të vogla të garojnë për anëtarë të Dhomës së Ulët të Parlamentit dhe Kryesisë së këtij shteti, siç ishin parashtruesit njëri hebre dhe tjetri rom. Për shkak se Kushtetuta e Bosnjë e Hercegovinës nuk është ndryshuar dhe rrjedhimisht me këtë nuk është tejkualuar diskriminimi, rasti vazhdon (KEDNJ, rasti *Sejdich dhe Finci*).⁸⁴

Shembull: Në rastin *Mental Disability Advocacy Center*, Komiteti konstatoi shkelje të Kartës Sociale Evropiane të rishikuar, përkatësisht shkelje të së drejtës për arsimim, në përpunje me nenin E (mosdiskriminimi). Me fjalë të tjera, në vendimin e tij, Komiteti kritikon hapur Bullgarinë për praktikën aktive të përjashtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara intelektuale nga sistemi arsimor, duke theksuar se 3000 fëmijë me aftësi të kufizuara intelektuale të mesme dhe të rëndë që jetojnë në 28 shtëpi për fëmijë me aftësi të kufizuara mendore u është shkurtuar e drejta për arsimim efektiv. Duke kritikuar standardet joadekuate të arsimit inkluziv në Bullgari, Komiteti theksoi se: „sistemi i rregullt arsimor nuk është as i aksesueshëm dhe as i përshtatur për fëmijët me aftësi të kufizuara që jetojnë në shtëpi për fëmijë me aftësi të kufizuara mendore; trajnimi i mësimdhënësve nuk është adekuat ndërsa programi mësimor dhe mjetet ndihmëse mësimore nuk janë përshtatur me nevojat e veçanta arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara intelektuale; Qeveria e Bullgarisë nuk pati sukses në zbatimin e ligjit të vitit 2002, i cili parashikon përfshirjen në procesin arsimor të fëmijëve që qëndrojnë në shtëpitë e fëmijëve me aftësi të kufizuara mendore; si rezultat i moszbatimit të këtij ligji, vetëm 6.2% të fëmijëve që qëndrojnë në shtëpitë e fëmijëve me aftësi të kufizuara mendore shkojnë në shkollë, ndërkaq përqindja e pjesëmarrjes në arsimin fillor i të gjithë fëmijëve në Bullgari është 94%; dallimi i frekuentimit të procesit mësimor të fëmijëve me dhe pa aftësi të kufizuara është aq i madh, saqë paraqet diskriminim për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale, të cilët jetojnë në shtëpitë për fëmijë me aftësi të kufizuara mendore“ (EKSP rasti *Mental Disability Advocacy Center*).⁸⁵

84. Shih: GJEDNJ, *Sejdić dhe Finci v. Bosnia and Hercegovina*, Aplikimi nr. 27996/06 dhe 34836/06, 22 dhjetor 2009.

85. Shih: EKSP, *Mental Disability Advocacy Center v. Bullgaria*, Aplikimi nr. 41/2007, 3 qershor 2008.

Shembull: Komiteti për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave pranë Kombeve të Bashkuara në rastin S.B. dhe M.B., nga viti 2020, në të cilin dy gra rome e kishin të kufizuar aksesin në shërbimet gjinekologjike për shkak të përkatësisë së tyre etnike, në vendim thekson se diskriminimi ndaj grave në bazë të seksit dhe gjinisë në mënyrë specifike ka të bëjë me faktorë të tjerë që prekin gratë, siç është raca, përkatësia etnike, feja ose besimi fetar, shëndeti, statusi, moshë, klasa, kasta, orientimi seksual dhe identiteti gjinor. Veç tjerash thekson se diskriminimi i bazuar në seks ose gjini mund t'i godasë gratë të cilat u përkasin këtyre grupeve në një shkallë të ndryshme dhe në mënyra të ndryshme nga burrat, ndërsa shtetet anëtare duhet ligjërisht t'i detektojnë dhe ndalojnë format e këtyra të shumëfishta të diskriminimit dhe ndikimin e tyre negativ kumulativ mbi gratë e prekura. Parashtrueset u trajtuan në mënyrë të pafavorshme në krahasim me gratë e tjera të moshës riprodhuese që nuk i përkisnin grupit etnik minoritar, të cilat njëkohësisht kishin nevojë për shërbime gjinekologjike. Komiteti vë në dukje se në rastin konkret, gjykatat nuk kishin mirëkuptim për shfaqjen e diskriminimit dhe fragjilitetin e grave rome në shoqëri dhe se, pavarësisht provave për trajtim të pabarabartë, gjykatat nuk arritën të konstatojnë se gjinekologu kishte qëndrim diskriminues dhe të sigurojnë mbrojtje ligjore nga diskriminimi, kështu që konstatoi se shteti i ka diskriminuar parashtrueset në bazë të seksit, gjinisë dhe përkatësisë etnike (Komiteti për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, rasti SB and MB).⁸⁶

86. Shih: Komiteti për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, SB dhe MB v. North Macedonia, CEDAW/C/ 77/D/143/2019, 1 dhjetor 2020.

2. Përgënjeshtrimi i supozimit për diskriminim dhe justifikimi objektiv

Pasi që parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës do të bëjë një rast diskriminimi *prima facie*, përkatësisht do ta bëjë të mundshme të ekzistojë një rast diskriminimi, atëherë barra e provës i kalon personit kundër të cilit është paraqitur parashtrësja për të provuar se ai/ ajo nuk ka diskriminuar përmes përgënjeshtimit të supozimit për diskriminim të bërë. Deklaratat të cilat nuk mund të verifikohen në lidhje me arsyet pse personi kundër të cilit është paraqitur parashtrësja u soll ashtu siç u soll nuk janë të mjaftueshme.

Shembull: *Gjykata e Kontesteve të Punës e Irlandës në rastin Campbell Catering Ltd v. Aderonke Rasaq,*⁸⁷ theksoi se provat duhet të jenë të argumentuara dhe bindëse, që me sukses të përgënjeshtrohet supozimi për diskriminim.

Përgënjeshttrimin e supozimit të diskriminimit të bërë mund ta bëjë personi kundër të cilit është paraqitur parashtrësja në dy mënyra, si vijon:

- » të provojë se parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës, në të vërtetë nuk është në gjendje të ngjashme ose të krahasueshme me komparatorin, ose
- » se trajtimi i ndryshëm në rastin e diskriminimit të drejtpërdrejtë nuk mbështetet në bazën diskriminuese në fjalë por në faktorë të tjerë objektivë, ndërsa në rastin e diskriminimit të tërthortë të dhënat e paraqitura statistikore mund të interpretohen ndryshe, ose se efekti negativ nuk është joproporcional me qëllimin legjitim dhe me testimin e proporcionalitetit.

E njëjta gjë është theksuar nga GJEDNJ-ja në shumë raste që i ka shqyrtuar, si për shembull, në rastin Khamtokhu and Aksenchik, rasti Chassagnou, rasti Biao, si dhe rasti *_07728 Timishev _1* dhe rasti D.H., të shpjeguar më sipër.⁸⁸

87. Shih: Equality Tribunal, *Campbell Catering Ltd v. Aderonke Rasaq*, 2004- EEDO48.

88. Shih: GJEDNJ, *Khamtokhu and Aksenchik k. Russia* [GC], Aplikimet nr. 60367/08 dhe 961/11, 24 janar 2017, paragrafi 65; GJEDNJ, *Chassagnou and Others k. France* [GC], Aplikimet nr. 25088/94, 28331/95 dhe 28443/95, 29 prill 1999, paragrafët 91 dhe 92; GJEDNJ, *Biao v. Denmark* [GC], Aplikimi nr. 38590/10, 24 maj 2016, paragrafi 114; GJEDNJ, *Timishev v. Russia*, Aplikimet nr. 55762/00 dhe 55974/00, 13 dhjetor 2005, paragrafi 39 dhe GJEDNJ, *D.H. and Others v. the Czech Republic* [GC], Aplikimi nr. 57325/00, 13 nëntor 2007, paragrafi 178.

Shembull: Në rastin nr. 0801-262,⁸⁹ në të cilin parashtruesja e parashtrësës pohonte se djali i saj ishte diskriminuar në bazë të statusit të vaksinimit, gjegjësisht statusit personal, nga shkolla fillore komunale, duke refuzuar regjistrimin e personit bazuar në faktin se ka munguar vërtetimi për vaksinat e pranuar të detyrueshme, Komisioni nuk përcaktoi diskriminim, por miratoi rekomandim të përgjithshëm. Në rekomandimin e përgjithshëm të vitit 2021, Komisioni thekson se: “Konventa për të Drejtat e Fëmijës garanton “interesin më të mirë të fëmijës” në të gjitha veprimet e ndërmarra në lidhje me fëmijët, pavarësisht nëse ato ndërmerren nga institucionet publike, gjykatat, organet administrative apo organet legjislative. Për më tepër, në rastin Vavriçka (Nr. 47621/13), GJEDNJ e vuri në dukje ekzistencën e një konsensusi të përgjithshëm se vaksinimi është një nga ndërhyrjet shëndetësore më të suksesshme dhe me kosto efektive dhe se çdo shtet duhet të synojë të arrijë nivelin më të lartë të mundshëm të vaksinimit në popullatën e saj. Nga ana tjetër, ligjet, masat, rekomandimet dhe aktet e tjera relevante që synojnë parandalimin, kurimin dhe kontrollin e situatës së sëmundjeve epidemike, endemike dhe sëmundjeve të tjera nuk përbëjnë shkelje të së drejtës së individit për privatësi, për jetën e tij personale dhe familjare dhe dinjitetin dhe reputacionin. Ato synojnë të garantojnë mbrojtjen e të mirës publike dhe mbrojtjen e shëndetit publik të të gjithë qytetarëve, veçanërisht të fëmijëve. Rrjedhimisht me këtë, Komisioni miratoi një rekomandim të përgjithshëm se vaksinimi i detyrueshëm i fëmijëve si kusht për regjistrim në shkollat fillore nuk përbën diskriminim mbi asnjë bazë.” (KPMD, rasti nr. 0801-262).

Shembull: Në rastin nr. 08-7,⁹⁰ në të cilin parashtruesja e parashtrësës pohoi se ka pasur diskriminim në bazë të bindjes politike nga Agjencia e Administratës në Fushën e Punës dhe Marrëdhëniet të Punës, KPMD e kaloi barrën e provës. Mirëpo, në përgjigjen e parashtrësës, janë dhënë fakte shpjeguese të cilat e ndihmuan KPMD-në gjatë analizës së të gjitha fakteve dhe provave në fjalë për të konstatuar se Agjencia e Administratës e përgënjeshtroi supozimin për diskriminim sepse të gjithë kandidatëve iu mundësua të aplikojnë për vendin e punës dhe t'i marrin pikët në përputhje me Ligjin për nëpunësit administrativë (KPMD, rasti nr. 08-7).

Shembull: Në drejtim të njëjtë si në rastin e shpjeguar më sipër, dhe në rastin nr. Nr. 0801-269, në të cilin parashtruesi i parashtrësës pohoi se ka diskriminim në bazë të përkatësisë etnike nga Akademia për Gjuetarë dhe Prokurorë Publikë, KPMD e kaloi barrën e provës. Mirëpo, në përgjigjen e parashtrësës, janë dhënë fakte shpjeguese që e kanë ndihmuar KPMD-në gjatë analizës së të gjitha fakteve dhe provave në fjalë në mënyrë që të përcaktojë se Akademia e Gjuetarëve dhe Prokurorëve Publikë e përgënjeshtroi parashtrësën për diskriminim meqë veprimi në përputhje me dispozitat e Ligjit për Akademinë e Gjuetarëve dhe Prokurorëve Publikë dhe me aktet nënligjore të Akademisë (KPMD, rasti nr. 0801-269).⁹¹

89. Shih: Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, nr. 0801-262, 7 korrik 2021.

90. Shih: Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, nr. 08-7, 7 korrik 2021.

91. Shih: Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, nr. 0801-269, 13 nëntor 2021.

Shembull: Në rastin e lartpërmendur *Brunnhofer*, GJDBE-ja dha udhëzime se si të përgënjeshtrohet supozimi për diskriminim të kryer. Së pari, nëse provohet se burrat dhe gratë e punësuar/a nuk janë në gjendje të ngjashme, sepse nuk është kryer punë me vlerë të njëjtë, përkatësisht puna përfshin detyra dhe detyrime që kanë natyrë të ndryshme esenciale, dhe së dyti, përmes vendosjes së faktorëve të tjerë objektivë të cilët kanë kontribuar në diferencën e pagës, ndërsa nuk kanë të bëjnë me përkatësinë e paditëses ndaj një seksi të caktuar, në këtë rast seksit femër, faturat si kompensim për jetë të ndarë apo shpenzimet e udhëtimit dhe ngjashëm (GJDBE, rasti *Susanna Brunnhofer*, paragrafët nga 51 deri në 62).

Shembull: Në rastin *Feryn*, që ka të bëjë me diskriminimin e drejtpërdrejtë në bazë të përkatësisë etnike, rasti *prima facie* i diskriminimit, i përcaktuar me deklaratën publike të pronarit të firmës se ai nuk do të punësojë marokenë, sipas GJDBE-së mund të përgënjeshtrohet nëse i padituri në këtë rast, për shembull, provon se praktika e punësimit, në të vërtetë, nuk tregon trajtim të ndryshëm ndaj personave që nuk e kishin ngjyrën e bardhë të lëkurës, përkatësisht e vë në dukje faktin se pikërisht personeli i tillë ishte punësuar sipas rutinës (GJDBE, rasti *Feryn*).⁹².

Shembull: Në rastin *Asociația ACCEPT*, të diskriminimit në bazë të orientimit seksual gjatë rekrutimit të lojtarëve nga një klub profesionist futbollit, GJDBE-ja konsideron se rasti *prima facie* i diskriminimit mbi bazë të orientimit seksual mund të përgënjeshtrohet me një grup të provave konsistente... një grup i tillë provash mund të përfshijë, për shembull, reagim nga i padituri duke u distancuar qartë nga deklaratat publike mbi të cilat bazohet supozimi për diskriminim, si dhe ekzistenca e dispozitave eksplicite që kanë të bëjnë me politikën e punësimit në drejtim të sigurimit të harmonizimit me parimin e trajtimit të barabartë. Gjykata vazhdoi duke theksuar se kalimi i barrës së provës nuk kërkon paraqitjen e provave të pamundura pa ndërhyrë në të drejtën e privatësisë (GJDBE, rasti *Asociația ACCEPT*).⁹³.

92. Shih: GJDBE, C-54/07, *Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding v. Firma Feryn NV*, 10 korrik 2008.

93. Shih: GJDBE, C-81/12, *Asociația Accept v. Consiliul Național pentru Combaterea Discriminării*, 25 prill 2013, paragrafët 58 dhe 59.

Shembull: Në rastin *Test-Achats*, ku e drejta belge u lejon shërbimeve të siguracionit ta përdorin seksin si faktor në përlllogaritjen e premive të siguracionit dhe pagesave bazuar në përjashtimin e përfshirë me nenin 5(2) të Direktivës së Këshillit 2004/113/EC. Parashtruesit e kontestuan të drejtën belge, e cila e praktikon këtë përjashtim dhe theksuan se është në kundërshtim me parimin e barazisë midis burrave dhe grave. GJDBE-ja vlerësoi se përdorimi i faktorëve aktuarialë në lidhje me seksin ishte një praktikë e pranuar gjerësisht në fushën e shërbimeve të siguracionit kur u miratua Direktiva, kështu që konsiderohej si adekuate që e njëjta të përfshijë një periudhë të caktuar kalimtare. Për më tepër neni 5(1) i Direktivës parashikonte që diferencat e premive dhe pagesave të cilat bazohen në seksin si faktor i përlllogaritjes duhet të anulohen më së voni deri më 21 dhjetor 2007, neni 5(2) ka lejuar disa shtete anëtare të Bashkimit Evropian të aprovojnë diferenca proporcionale në premite dhe pagesat e individëve edhe atë për një kohë të pakufizuar, përkatësisht kur përdorimi i seksit është faktor vendimtar në vlerësimin e rreziqeve që bazohen mbi të dhënat aktuariale dhe statistikore relevante dhe të sakta. Si rezultat i kësaj, gratë dhe burrat paguanin shumën të ndryshme të polisave private të sigurimeve. Gjykata, duke e bazuar argumentin e saj mbi Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, vendosi se kjo praktikë përbën diskriminim në bazë të seksit kurse neni 5(2) duhet të konsiderohet si i pavlefshëm pas skadimit të periudhës së caktuar kohore, që në rastin konkret është data 21 dhjetor 2012 (GJDBE, rasti *Test-Achats*).⁹⁴.

94. Shih: GJDBE, C-236/09, *Association Belge des Consommateurs Test-Achats ASBL and Others v Conseil des ministres*, ECR 2011 I-00773, 1 mars 2011.

Shembull: GJEDNJ në rastin Petrov shqyrtoi zbatimin e rregullit lidhur me praktikën në një burg që lejon të burgosurit që janë të martuar nga dy telefonata në muaj nga bashkëshortet e tyre. Parashtruesi jetoi me partneren e tij për katër vjet dhe kishte një fëmijë me të, para se të dënohej me burgim, por atij nuk iu lejua të ketë dy telefonata në muaj nga partnerja e tij. GJEDNJ-ja e shqyrtoi këtë çështje dhe vendosi se, ndonëse martesë kishte një status të veçantë, për qëllime të rregullave në lidhje me komunikimin telefonik, parashtruesi - i cili formoi një familje me një partner të qëndrueshëm - ishte në një gjendje të krahasueshme me çiftet e martuara. GJEDNJ-ja specifikoi “edhe pse shtetet palë kontraktuese gëzojnë një hapësirë të caktuar diskrecioni në lidhje me mënyrën se si i trajtojnë çiftet e martuara dhe ato jashtëmartesore në fusha të tilla si, për shembull, tatimimi, sigurimi social ose politika sociale... nuk ka fakte evidente pse partnerët martesorë dhe jashtëmartesorë, të cilët kanë krijuar familje, i nënshtrohen një trajtimi të ndryshëm në lidhje me mundësinë e mbajtjes së kontaktit me telefon gjatë periudhës kur njëri partner është duke vuajtur dënimin me burgim.” Së këtejmi, GJEDNJ-ja vendosi se diskriminimi ishte i pajustificuar (GJEDNJ, rasti Petrov.⁹⁵

Në rastet e ngacmimit, prezumimi i diskriminimit mund të përgënjeshtrohet nëse personi kundër të cilit është parashtruar parashtrësia provon se trajtimi nuk e ka pasur për qëllim ose për pasojë cenimin e dinjitetit ose krijimin e mjedisit, qasjes ose praktikës kërcënuese, armiqësore, degraduese ose frikësuese.

Shembull: Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi në rastin nr. 0801 -355⁹⁶ i shqyrtoi pretendimet e parashtrueses së parashtrësës, e cila pohoi se ka pasur ngacmime në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor nga një parti politike në pjesën e medias dhe informimit publik. KPMD-ja konsideron se parashtruesja e parashtrësës, pohimin për diskriminim me sa duket e ka bërë me paraqitjen e print screen nga publikimi i partisë politike në profilin e saj në një nga rrjetet sociale dhe për këtë arsye barrën e provës ia kaloi personit kundër të cilit ishte paraqitur parashtrësia që të provojë se nuk ka bërë diskriminim. Në përgjigjen e parashtrësës janë dhënë fakte shpjeguese të cilat e ndihmuan KPMD-në gjatë analizës së të gjitha fakteve dhe prova-ve të rastit për të konstatuar se partia politike e ka përgënjeshtrohet supozimin për diskriminim dhe nuk ka gjetur ngacmim (KPMD, rasti nr. 0801-355).

Rastet e përshtatjes përkatëse mund të përgënjeshtrohen nëse provohet se ndryshimi dhe përshtatja e nevojshme në rastin e caktuar shkakton një barrë joproporcionale ose të panevojshme.

95. Shih: GJEDNJ, Petrov v. Bulgaria, Aplikimi nr 15197/02, 22 maj 2008.

96. Shih: Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, nr. 0801-355, 22 qershor 2022.

Shembull: Gjykata Administrative në Ruen në rastin nr. 0500526-3,⁹⁷ e shqyrtoi padinë e një personi me karrocë kundër Ministrisë së Arsimit për shkak se nuk ishte i punësuar në vendin e caktuar për të cilin kishte konkurruar. Aplikimi për punë i paraqitur nga paditësi u rangua në vendin e tretë në listën e kandidatëve. Kur dy kandidatët e parë nga lista e refuzuan vendin e ofruar të punës, i njëjti iu ofrua kandidatit të katërt, në vend që t'i ofrohej paditësit. Në vend të kësaj, paditësit iu ofrua një vend pune në një repart tjetër ku mjedisi i punës tashmë ishte i përshtatur për akses me karrocë. Shteti e arsyetoi këtë vendim me faktin se investimi i mjeteve për përshtatjen e ambienteve të punës nuk është në favor të interesit publik. Gjykata përcaktoi se Ministria e Arsimit nuk e përmbushi detyrën e saj për përshtatje adekuate për personat me aftësi të kufizuara, gjë që nuk mund të justifikohet me arsyet e prezantuara nga Ministria dhe konstatoi diskriminim (Gjykata Administrative e Ruen-it, rasti nr. 0500526-3).

Në rastin e diskriminimit të tërthortë, është mjaft diskutabile se sa është përqindja e grupit të prekur me efektin negativ joproportional të dispozitës, kriterit ose praktikës në shikim të parë neutrale, që është i mjaftueshëm të tregohet në mënyrë që të përcaktohet ekzistenca e rastit prima facie të diskriminimit, përkatësisht përgënjeshttrimit të këtij supozimi. GJDBE-ja në shumicën e rasteve që kanë të bëjnë me diskriminimin në bazë të seksit (si p.sh.: Rinner-Kühn, Nimz, Kowalska, De Weerd dhe Nolte) dhe në të gjitha rastet konsideron se nevojitet të tregohet një numër përmbajtësor. Për shembull, në rastin e Rinner-Kühn, ky numër është 89%.⁹⁸ Megjithatë, GJDBE-ja ua lë gjykatave kombëtare të vlerësojnë se a është përfshirë një numër i mjaftueshëm individësh në mënyrë që të përjashtohet rastësia dhe afati i shkurtër i pretendimeve.⁹⁹ E njëjta logjikë ndiqet nga GJEDNJ-ja në rastin *Di Trizio*¹⁰⁰ dhe rastin D.H., të shpjeguar më lart.

97. Shih: Gjykata Administrative në Ruen, Bouthellier v. Ministère de l'éducation, nr. 0500526-3, 24 qershor 2008..

98. Shih: GJDBE, C-171/88, Ingrid Rinner-Kühn v. FWW Spezial-Gebäudereinigung GmbH & Co. KG, 13 korrik 1989.

99. Shih: GJDBE, C-127/92, Dr. Pamela Mary Enderby v. Frenchay Health Authority and Secretary of State for Health, 27 tetor 1993.

100. Shih: GJEDNJ, *Di Trizio* k. Switzerland, App No. 7186/09, 2 shkurt 2016.

Shembull: Në rastin para Komisionit për Trajtim të Barabartë të Holandës, parashtruesja pohoi se ka diskriminim të tërthortë në bazë të përkatësisë etnike. Me fjalë të tjera, parashtruesja ndryshoi apartamentin e saj dhe gjatë shpërnguljes në pjesën juglindore të Amsterdami, ajo mori me vete abonimin e saj televiziv. Kur iu prish ruteri, ajo thirri kompaninë që t'i dërgojnë një teknik për të kontrolluar koneksionin. Kompania e refuzoi kërkesën duke theksuar se ka pjesë të qytetit me numra të caktuar postar në të cilat nuk dërgojnë teknikë për arsye sigurie, përkatësisht për shkak të rrezikut të grabitjes ose vjedhjes së teknikëve ose automjeteve. Parashtruesja pohimin e saj për diskriminim të tërthortë e konfirmoi me të dhëna statistikore lokale (të dhënat komunale të popullsisë) të cilat treguan se dy të tretat e popullsisë në atë pjesë konkrete të qytetit me numër të caktuar postar ishin persona të komuniteteve minoritare etnike, kështu që e bëri të mundur se politika e këtillë e kompanisë ka një efekt negativ joproporcional ndaj anëtarëve të këtyre komuniteteve minoritare etnike. Komisioni pranoi se ky është rast *prima facie* diskriminimi dhe konsideron se kompania nuk kishte justifikim objektiv për një sjellje të këtillë (Komisioni për Trajtim të Barabartë i Holandës, rasti nr. 2004-15).¹⁰¹.

Në disa shtete, instancat më të larta gjyqësore, nëpërmjet praktikës së tyre gjyqësore ose pavarësisht nga ajo, kanë hartuar udhëzime praktike për gjykatat më të ulëta që kanë të bëjnë me kalimin e barrës së provës në praktikë, përkatësisht si të vlerësojnë gjykatat nëse paditësi ose paditësja kanë krijuar një rast diskriminimi *prima facie* dhe kur duhet t'ia kalojnë barrën e provës punëdhënësit që ai/ajo të sigurojë një shpjegim të kënaqshëm për veprimet e veta. Së këtejmi, si praktikë të mirë do t'i veçonim udhëzimet e Gjykatës së Apelit në Angli dhe Uells në rastin *Igen Ltd v. Wong* që kanë të bëjnë edhe me rastin *Chamberlin and Emizie v. Emokpae dhe Webster v. Brunel University*.¹⁰² Udhëzimet shpjegojnë se kjo duhet parë si një qasje me dy shkallë në të cilën:

- » *Së pari*, paditësi ose paditësja duhet të provojë ekzistencën e fakteve nga të cilat gjykata mund të konkludojë, në bazë të bilancit të probabilitetit¹⁰³ dhe në mungesë të një shpjegimi adekuat, se i padituri ose e paditura ka kryer diskriminim të paligjshëm ndaj të paditurit ose të paditurës. Në këtë fazë, gjykata nuk merr një vendim përfundimtar se faktet e paraqitura çojnë në një vendim se është kryer diskriminim, por gjykata i shqyrton vetëm faktet primare para se të shqyrtojë se çfarë konkluzione për fakte dytësore mund të nxirren prej tyre. Gjatë miratimit të konkluzioneve nga faktet primare, gjykata duhet të supozojë se nuk ka shpjegim përkatës për këto fakte. Konkluzione mund të nxirren si nga përgjigjet e

101. Shih: Komisioni për Trajtim të Barabartë i Holandës, nr. 2004-15, vendim i datës 1 mars 2004.

102. Shih: Court of Appeal of England and Wales, *Igen Ltd (formerly Leeds Careers Guidance) and Others v Wong, Chamberlin and Another v Emokpae and Webster v Brunel University*, [2005] IRLR 258.

103. Shih: Me standardin *bilanci i probabiliteteve* nënkuptohet një situatë në të cilën gjykata më shumë beson se pretendimet e paditësit, përkatësisht paditësës janë të vërteta, sesa se nuk janë të vërteta.

pyetësorit, ashtu edhe nga mostrajtimi konform kodit të praktikave nëse i njëjti ekziston.

- » *Së dyti*, i padituri ose e paditura duhet të provojë, në bazë të bilancit të probabilitetit, se ai/ajo nuk ka kryer diskriminim të kundërligjshëm. Në këtë fazë, gjykata vlerëson jo vetëm nëse i padituri ose e paditura ka paraqitur një shpjegim të fakteve nga të cilat mund të nxirren konkluzione të tilla, por në mënyrë plotësuese nëse kjo është e mjaftueshme për ta çliruar atë nga barra e provës në bazë të bilancit të probabilitetit. Për shkak se faktet e nevojshme për të siguruar një shpjegim janë, më së shpeshti, në posedim të të paditurit ose paditurës, gjykata pret prova të sigurta për kalimin e barrës së provës. Në mënyrë të veçantë, gjykata me kujdes i shqyrton shpjegimet e të paditurit ose paditurës për mostrajtimin e tij/saj në procedurën e përgjigjes së pyetësorit ose mostrajtimin konform kodit të praktikave, nëse një i këtillë ekziston.

Nëse personi kundër të cilit është parashtruar parashtrësia nuk mund ta përgënjeshtrojë supozimin për diskriminim me kundërprova, atëherë kjo duhet ta justifikojë objektivisht atë. Duhet theksuar se në rastet e diskriminimit të drejtpërdrejtë, e drejta e Bashkimit Evropian nuk lejon justifikim të përgjithshëm, por vetëm përjashtime nga diskriminimi, ndërkaq legjislacioni ynë bazohet pikërisht mbi këtë standard juridik. Për më tepër, neni 7 i LPMD-së parashih përjashtimet nga diskriminimi, gjegjësisht parashih masat dhe trajtimet që nuk përbëjnë diskriminim, edhe atë shumë më ngushtë se e drejta e Bashkimit Evropian. Konkretisht, LPMD-ja përcakton se, “masat dhe trajtimet e ndërmarra me qëllimin e vetëm për të shmangur gëzimin e pabarabartë të të drejtave dhe lirive të njeriut nuk do të konsiderohen si diskriminim derisa të arrihet barazia faktike e një personi apo grupi, nëse dallimi është i justifikuar dhe objektiv, ndërsa mjetet për të arritur këtë qëllim janë proporcionale, përkatësisht përkatëse dhe të domosdoshme” (paragrafi 1). Së këtejmi, këto masa dhe veprime duhet të kufizohen në aspektin kohor dhe të zbatohen derisa të arrihet barazia faktike e personave ose grupit në gëzimin e të drejtave të tyre (paragrafi 2).

Shembull: *Rasti para Gjykatës së Kontesteve të Punës në Këln kishte të bënte me një shpallje punësimi duke filluar me frazën: “Gratë po vijnë në pushtet!” Një kandidat i pasuksesshëm u ankua se ai si burrë ishte diskriminuar. Gjykata e hodhi poshtë ankesën, duke i pranuar argumentet e kompanisë së paditur të cilët e përgënjeshtroan prezumimin e diskriminimit. Me fjalë të tjerat, trajtimi ishte i justifikuar sepse në kompaninë nuk kishte asnjë punonjëse femër (shitëse automobilash) ndërsa qëllimi i masës ishte t’u siguronte klientëve shitës dhe shitëse të të dy seksëve (Gjykata e Kontesteve të Punës në Këln, rasti Nr. Az 9 Ca 4843/15).¹⁰⁴*

104. Shih: Gjykata e Kontesteve të Punës e Këlnit, nr. Az. 9 Ca 4843/15, 10 Shkurt 2016.

Për më tepër, LPMD-ja parashikon në mënyrë eksplicite edhe dy përjashtime të tjera, përkatësisht nuk do të konsiderohet për diskriminim:

- » Së pari, trajtimi i ndryshëm i personave që nuk janë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut në lidhje me të drejtat dhe liritë e përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në ligjet dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë rezultojnë nga shtetësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- » Së dyti, trajtimi ndryshe i personave mbi ndonjë nga bazat diskriminuese për shkak të natyrës së profesionit ose aktivitetit apo për shkak të kushteve në të cilat zhvillohet ai profesion, i cili paraqet një kërkesë thelbësore dhe vendimtare, qëllimi është legjitim, ndërsa kushti nuk e tejkalon nivelin e nevojshëm për realizimin e tij (paragrafi 3).

Shembull: Në rastin *Mahlburg*, parashtruesja, e cila ishte shtatzënë, u refuzua në vendin e përhershëm të punës si infermiere, detyrat e së cilës do të kryheshin, në masë të madhe, në një sallë operacioni, me arsyetimin se ekspozimi ndaj substancave të rrezikshme në sallën e operacionit mund ta dëmtojë fëmijën e saj. GjDBE-ja përcaktoi duke qenë se ishte një vend i përhershëm i punës, ishte joproporcionale të ndalohej parashtruesja të aplikojë për këtë vend pune pasi që pamundësia e saj për ta kryer punën në sallën e operacionit do të ishte vetëm e përkohshme. Megjithëse u pranuan kufizimet në lidhje me kushtet e punës për një grua shtatzënë, ato duhet të kufizohen rreptësisht vetëm në detyrat që mund ta dëmtojnë atë dhe nuk guxojnë të nënkuptojnë ndalim të përgjithshëm të punës (*GJDBE, rasti Mahlburg*).¹⁰⁵

Shembull: Gjykata Administrative në Vasa në rastin nr. 04/0253/3, shqyrtoi çështjen në të cilën Kisha Ungjillore Luteriane e Finlandës refuzoi të caktojë për udhëheqës të morgut (ndihmës-klerik) një person i cili ishte në marrëdhënie me një person të të njëjtit seks. Gjykata e hodhi poshtë vendimin për shkak se heteroseksualiteti nuk mund të konsiderohet si kusht real profesional për kryerjen e detyrës përkatëse. Vëmendja u përqendrua mbi faktin se rregullat interne të Kishës nuk përmendin orientimin seksual në lidhje me emërimin e klerikëve dhe udhëheqësve të morgut (*Gjykata Administrative në Vasa, rasti nr. 04/0253/3*).¹⁰⁶

Duhet të dihet!

Diskriminimi i drejtpërdrejtë objektivisht nuk justifikohet, por ka vetëm përjashtime, përkatësisht masa dhe veprime që nuk përbëjnë diskriminim.

105. GjDBE, C-207/98, *Mahlburg* k. Land Mecklenburg-Vorpommern, ECR I-549, 3 shkurt 2000.

106. Shih: Gjykata Administrative Vaasan, Vaasan Halinto-oikeus, nr. 04/0253/3.

Shembull: Rasti para Avokatit për Parimin e Barazisë të Sllovenisë ka të bëjë me një individ i cili në moshën 70 vjeçare humbi automatikisht të drejtën për të vazhduar punën e tij në kuadër të një shoqërie sportive si refer sportiv (komisionar për ciklizëm). Në vitin 2018, Avokati për Parimin e Barazisë i Sllovenisë (organi kombëtar për barazi) mori një vendim, me të cilin u konstatua se kufiri i moshës ishte vendosur shumë përgjithësisht dhe zbatohet në praktikë pa dallim, përkatësisht pavarësisht mundësive të individit. Personi kundër të cilit është paraqitur parashtrës, Shoqata e ka mbështetur mbrojtjen e saj në të njëjtin kufi të moshës të përcaktuar në statutin e shoqatës ndërkombëtare, por nuk ka specifikuar arsye plotësuese pse kufiri i moshës do të ishte i domosdoshëm. Avokati i Parimit të Barazisë në procedurën e tij ka përcaktuar se rregullat e asociacionit ndërkombëtar të sportit, e që në të vërtetë është një organizatë ndërkombëtare joqeveritare, nuk e ka deroguar legjislacionin e brendshëm dhe të drejtën e Bashkimit Evropian. Në vendimin e tij përcaktoi se personi kundër të cilit është parashtruar parashtrës nuk e plotësoi barrën e provës së tij sepse nuk është përpjekur ta përcaktojë dhe sqarojë proporcionalitetin e masës ose të specifikojë se cili është qëllimi legjitim që do ta kishte ajo masë. Avokati iu referua Direktivës 2000/78/EC për barazi gjatë punësimit, meqë masa i ka kufizuar personat mbi moshën 70-vjeçare të përfshihen me punë të paguar në shoqatat (Avokati për Parimin e Barazisë i Sllovenisë, rasti nr. 0700-52/2020/11).¹⁰⁷

Shembull: Rasti Çam, kishte të bënte me refuzimin e parashtrueses - një vajzë me shikim të dëmtuar, për t'u regjistruar si studente në Akademinë Kombëtare të Muzikës të Turqisë. Edhe pse zonja Çam tregoi aftësi përkatëse për të luajtur flautin turk (saz) dhe e kaloi provimin pranues, ajo u refuzua nga drejtorja e dekanatit për shkak se kurset e muzikës nuk ishin të aksesueshme për personat me dëmtim të shikimit dhe kërkonin që ajo të paraqiste një vërtetim nga Drejtorja e Mjekëve se ajo mund të ndjekë kurset. Parashtruesja pohoi se ajo ishte diskriminuar në bazë të aftësisë së kufizuar dhe u ankua se është shkelur Konventa. Me vendimin e miratuar, GJEDNJ-ja konsideron se diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar e përfshin edhe mospëmbajtjen e përshtatjes adekuate. Gjykata vuri në dukje se me refuzimin e aplikimit të parashtrueses pa plotësuar nevojat e saj, autoritetet turke e penguan që ta realizojë të drejtën e saj për arsimim pa ndonjë arsyetim objektiv (GJEDNJ, rasti Çam).¹⁰⁸

Në çdo rast të diskriminimit të tërthortë, ndërhyhet në arsyetimin objektiv të diskriminimit përmes:

- » specifikimit të qëllimit legjitim,

107. Shih: Avokati për Parimin e Barazisë i Sllovenisë, nr. 0700-52/2020/11, vendim i datës 20.09.2021.

108. GJEDNJ, Çam k. Turkey, Aplikimi nr. 51500/08, 23 shkurt 2016.

- » përmbushjes së testit të proporcionalitetit (përshtatshmërisë dhe domosdoshmërisë).

Për të përcaktuar testin e proporcionalitetit, KPMD-ja duhet të bindet se: nuk ka mjete të tjera për arritjen e qëllimit të përcaktuar legjitim që imponon më pak ndërhyrje në të drejtën e barazisë. Me fjalë të tjera, pozita e pësuar e pafavorshme është niveli minimal i mundshëm i dëmtimit që kërkohet për të arritur qëllimin e dëshiruar. Njëkohësisht, duhet të tregohet se qëllimi që duhet të arrihet është mjaft i rëndësishëm për të justifikuar nivelin e ndërhyrjes.

Këto kritere i përcaktoi GJDBE-ja në rastin *Bilka-Kaufhaus*, në të cilin specifikohet se masa, praktika ose incidenti mund të justifikohen objektivisht mbi një bazë të ndryshme nga baza e specifikuar diskriminuese dhe se ndërmarrja mund të justifikojë politikën e miratuar të përjashtimit të punëtorëve dhe punëtoreve me orar të shkurtuar të punës nga skema e pagesave sociale, pavarësisht nga seksi i tyre, për të arritur qëllimin që të punësojë sa më pak punëtorë dhe punëtore me orar të shkurtuar të punës, nëse tregon se mjetet e zgjedhura për arritjen e këtij qëllimi, që korrespondojnë me nevojën reale të punëdhënësit, janë përkatëse dhe të domosdoshme për arritjen e tij¹⁰⁹.

Shembull: Në rastin *Bilka-Kaufhaus*, të shpjeguar më sipër, shtëpia e mallrave *Bilka* pohoi se qëllimi që qëndronte pas trajtimit të ndryshëm ishte të dekurajonte punën me orar të shkurtuar të punës dhe të stimulonte punën me orar të plotë të punës, sepse punëtorët me orar të shkurtuar të punës pretendonin të refuzonin punën në turnet e natës dhe ditëve të shtuna, me ç'rast kompania kishte vështirësi në sigurimin e numrit të mjaftueshëm të të punësuarve. GJDBE-ja përcaktoi se ky mund të jetë një qëllim legjitim, megjithatë, ajo nuk iu përgjigj pyetjes nëse përjashtimi i punëtorëve me orar të shkurtuar të punës nga *Fondi Pensional* është në proporcion me arritjen e këtij qëllimi. Kushti sipas të cilit masat e ndërmarra duhet të jenë “të domosdoshme” nënkupton se nuk ekziston një mjet alternativ i arsyeshëm, që do të shkaktonte më pak ndërhyrje në të drejtën e barazisë. Prandaj, GJDBE-ja ia la Gjykatës së brendshme ta zbatonte të drejtën bazuar në faktet e çështjes.

Shembull: Në një rast tjetër, GJDBE-ja specifikoi se i padituri ose e paditura duhet të provojë se masa, ligji ose praktika e miratuar është përkatëse dhe e domosdoshme për të arritur qëllimet e përcaktuara legjitime dhe se pafavorshmëritë e shkaktuara (efekti negativ) nuk janë joproporcionale me qëllimet që synojnë t'i arrijnë (GJDBE, rasti *CHEZ - Nikolova*).¹¹⁰

GJDBE-ja është e qartë në qëndrimin se qëllimet thjesht mone-tare nuk janë të pranueshme si justifikim objektiv dhe se përgjithësimi i zakonshëm i qëllimit që nuk ndërlihet me mirëqenien më

109. Shih: GJDBE, C-170/84, *Bilka - Kaufhaus GmbH v Karin Weber von Hartz*, 13 maj 1986, paragrafi 37.

110. Shih: GJDBE, C-83/14, „*CHEZ Razpredelenie Bulgaria*“ AD v. Komisia za zashitita ot diskriminatsia [GC], 16 korrik 2015, paragrafi 128.

të gjerë shoqërore nuk e kalon pragun e nevojshëm për justifikimin objektiv të diskriminimit. Ndryshe nga ky qëndrim, vendosi KPMD-ja në rastin nr. 0801225, shpjeguar më poshtë.

Shembull: Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi në rastin nr. 0801 -225,¹¹¹ i shqyrtoi pretendimet e parashtrueses së parashtrësës, e cila pohoi se ka diskriminim të tërthortë në bazë të gjendjes shëndetësore nga kompania e sigurimeve në fushën e aksesit në mallra dhe shërbime. KPMD ishte i mendimit se parashtruesja e parashtrësës e konfirmoi pohimin për diskriminim me sa duket me paraqitjen e kopjes nga komunikimi në Viber dhe letrën e refuzimit të ofertës për sigurim shëndetësor privat familjar sepse ajo paraprakisht kishte hepatitin C. Me përgjigjen ndaj parashtrësës janë dhënë fakte shpjeguese dhe janë bashkëngjitur provat, të cilat e kanë ndihmuar KPMD-në gjatë analizës së të gjitha fakteve dhe provave të rastit për të konstatuar se kompania e sigurimeve edhe pse nuk e ka përgënjeshtuar supozimin për diskriminim, megjithatë, objektivisht e ka justifikuar. Në opinionin e saj, KPMD-ja theksoi se në këtë rast refuzimi për përfshirje në sigurimin privat nga siguruesi është një mjet proporcional dhe i domosdoshëm për të përmbushur qëllimin legjitim të siguruesit – shmangien e çdo rreziku potencial të lartë që mund të çojë në humbje financiare (KPMD, rasti nr 0801-225).

Sipas standardeve ndërkombëtare, ekzistojnë disa parime që kufizojnë se cilat qëllime legjitime mund të konsiderohen si të pranueshme, si vijon:

- » Vetëm shqyrtimet buxhetore (financiare) asnjëherë nuk mund të shërbejnë si justifikim objektiv për diskriminimin.
- » Qëllimi i një praktike të tillë nuk duhet të ndërlidhet me diskriminim ndërkaq nuk mjafton vetëm përgjithësimi.
- » Proporcionaliteti nënkupton se masa e marrë konkrete për të arritur një qëllim legjitim duhet të jetë përkatëse për të arritur atë qëllim.
- » Nga ana tjetër, proporcionaliteti nënkupton se parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet të tregojë se një masë tjetër me efekt më të vogël ose pa efekt të dëmshëm fare nuk do të ishte efektive.

111. Shih: Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, nr. 0801-225, 8 nëntor 2021.

Shembull: Pas aktgjykimit të GJDBE-së në rastin Kalliri,¹¹² Këshilli i Shtetit i Greqisë në aktgjykimin e tij nr. 902/2021, njëzëri vendosi se kushti për pranim në shkollën e policisë me lartësi prej së paku 1.70 m, pavarësisht seksit të kandidatëve dhe kandidateve, padyshim se paraqet diskriminim të pajustificuar të tërthortë në bazë të seksit, në kundërshtim me Direktivën e Bashkimit Evropian për Barazi Gjinore. Këshilli përcaktoi se shteti grek, i cili e ka barrën e provës, nuk arriti të justifikojë nëse lartësia minimale e përmendur ishte përkatëse dhe e domosdoshme në mënyrë që të arrihet qëllimi legjitim, përkatësisht të sigurojë kapacitet operacional dhe funksionim të duhur të policisë. Pretendimet e shtetit se “lartësia e madhe” përfshin “pushtetin ekzekutiv dhe lehtëson mbrojtjen dhe zbatimin e teknikave të sulmit” nuk mund të pranohen si justifikim objektiv i diskriminimit indirekt bazuar në gjini ndaj kandidateve femra. Ajo që është interesante në këtë rast konsiston në atë se për herë të parë Këshilli në mënyrë eksplicite e zbatoi të drejtën e BE-së për kalimin e barrës së provës në rastet e barazisë gjinore, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJDBE-së për përdorimin e të dhënave statistikore si provë për ekzistimin e diskriminimit të tërthortë (Këshilli i Shtetit i Greqisë, rasti nr. 902/2021).¹¹³

Shembull: Rasti Vasil Ivanov Georgiev, para GJDBE-së, ka të bëjë me çështjen lidhur me pensionimin e detyrueshëm të pleqërisë. Legjislacioni bullgar i lejonte punëdhënësit t’ia anulojë kontratën e punës për marrëdhënie pune profesorit universitar kur të mbushte moshën 65-vjeç dhe pas kësaj moshe të ketë mundësi për maksimum tri kontrata njëvjeçare me afat të caktuar. Para GJDBE-së, qeveria bullgare pohoi se legjislacioni i kontestuar i brendshëm, brezave të rinj ua jep mundësinë të arrijnë deri në poste profesorësh, duke kontribuar kështu në ruajtjen e cilësisë së procesit mësimor dhe punës kërkimore si qëllim legjitim. Gjatë analizës së rastit, GJDBE-ja përcaktoi se Direktiva 2000/78/EC e Këshillit lejon miratimin e ligjeve të brendshme, të cilët konfirmojnë se profesorët universitarë mund të vazhdojnë të punojnë edhe pasi të kenë arritur moshën 65-vjeç, vetëm përmes kontratave njëvjeçare me afat të caktuar dhe të pensionohen në moshën 68-vjeçare. Megjithatë, Gjykata theksoi se ligji i këtillë duhet të ketë qëllim legjitim në lidhje me tregun e punës ose politikën e punësimit dhe se ky qëllim duhet të pritet të arrihet me mjete përkatëse dhe të domosdoshme. Qëllimet legjitime sipas GJDBE-së mund të përfshijnë sigurimin e procesit cilësor arsimor, si dhe shpërndarjen optimale të posteve të profesorëve ndërmjet gjeneratave të ndryshme (GJDBE, rasti Vasil Ivanov Georgiev).¹¹⁴

112. Shih: GJDBE, C-409/16, Ypourgos Esoterikon dhe Ypourgos Ethnikis payeias kai Thriskevmaton v Maria-Eleni Kalliri, ECLI EU C:2017:767, 18 tetor 2017.

113. Shih: Këshilli i Shtetit i Greqisë, nr. 902/2021. Për më shumë informacione shih: The European network of legal experts in gender equality and non-discrimination, *European equality law review*, Luxembourg, Publications Office of the European Union, shtator 2022, f. 106-108.

114. Shih: GJDBE, C-250/09 и C-268/09, Vasil Ivanov Georgiev v Tehnicheski universitet - Sofia, filial Plovdiv, ECR 2010 I-11869, 18 nëntor 2010.

Të njëjtin qëndrim e ka edhe GJEDNJ.

Shembull: Në rastin *Timishev*, parashtruesi pohoi se ka diskriminim për shkak se ishte penguar të kalojë pikën e kontrollit në një rajon të caktuar për shkak të origjinës së tij etnike çeçene. Gjykata përcaktoi se kjo konfirmohet me dokumente zyrtare, në të cilat vërehet ekzistencë e politikës për kufizimin e lëvizjes së çeçenëve etnikë. GJEDNJ-ja ishte e mendimit se, pasi parashtruesi tregoi ekzistencën e trajtimit të ndryshëm, është detyrimi i Qeverisë të provojë se një gjë e këtillë ishte e justifikuar. Në këtë rast, shpjegimi i shtetit u shpall jo bindës për shkak të mospërputhjeve në pohimin e tij se parashtruesi është larguar vullnetarisht pasi iu refuzua përparësia e radhës. Sipas kësaj, Gjykata arriti në konkluzionin se parashtruesi ishte diskriminuar në bazë të përkatësisë së tij etnike (GJEDNJ, rasti *Timishev*).¹¹⁵

Shembull: Në vitin 2017, për herë të parë, Gjykata e Rrethit e Stokholmit shqyrtoi një çështje identike me një çështje tjetër të paraqitur në Gjykatën e Përgjithshme një vit më parë. Në të dyja rastet, fokusi ishte mbi zbatimin e parimit të kalimit të barrës së provës. Me fjalë të tjera, këto raste kishin të bënin me atë nëse mëngët për një përdorim janë alternativë për parakrahët e zhveshur të myslimanëve që kanë studiuar stomatologji (Gjykata e Qarkut)¹¹⁶ ose për myslimanët stomatologë (Gjykata për Marrëdhënie të Punës).¹¹⁷ Fokusi ishte mbi zbatimin e akteve normative për shëndetin dhe sigurinë në punë, dëshirën e të interesuarve që të mos punojnë me parakrahë të ekspozuar të zhveshur për arsye fetare dhe zbatimi i këtij rregulli a përbën diskriminim të tërthortë. Në të dyja rastet, u dëgjuan dy ekspertë për domosdoshmërinë higjienike gjatë punës me parakrahë të zhveshur si pjesë e standardeve të higjienës dhe të njëjtit shprehën mendime të kundërta. Gjykata e Rrethit erdhi në përfundimin se mendimet e dy ekspertëve janë të besueshme, por në këtë rast i padituri duhet ta mbajë barrën e provës që ta përgënjeshtrojë prezumimin e diskriminimit të kryer. Prandaj, i padituri e humbi çështjen sepse nuk mund të provonte se përdorimi i mbrojtjes së parakrahut për një përdorim do ta rriste rrezikun nga infektimi. Nga ana tjetër, Gjykata për Konteste të Punës mori një vendim kontradiktor, edhe pse ka vendosur për një rast në bazë të provave thelbësisht të njëjta. Gjykata e Punës konsideron se kur i padituri i ka paraqitur arsyet objektive për veprimin e këtillë, të cilat ishin të natyrës higjienike, barra e provës i kaloi sërish paditësit, përkatësisht paditësi ta përgënjeshtrojë këtë pohim, edhe pse është konsideruar se të dy ekspertët kishin kredibilitet të njëjtë. Në këtë rast, Avokati i Popullit për Barazi nuk arriti t'i përgënjeshtrojë pohimet e ekspertit të palës së paditur dhe rrjedhimisht e humbi lëndën. Arsyeja kryesore për këtë rezultat ishte se, kur bëhet fjalë për rrezikimin e sigurisë së pacientit ose pacientes, punëdhënësit duhet t'i lejohet një hapësirë e gjerë diskrecioni në përcaktimin e rregullave të higjienës (försiktigesprincipen - parimi i kujdesit të duhur) kështu që çdo dyshim shtesë bie mbi paditësin, përkatësisht mbi paditësen..

115. Shih: GJEDNJ, *Timishev* k. Russia, Aplikimet nr. 55762/00 dhe 55974/00, 13 dhjetor 2005, paragrafi 57.

116. Shih: Gjykata e Qarkut të Stokholmit, *Equality Ombudsman v. the Swedish State through Karolinska Institutet*, nr. T 3905-15, 16 nëntor 2016.

117. Shih: Gjykata për Konteste të Punës e Suedisë, *Equality Ombudsman v. Peoples Dentist of Stockholm County*, nr. 65/2017, 20 dhjetor 2017.

3. Specifikimi i kalimit të barrës së provës në vendim (vendimin gjyqësor ose mendimin e KPMD-së)

Specifikimi dhe argumentimi i barrës së provës në vendim, vendimin gjyqësor apo mendimin e KPMD-së është jashtëzakonisht i rëndësishëm për efektivitetin e legjislacionit dhe zbatimin efikas të tij. Nga ana tjetër, analiza e mendimeve të KPMD-së, vë në pah se Komisioni, në përgjithësi, i ndjek elementet e kalimit të barrës së provës ndërkaq vendimin e tij e mbështet në zbatimin e këtij rregulli procedural, megjithatë në arsyetimin, aspak nuk i argumenton detajisht. Në disa raste, në mënyrë të qartë e specifikon neni 26 dhe e vë në dukje momentin e saktë të kalimit të barrës së provës, përkatësisht kur konsideron se është krijuar një rast *prima facie* diskriminimi dhe nuk gjen diskriminim në rastet në të cilat prezumimi i diskriminimit është përgënjeshtuar nga personi kundër të cilit është parashtruar parashtrësia. Në procedurat e zhvilluara *ex officio*, barra e provës zakonisht kalon me vendimin për ngritjen e procedurës sipas detyrës zyrtare për arsye se informacionet e pranuar që paraqesin dyshim të bazuar krijuan një shkallë të lartë bindjeje, përkatësisht prezumim të diskriminimit.

Ndërkaq, në procedurat gjyqësore, praktika është e ndryshme. Kotsevski në analizën e tij thekson se vetëm në 36 aktgjykime, më pak se gjysma e të analizuarve, barra e provës kalohet. Për më tepër, ekziston një praktikë e mirë që në disa aktgjykime, gjykatat në mënyrë eksplicite dhe pa mëdyshje, vendimet e tyre i mbështesin duke i zbatuar rregullat e barrës së provës. Në vazhdim janë specifikuar disa shembuj, të marrë drejtpërdrejt nga kjo analizë.¹¹⁸

Shembull: *Duke marrë parasysh dispozitat e cituara, veçanërisht dispozitën e nenit 38 paragrafit 1 të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, e cila përcakton që barra e provës se nuk ka pasur diskriminim bie mbi të paditurin, kjo gjykatë vlerëson se paditësit kanë paraqitur prova nga të cilat është bërë e mundshme se ndaj tyre është vepruar në mënyrë diskriminuese gjatë refuzimit, për t'iu mundësuar të dalin nga shteti, ndërsa i padituri nuk kishte provuar se nuk ka pasur diskriminim, përkatësisht se veprimet e punonjësve të policisë janë ndërmarrë në të njëjtën mënyrë si edhe për të gjithë qytetarët e tjerë. Paditësve, në mënyrë të pajustificueshme, nuk iu lejua të dalin nga shteti nga personat zyrtarë të punësuar në pikat kufitare, gjë që i ka vënë në pozitë të pabarabartë me qytetarët e tjerë. I padituri nuk provoi se ka pasur arsye të justifikuar të përcaktuara me akt normativ që paditësve të mos u lejohet të dalin nga shteti, dhe sipas kësaj se nuk ka pasur diskriminim në rastin konkret (Gjykata Themelore Manastir, P4 nr. 123/17).¹¹⁹*

118. Shih: Kocevski, G., Kalimi i barrës së provës në procedurat gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi, Analiza dhe rekomandimet për avancimin e efektivitetit të mbrojtjes gjyqësore nga diskriminimi, dokument i politikave publike, Koalicioni "Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara" MARGINI Shkup, Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi, Shkup, 2020, f. prej 26 deri në faqen 28.

119. Shih: Gjykata Themelore Manastir P4 nr. 123/17 datë 30.3.2018.

Shembull: Për sa i përket sugjerimit nga Gjykata e Apelit se nuk është e qartë se prej ku rezulton konkluzioni që i padituri do ta vazhdonte marrëdhënien e punës me paditësen nëse ajo nuk do të ishte shtatzënë, duke e pasur parasysh se kontrata e saj e punës ishte për një kohë të caktuar, në përputhje me nenin 38 paragrafi 1 të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, dëshmimi se nuk ka pasur diskriminim bie mbi palën e kundërt. Në rastin konkret, e paditura nuk provoi para gjykatës se edhe nëse paditësja nuk do të kishte qenë shtatzënë, nuk do t'ia kishte vazhduar kontratën e punës, aq më tepër kur u mor aktvendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditëses, 6 punëtorë kanë themeluar marrëdhënie pune me të paditurin, ndërsa i padituri nuk paraqiti prova se arsyeja e aktvendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditëses nuk ishte shtatzënia e saj (Gjykata Themelore Shkup 2, RO-980/17).¹²⁰

Shembull: Në aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës Themelore Civile Shkup, për diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar për shkak të mospajësimit të qasjes në vendin zgjedhor mbi bazë të njëjtë me të tjerët, Gjykata qartë theksoi se pas krijimit të rastit *prima facie* të diskriminimit nga ana e paditësit, të paditurit të cilët e kanë barrën e provës në përputhje me Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi në këtë procedurë, nuk kanë propozuar dhe nuk kanë paraqitur prova adekuate nga të cilat do të konstatohet se në periudhën pas vitit 2019, pas përpilimit të raporteve të shoqatave dhe pas dhënies së rekomandimeve të lartpërmendura, se në të gjitha vendet zgjedhore të shtetit pamundësohet plotësisht qasja e personave me aftësi të kufizuara dhe se është bërë një përshtatje e duhur në vendet zgjedhore për realizimin pa pengesa të së drejtës së tyre të votës (Gjykata Themelore Civile Shkup P4 nr. 75/21).¹²¹

Sa u përket praktikave të mira nga organet e barazisë për udhëzimet me shkrim në lidhje me kalimin e barrës së provës do të veçonim udhëzimet e këshillit konsulent të Autoritetit për Barazi të Hungarisë.¹²² Në udhëzimet specifikohet se:

- » Personi që ka ngrit procedurën (parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës) duhet të provojë se ka pësuar një lloj dëmi dhe se ka tipar të mbrojtur, por nuk e provon lidhjen kauzale ndërmjet dëmit dhe karakteristikës së mbrojtur.
- » Personi që ngrit procedurën (parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës) nuk duhet të provojë se ka pësuar dëm juridik, por vetëm dëm të zakonshëm. Kjo do të thotë se personi nuk

120. Shih: Gjykata Themelore Shkup 2 RO-980/17 e datës 7/6/2017.

121. Shih: Gjykata Themelore Civile Shkup, P4 nr. 75/21, datë 19.4.2022.

122. Shih: Position paper no. 10,007/1/2006 TT. Mes tjerash edhe: Resolution No. 384/4/2008. (III.28.) TT. of the Advisory Body of the Equal Treatment Authority relating to the share of the burden of proof (Az Egyenlő Bánásmód Tanácsadó Testület 384/4/2008. (III.28.) TT. sz. állásfoglalása a bizonyítási kötelezettség megosztásával kapcsolatban). Që nga viti 2021, Autoriteti i Barazisë i Hungarisë është bashkuar me Zyrën e Komisionarit për të Drejtat Themelore të Hungarisë, e cila i sublimon të dy mandatet, përkatësisht është edhe institucion kombëtar për të drejtat e njeriut edhe organ për barazi.

duhet të provojë se me trajtimin është shkelur ndonjë dispozitë e veçantë juridike, megjithatë një gjë e këtillë ka qenë më e pafavorshme për të, sesa qëndrimi i tij/saj i caktuar.

- » Personi ndaj të cilit është ngritur procedura provon se nuk ka lidhje kauzale ndërmjet dëmit dhe tiparit të mbrojtur.
- » Përveç kësaj, nëse ka lidhje kauzale ndërmjet dëmit dhe tiparit të mbrojtur, me njohjen e lidhjes kauzale, personi kundër të cilit është ngritur procedura ka mundësi të provojë se nuk ka qenë i obliguar të respektojë detyrimin për trajtim të barabartë.





BIBLIOGRAFIA

- CJEU, C-199/82, Amministrazione delle Finanze dello Stato v. SpA San Giorgio, [1983] ECR 3595.
- CJEU, C-81/12, Asociația Accept v. Consiliul Național pentru Combaterea Discriminării, 25 prill 2013.
- CJEU, C-236/09, Association Belge des Consommateurs Test-Achats ASBL and Others v Conseil des ministres, ECR 2011 I-00773, 1 mars 2011.
- CJEU, C-394/11, Belov v CHEZ Elektro Bulgaria AG, [2013] 2 CMLR 29.
- CJEU, C-170/84, Bilka - Kaufhaus GmbH v Karin Weber von Hartz, 13 maj 1986.
- CJEU, C-32/93, Carole Louise Webb v. EMO Air Cargo (UK) Ltd., 14 korrik 1994.
- CJEU, C-54/07, Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding v Firma Feryn NV, 10 korrik 2008.
- CJEU, C-83/14, "CHEZ Razpredelenie Bulgaria" AD v. Komisia za zashtita ot diskriminatsia [GC], 16 korrik 2015.
- CJEU, C-303/06, Coleman v Attridge Law and Steve Law, 17 korrik 2008.
- CJEU, C-45/76, Comet v. Produktschap voor Siergewassen, [1975] ECR 2043.
- CJEU, C-80/70, Defrenne I, [1971] ECR 445.
- CJEU, C-50/96, Deutsche Telekom v. Schröder, [2000] ECR I-743.
- CJEU, C-127/92, Dr. Pamela Mary Enderby v. Frenchay Health Authority and Secretary of State for Health, 27 tetor 1993.
- CJEU, C-177/88, Elisabeth Johanna Pacifica Dekker v. Stichting Vormingscentrum voor Jong Volwassenen (VJV-Centrum) Plus, 8 nëntor 1990.
- CJEU, C-127/92, Enderby v Frenchay Health Authority and Secretary of State of Health, 1993 ECR I-05535.
- CJEU, C-415/10, Galina Meister v. Speech Design Carrier Systems GmbH, 19 prill 2012.
- CJEU, C-109/88, Handels- og Kontorfunktionærernes Forbund i Danmark v Dansk Arbejdsgiverforening (acting on behalf of Danfoss), [1989] ECR I-3199.
- CJEU, C-4/02 and C-5/02, Hilde Schönheit v. Stadt Frankfurt am Main and Silvia Becker v. Land Hessen, ECR I-12575, 23 tetor 2003.
- CJEU, C-171/88, Ingrid Rinner-Kühn v. FWW Spezial-Gebäudereinigung GmbH & Co. KG, 13 korrik 1989.
- CJEU, C-207/98, Mahlburg v. Land Mecklenburg-Vorpommern, ECR I-549, 3 shkurt 2000.
- CJEU, C-267/06, Maruko v. Versorgungsanstalt der deutschen Bühnen, ECR I-1757, 1 prill 2008.
- CJEU, C-191/03, North Western Health Board v. Margaret McKenna, 8 shtator 2005.
- CJEU, C-104/10, Patrick Kelly v. National University of Ireland (University College, Dublin), 21 korrik 2011.
- CJEU, C-167/97, Regina v. Secretary of State for Employment, ex parte Seymour-Smith and Perez, [1999], ECR I-623, 9 shkurt 1999.
- CJEU, C-423/04, Richards v. Secretary of State for Work and Pensions, ECR I-3585, 27 prill 2006.
- CJEU, C-506/06, Sabine Mayr v. Bäckerei und Konditorei Gerhard Flöckner OHG [GC], 26 shkurt 2008.

- CJEU, C-381/99, Susanna Brunnhofer v. Bank der österreichischen Postsparkasse AG, [2001] ECR I-4961, 26 qershor 2001.
- CJEU, C-250/09 and C-268/09, Vasil Ivanov Georgiev v Tehniceski universitet - Sofia, filial Plovdiv, ECR 2010 I-11869, 18 nëntor 2010.
- CJEU, C-409/16, Ypourgos Esoterikon and Ypourgos Ethnikis paideias kai Thriskevmaton v Maria-Eleni Kalliri, ECLI EU C:2017:767, 18 tetor 2017.
- Committee on the Rights of Persons with Disabilities, S.C v. Brazil, Communication No. 10/2013, CRPD/C/12/D/10/2013, Decision of 28 tetor 2014.
- Council Directive 97/80/EC of 15 December 1997 on the burden of proof in cases of discrimination based on sex, OJ L 14, 20.1.1998.
- Council Directive 2000/43/EC of 29 June 2000 implementing the principle of equal treatment between persons irrespective of racial or ethnic origin, OJ L 180, 19.7.2000.
- Council Directive 2000/78/EC of 27 November 2000 establishing a general framework for equal treatment in employment and occupation, OJ L 303, 2.12.2000.
- Council Directive 2004/113/EC of 13 December 2004 implementing the principle of equal treatment between men and women in the access to and supply of goods and services, OJ L 373, 21.12.2004.
- Council Directive 97/80/EC of 15 December 1997 on the burden of proof in cases of discrimination based on sex.
- Council of Europe/European Court of Human Rights, Guide on Article 14 of the European Convention on Human Rights and on Article 1 of Protocol No. 12 to the Convention, Prohibition of discrimination, Strasbourg, updated on 31 August 2022.
- Court of Appeal of England and Wales, Igen Ltd (formerly Leeds Careers Guidance) and Others v Wong, Chamberlin and Another v Emokpae and Webster v Brunel University, [2005] IRLR 258.
- CEDAW, S.B. and M.B. v. North Macedonia, CEDAW/C/ 77/D/143/2019, 1 December 2020.
- CRPD, Michael Lockrey v. Australia, Communication No. 13/2013, CRPD/C/15/D/13/2013, 25 prill 2016.
- De Schutter, O., Methods of proof in the context of combatting discrimination, in Cormack, J. (ed), Proving discrimination. The dynamic implementation of EU anti-discrimination law: The role of specialised bodies, Migration Policy Group, Brussels, 2003.
- Directive 2006/54/EC of the European Parliament and of the Council of 5 July 2006 on the implementation of the principle of equal opportunities and equal treatment of men and women in matters of employment and occupation (recast), OJ L 204, 26.7.2006.
- ECSR, Associazione Nazionale Giudici di Pace v. Italy, App No. 102/2013, 5 korrik 2016.
- ECSR, SUD Travail Affaires Sociales, SUD ANPE and SUD Collectivité Territoriales v. France, App No. 24/2004, 8 nëntor 2005.
- ECSR, Mental Disability Advocacy Centre (MDAC) v. Bulgaria, App No. 41/2007, 3 qershor 2008.
- ECtHR, Anguelova v. Bulgaria, App No. 38361/97, 13 qershor 2002.
- ECtHR, Biao v. Denmark [GC], App No. 38590/10, 24 maj 2016.
- ECtHR, B.S. v. Spain, App No. 47159/08, 24 korrik 2012.
- ECtHR, Carvalho Pinto de Sousa Morais v. Portugal, App No. 17484/15, 25 korrik 2017.
- ECtHR, Cînta v. Romania, App No. 3891/19, 18 shkurt 2020.
- ECtHR, Chassagnou and Others v. France [GC], App Nos. 25088/94, 28331/95 and 28443/95, 29 prill 1999.

- ECtHR, D.H. and Others v. Czech Republic case, App No 57325/00, Grand Chamber Judgement, 13 nëntor 2007.
- ECtHR, Di Trizio v. Switzerland, App No. 7186/09, 2 shkurt 2016.
- ECtHR, Gaygusuz v. Austria, App No. 17371/90, 16 shtator 1996.
- ECtHR, Guberina v. Croatia, App No. 23682/13, 22 mars 2016.
- ECtHR, Hoogendijk v. the Netherlands (dec.), App No. 58641/00, 6 janar 2005.
- ECtHR, Horváth and Kiss v. Hungary, App No. 11146/11, 29 janar 2013.
- ECtHR, Khamtokhu and Aksenchik v. Russia [GC], App Nos. 60367/08 and 961/11, 24 janar 2017.
- ECtHR, Kiyutin v. Russia, App No. 2700/10, 10 mars 2011.
- ECtHR, Makuchyan and Minasyan v. Azerbaijan and Hungary, App No. 17247/13, 26 maj 2020.
- ECtHR, Nachova and Others v. Bulgaria case, App Nos. 43577/98 and 43577/98, 6 korrik 2005.
- ECtHR, Oršuš and Others v. Croatia [GC], App No. 15766/03, 16 mars 2010.
- ECtHR, Petrov v. Bulgaria, App No. 15197/02, 22 maj 2008.
- ECtHR, Çam v. Turkey, App No. 51500/08, 23 shkurt 2016.
- ECtHR, Salman v. Turkey [GC], App No. 21986/93, 27 qershor 2000.
- ECtHR, Sejdić and Finci v. Bosnia and Hercegovina, App Nos. 27996/06 and 34836/06, 22 dhjetor 2009.
- ECtHR, Timishev v. Russia case, App Nos. 55762/00 and 55974/00, 13 dhjetor 2005.
- Equality Tribunal, Campbell Catering Ltd v. Aderonke Rasaq, 2004- EEDO48.
- European Committee of Social Rights, Mental Disability Advocacy Center v. Bulgaria, Complaint No. 41/2007, 3 qershor 2008.
- European Committee of Social Rights, European Action of the Disabled (AEH) v. France, Complaint No. 81/2012, 11 shtator 2013.
- European Network Against Racism, Changing Perspective: Shifting of the burden of proof in racial equality cases, Brusseles, 2006.
- European Union Agency for Fundamental Rights and Council of Europe, Handbook on European non-discrimination law, 2018 edition, Publications Office of the European Union, Luxembourg, 2018.
- Farkas, L., O'Farrell, O., Reversing the burden of proof: Practical dilemmas at the European and national level, European Commission, Brusseles, 2014.
- Fredman, S., Discrimination Law, (2nd edn), Oxford University Press, 2011.
- General Comment No. 6: Article 5: Equality and non-discrimination, Committee on the Rights of Persons with Disabilities, CRPD/C/GC/6, 9 mars 2018.
- General Comment No. 20, Non-discrimination in economic, social and cultural rights, United Nations Committee on Economic, Social and Cultural Rights, E/C.12/GC/20, 2 korrik 2009.
- General Comment No. 3: Article 6: Women and girls with disabilities, Committee on the Rights of Persons with Disabilities, CRPD/C/GC/3, 25 nëntor 2016.
- Houtzager, D., Changing Perspectives: Shifting the Burden of Proof in Racial Equality Cases, European Network Against Racism (ENAR) Brussels, qershor 2006.
- Position paper no. 10.007/1/2006 TT, Advisory Body of the Equal Treatment Authority.
- Resolution No. 384/4/2008. (III.28.) TT. of the Advisory Body of the Equal Treatment Authority relating to the share of the burden of proof (Az Egyenlő Bánásmód Tanácsadó Testület 384/4/2008. (III.28.) TT. sz. állásfoglalása a bizonyítási kötelezettség megosztásával kapcsolatban).

- Ringelheim, J., The burden of proof in anti-discrimination proceedings. A focus on Belgium, France and Ireland, in European equality law review, European network of legal experts in gender equality and non-discrimination, Publications Office of the European Union, Luxembourg, 2019.
- The European network of legal experts in gender equality and non-discrimination, European equality law review, Luxembourg, Publications Office of the European Union, shtator 2022.
- The European network of legal experts in gender equality and non-discrimination, A comparative analysis of non-discrimination law in Europe 2021, Luxembourg, Publications Office of the European Union, shkurt 2022.
- The European network of legal experts in gender equality and non-discrimination, A comparative analysis of gender equality law in Europe 2021, Publications Office of the European Union, Luxembourg, shkurt 2022.
- Autoriteti i Barazisë i Hungarisë, nr. 654/2009, 20 dhjetor 2009.
- Avokati për Parimin e Barazisë i Sllovenisë, nr. 0700-52/2020/11, Vendimi i 20 shtatorit 2021.
- Gjykata e Apelit në Montpellier, IBM v. Buscail, nr. 0200504, 28 maj 2020.
- Gjykata e Apelit në Paris, Billau v SOS Racism, vendimi nr. 07.04974, 17 maj 2008.
- Gjykata e Apelit e Mbretërisë së Bashkuar, Eweida v. British Airways Plc., EWCA çështje nga e drejta civile nr. 80, 12 shkurt 2010.
- Gjykata Supreme e Francës, Seksioni për të Drejta Sociale, P+B Fluchère, Dick v CFDT v SNCF, nr. 1027, 28 mars 2000.
- Gjykata Supreme e Holandës, Binderen v. Kaya, NJ 1983, 687, 10 dhjetor 1982.
- Gjykata Federale e Gjermanisë për Konteste të Punës, nr. 8 AZR 170/19, 25 mars 2003.
- Këshilli i Shtetit i Greqisë, nr. 902/2021.
- Këshilli i Shtetit i Francës, nr. 16-102017, 16 tetor 2017.
- Gjykata e Qarkut në Lubjanë, nr. III P 7/2021, vendim i datës 25.02.2021.
- Ligji për mbrojtje nga ngacmimet në vendin e punës, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 79/2013 dhe 147/2015 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV”, nr. 103/2021.
- Ligji për Avokatin e Popullit, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 60/03, 114/09, 181/16, 189/16 dhe 35/2018.
- Ligji për procedurë kontestimore, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 79/2005, 110/2008, 83/2009, 116/2010 dhe 124/2015.
- Ligji për marrëdhëniet e punës, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 62. 2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015, 27/2016 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV”, nr. 10/2019, 267/2020, 151/2021 dhe 288/2021.
- Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, “Gazeta Zyrtare e RMV”, nr. 258/2020.
- Komisioni për Trajtim të Barabartë i Holandës, nr. 2004-15, vendim i datës 1 mars 2004.
- Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, nr. 0801-355, 22 qershor 2022.
- Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, nr. 0801-312, 13 dhjetor 2021.
- Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, nr. 0801-265, 9 dhjetor 2021.
- Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, nr. 0801-269, 13 tetor 2021.
- Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, nr. 0801-225, 8 tetor 2021.
- Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, nr. 0801-136, 30 gusht 2021.
- Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, nr. 0801-262, 7 korrik 2021.
- Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, nr. 08-7, 7 korrik 2021.

- Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, nr. 0801-278, 5 korrik 2021.
- Kotevska, B., Udhëzues për bazat e diskriminimit, Misioni i OSBE-së në Shkup dhe Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi, Shkup, 2013, f.
- Kocevski, G., Kalimi i barrës së provës në procedurat gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi, Analiza dhe rekomandimet për avancimin e efektivitetit të mbrojtjes gjyqësore nga diskriminimi, dokument i politikave publike, Koalicioni “Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara” MARGINI Shkup, Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi, Shkup, 2020.
- Kočoska, E., Trpevska, M., Udhëzues për përshtatje përkatëse, Misioni i OSBE-së në Shkup, Shkup, 2020.
- Avokati i Popullit për trajtim të barabartë i Sllovenisë, nr. UEM-0921-1/2008-3, 28 gusht 2008.
- Gjykata e Qarkut në Varshavë (Gjykata e Shkallës së Dytë), nr. V Ca 3611/14, 18 nëntor 2005.
- Gjykata e Qarkut në Sofje, nr. 2860/2006, 21 qershor 2006.
- Gjykata e Qarkut në Stokholm, Equality Ombudsman v the Swedish State through Karolinska Institutet, nr. T 3905-15, 16 nëntor 2016.
- Gjykata Themelore Manastir P4 nr. 123/17, 30.3.2018.
- Gjykata Themelore Civile Shkup, P4 nr. 75/21, 19.4.2022.
- Gjykata Themelore Bruksel, nr. 05/1289/A ref. T. Nr. 1264/05, 25 qershor 2005.
- Gjykata Themelore Shkup 2 PO-980/17, 7.6.2017.
- Poposka, Zh., Interpretues i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Polio Plus – Lëvizja kundër handicapit, Shkup, 2018.
- Poposka, Zh., Mihajloski, Z., Georgievski, A., Udhëzues për rolin e Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi në Procedurë Gjyqësore dhe Kalimi i Barrës së Provës, Misioni i OSBE-së në Shkup, Shkup, 2013.
- Poposka, Zh., Diskriminimi në bazë të handicapit në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi” – Shkup, Fakulteti Juridik “Justiniani I” 2012.
- Gjykata për Konteste të Punës në Këln, nr. Az. 9 Ca 4843/15, 10 shkurt 2016.
- Gjykata për Konteste të Punës e Irlandës, Noonan Services v A Worker, EDA1126, 29 korrik 2011.
- Gjykata për Konteste të Punës e Irlandës, Wrights of Howth Seafood Bars Limited v. Murat, EDA1728, 26 tetor 2017 .
- Gjykata për Konteste të Punës e Irlandës, A Nigerian National v Financial Institution , DEC-S2005-114.
- Gjykata për Konteste të Punës e Suedisë, Equality Ombudsman v. Peoples Dentist of Stockholm County, nr. 65/2017, 20 dhjetor 2017.
- Tribunali i Punësimit në Leuven, AR 12/1064/1, 12 dhjetor 2013.
- Gjykata Administrative Vaasan, Vaasan Halinto-oikeus, nr. 04/0253/3.
- Gjykata Administrative në Ruen, Bouthellier v. Ministère de l'education, nr. 0500526-3, 24 qershor 2008.



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

Misioni i OSBE-së në Shkup

adresa: Bulevardi 8 shtatori Nr. 16, 1000 Shkup

e-mail: info-MK@osce.org

web faqja: www.osce.org/mission-to-skopje